

REFORMIMI I SISTEMIT TË PENSIONEVE PROBLEMET DHE SFIDAT

Landi Gushi

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në “Shkenca
Ekonomike” me profil “Financë” për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Adrian Civici

Prof. Asoc. Dr. Mirela Çuçllari

Numri i fjalëve: 58452

Tirane, Tetor 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Landi Gushi

ABSTRAKTI

Procesi i zhvillimit të sistemit të sigurimeve shoqërore në Shqipëri i korrespondon transformimit të saj nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë. Në qendër të sistemit të sigurimeve shoqërore është skema e pensioneve. Aktualisht me pensione trajtohen rreth 20 përqind e popullsisë, me tendencë të qarta drejt rritjes së numrit të tyre. Megjithatë sistemi i pensioneve në Shqipëri ka kaluar një seri reformash të rëndësishme, në vitet 1993, 2002, 2005 dhe 2014, ai ende përballë me një numër sfidash. Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, krijoi një sistem të detyrueshëm, publik, me mbulim universal të sigurimeve shoqërore dhe një shtyllë suplementare vullnetare, e cila megjithatë ka një kuadër ligjor të plotësuar nuk paraqitet ende e zhvilluar. Aktualisht, sistemi i pensioneve në Shqipëri dominohet nga skema e detyrueshme publike, e cila sot menaxhohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Sa i suksesshëm është sistemi shqiptar i pensioneve në përmbushjen e funksioneve të tij? Analiza e sistemit bën evidente problemet e funksionimit të tij në kushtet aktuale të zhvillimit ekonomik të vendit tonë. Me qëllim që sistemi të plotësojë funksionet për të cilat është ngritur, të jetë i qëndrueshëm financiarisht dhe t’i përshtatet zhvillimeve të ardhshme social-ekonomike të vendit, si alternativë e vetme mbetet vazhdimi i reformimit të tij. Nevoja më e madhe për reformim lind tek skema e detyrueshme, e cila mban peshën më të madhe të funksionimit të mbrojtjes sociale në vendin tonë dhe që ka si qëllim garantimin e mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit, me elementë të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme. Mundësitë për të ndërmarrë reforma dhe llojet e tyre janë të shumta, por suksesi apo dështimi i tyre varet nga sasia dhe masat që merren për sigurimin e mjeteve financiare që do të financojnë sistemin. Çdo reformë strukturore duhet të mbajë mirë parasysh rregullimet parametrike, të cilat do të jenë të nevojshme për të mbajtur në balancë skemën e pensioneve publike. Njerëzit që përfitojnë nga kjo, i kanë merituar të drejtat e fituara dhe natyrisht kanë të drejtë të kërkojnë më shumë për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre. Ky punim nëpërmjet një analize përshkruese të sistemit të pensioneve në Shqipëri, identifikon problematikat dhe sfidat për zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të pensioneve në kontekstin e zhvillimit social-ekonomik të vendit.

Fjalët kyçe: Reforma, Sistemi i pensioneve, Shqipëri.

ABSTRACT

The process of developing the social insurance system in Albania corresponds to its transformation from a centrally planned economy to a free market economy. In the center of the social insurance system is the retirement fund scheme. Actually, there is about 20 percent of the population treated with pensions, with clear trends towards increasing their numbers. Although the pension system in Albania has passed a series of important reforms in the years 1993, 2002 and 2005, it still faces a number of challenges. Law no. 7703 , dated 11.05.1993 " On Social Insurance in the Republic of Albania " , as amended , established a system of compulsory public, universal social security coverage and a voluntary supplementary pillar , which although has a legal framework does not appear to meet yet the complete development. Currently, pension system in Albania is dominated by mandatory public schemes, which today is managed by the Institute of Insurance System. How successful is the Albanian pension system to fulfill its functions? System analysis makes evident its functioning problems in current economic conditions of our country. In order that the system fulfills the functions for which it was established, to be financially sustainable and adapt to the developments of socio- economic future of the country, the only alternative left is to continue his reforms. The greatest need for reform arises to mandatory schemes, which holds the largest share of the functioning of social protection in our country and that is intended as ensuring full coverage of the country's population, with elements of social security binding, held at acceptable levels. Opportunities to undertake reforms and their types are numerous, but their success or failure depends on the quantity and measures for securing funds that will finance system. Any structural reform must keep in mind parametric adjustments that would be necessary to maintain the balance of the public pension scheme. People who benefit from it deserve the rights acquired and of course have the right to demand more for improving the quality of their lives. This paper through a descriptive analysis of the pension system in Albania, identifies issues and challenges for the development of a sustainable pension system in the context of socio-economic development of the country.

Key words: reform, pension system, Albania.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I → HYRJE.....	1
I.1. Formulimi i problemit.....	2
I.2. Synimi dhe qëllimi i studimit.....	4
I.3. Objektivat e Studimit.....	5
I.4. Hipoteza dhe pyetjet e kërkimit.....	5
I.5. Metodologjia.....	6
I.6. Rëndësia e studimit.....	8
I.7. Kufizimet e studimit.....	8
KAPITULLI II → VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI SIGURIMET	
SHOQËRORE DHE SISTEMET E PENSIONIT.	
II.1 Parimet dhe funksionimi i sigurimeve shoqërore.....	9
II.1.1 Koncepti i sigurimeve shoqërore.....	9
II.1.2 Parimet e sigurimeve shoqërore.....	11
II.2 Roli i sistemeve të pensionit.....	16
II.2.1 Origjina dhe sistemet e para të pensioneve në botë.....	16
II.2.2 Përse shërbejnë sistemet e pensioneve?	17
II.2.3 Objektivat e një sistemi pensioni.....	19
KAPITULLI III → STRUKTURA E PENSIONEVE	
III.1 Llojet e skemave të pensioneve dhe administrimi i tyre.....	22
III.2 Mekanizmat mbështetës për personat e moshës së tretë.....	26
III.2.1 Sistemet kontribuese: kostot dhe risku.....	26
III.2.2 Sistemet e pensioneve jo kontribuese: kostot dhe risku.....	28
III.3. Ndikimi rishpërndarës dhe social i sistemeve të pensionit.....	30

III.3.1 Rishpërndarje nëpërmjet kontributit.....	33
III.3.2.1 Rishpërndarja e qëllimshme.....	34
III.3.2.2 <i>Rishpërndarja e paqëllimshme</i>	36
III.3.2.3 <i>Rishpërndarja midis brezave</i>	37
III.4 Rishpërndarja në sistemin me kontribut të përcaktuar.....	38
III.5 Rishpërndarja nëpërmjet fondeve vullnetare ose suplementare.....	39
III.6 Sistemi shumëshpyllësh i Bankës Botërore.....	40
III.6.1 Përkufizimet e shtyllave.....	41

KAPITULLI IV → REFORMIMI I SISTEMIT TË PENSIONEVE

IV.1 Arsye për reformimin e sistemit të pensionit.....	44
IV.2 Llojet e reforma në sistemet e pensioneve dhe pasojat e shpërndarjes.....	46
VI.2.1 Reformat parametrike.....	47
IV.3 Reformat e pensioneve në Europën Qendrore dhe Lindore	52
IV.4 Treguesit kryesorë të skemave të pensionit.....	52
IV.5 Tipet, llogaritja dhe niveli i përfitimeve.....	60
IV.5.1 Tipet e përfitimeve.....	60
IV.5.2 Formula e llogaritjes së përfitimit.....	67

KAPITULLI V → SISTEMI I PENSIONEVE NË SHQIPËRI

V.1 Sistemi i pensioneve para viteve '90.....	74
V.1.1 Elementët pozitivë dhe negativë të sistemit të trashëguar të Sigurimeve Shoqërore	78
V.2 Sistemi i pensioneve pas miratimit të Ligjit Nr. 7703.....	78
V.2.1 Skemat e përfitimeve.....	80
V.2.2 Llojet e përfitimit.....	80
V.2.3 Çështje fiskale dhe financiare të sigurimeve shoqërore.....	82

V.3 Sistemi aktual dhe reformat e ndërmarra deri në vitin 2015.....	84
V.3.1 Ndryshimet e zbatuara në sistemin e sigurimeve shoqërore deri në vitin 1998.....	85
V.3.2 Reformat parametrike të vitit 2002.....	86
V.3.3 Proceset e ngushtimit të diferencave në masën e pensioneve.....	87
V.3.4 Reformat e sistemit në vitin 2005.....	88
V.3.5 Reformat e sistemit në vitin 2014.....	89
V.4 Problemet që konstatohen në sistemin aktual të pensioneve.....	100

KAPITULLI VI → PROGNOZIMI ME MODELIN PROST

VI.1 Pse prognozojmë sistemet e pensioneve?.....	102
VI.2 Pyetjet e kërkimit.....	104
VI.3 Metodologjia e prognozimit.....	104
VI. 3.1 Outputi i modelit.....	105
VI. 3.2 Të dhënat dhe supozimet e modelit.....	106

KAPITULLI VII → SUPOZIMET PËR PROJEKTIM TË SISTEMIT

SHQIPËTAR

VII. 1. Supozime i Projektimi të sistemit bazë(egzistues).....	108
VII. 2. Supozimet me sistem të reformuar duke futur dhe kolonën e dytë.....	122
VII.2.1 Parimet e ndërtimi të kolonës së dytë.....	122
VII.2.2 Probleme që duhen marrë në konsideratë për të realizuar futjen e kolonës së dytë të pensioneve.....	123
VII.2.3 Strukturat institucionale të nevojshme për të implementuar skemën private të pensioneve.....	126
VII.2.3.1 Strukturat rregullatore dhe administrative.....	127

VII.2.3.2 Përcaktimi i rolit të qeverisë para dhe pas ndërmarrjes së reformës.....	128
VII.2.3.3 Mbikqyrja e qeverisë për fondet private.....	130
VII.2.3.4 Reformat paralele të nevojshme për të siguruar suksesin e skemës shumëkolonëshe.....	131
VII.2.4 Përcaktimet ligjore për implementimin e skemës private të pensioneve.....	132
VII. 3 Supozimet e modeleve për shtyllën e dytë.....	133

KAPITULLI VIII → REZULTATET E PARASHIKIMIT

VIII.1. Rezultatet e parashikimit të sistemit bazë (egzistues).....	139
VIII. 1.1. Parashikimet për popullsinë.....	139
VIII. 1.2. Parashikimet e rezultatit financiar.....	145
VIII. 2. Rezultatet e parashikimit të sistemit me kolonë të dytë të plotë.....	147
VIII. 3. Rezultatet e parashikimit të sistemit me kolonë të dytë të pjesshme 10%.....	153
VIII. 4. Rezultatet e parashikimit të sistemit me kolonë të dytë e të pjesshme 5%.....	161

KAPITULLI IX → PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

XI. 1.	
Përfundime.....	166
XI. 2 . Rekomandime.....	167

LISTA E GRAFIKEVE

Grafiku 1: Popullsia sipas grupmoshave.....	139
Grafiku 2: Koeficienti i varësisë së të moshuarve.....	140
Grafiku 3: Norma e varësisë së sistemit.....	141
Grafiku 4: Numri i pensionistëve ndaj numrit total të popullsisë.....	142
Grafiku 5: Norma e varësisë së sistemit.....	143
Grafiku 6: Shkalla e zëvendësimit të sistemit.....	144
Grafiku 7: Të ardhurat dhe shpenzimet.....	145
Grafiku 8: Balanca e sistemit ndaj GDP nominale.....	146
Grafiku 9: Të ardhurat e sistemit PAYG kur futet kolona e dytë e plotë.....	148
Grafiku 10: Shpenzimet e sistemit PAYG kur futet kolona e dytë.....	148
Grafiku 11: Balanca e skemes PAYG me kolonë të dytë të plotë.....	149
Grafiku 12: Balanca e skemes PAYG me kolonë të dytë të plotë ndaj GDP.....	150
Grafiku 13: Të ardhurat e kolonës së dytë.....	151
Grafiku 14: Numëri i kontribuesve sipas skemave.....	152
Grafiku 15: Nr i pensionistëve sipas skemave.....	152
Grafiku 16: Shkalla e zëvendësimit sipas kolonave.....	153
Grafiku 17: Nr kontribuesve sipas skemave.....	154
Grafiku 18: Nr pensionistëve të pleqërisë.....	155
Grafiku 19: Balanca/GDP.....	155
Grafiku 20: Shkalla e zëvendësimit.....	156
Grafiku 21: Balanca/GDP në të dy supozimet 10% dhe 5%.....	156
Grafiku 22: Balanca/GDP e të dy kolonave.....	157
Grafiku 23: Balanca/GDP e krahasuar me variantin bazë.....	158

Grafiku 24: Balanca/GDP e kolonës së dytë.....	159
Grafiku 25: Balance/ GDP i krahasuar për të dy opsionet.....	159
Grafiku 26: Shkalla e zëvendësimit në dy rastet.....	160
Grafiku 27: Balanca/GDP.....	161
Grafiku 28: Nr kontribuesve sipas skemave.....	162
Grafiku 29: Nr pensionistevë të pleqërisë sipas skemave.....	162
Grafiku 30: Shkalla e zëvendësimit.....	163
Grafiku 31: Balanca/GDP për kolonën e dytë.....	163
Grafiku 32: Balanca/GDP për kolonën PAYG.....	164
Grafiku 33: Krahasimim i grafikëve Balanca/GDP	164
Grafiku 34: Shkalla e zëvendësimit sipas 3 skenarëve.....	165

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Ndarja e normës së sigurimeve shoqërore dhe e sigurimit shëndetësor.....	81
Tabela 2. Skema e buxhetit të Sigurimeve Shoqërore.....	82
Tabela 3. Të dhënat dhe supozimet e përdorura në modelin PROST.....	107
Tabela 4. Indeksi i lindshmërisë.....	109
Tabela 5. Indeksi i lindshmërisë në Europë.....	109
Tabela 6. Parashikimi Botëror i Popullsisë.....	111
Tabela 7. Parashikimi i Indeksit të lindshmërisë për modelin.....	111
Tabela 8. Jetëgjatësia sipas gjinisë.....	112
Tabela 9. Parashikimi i numërit të kontribuesve për modelin.....	116
Tabela 10. Parashikimet për treguesit kryesore ekonomik.....	117
Tabela 11. Parashikimi i rritjes reale në vendet e Europës dhe Azisë Qendrore.....	120
Tabela 12. Parashikimi i treguesve kryesore ekonomike për modelin.....	120
Tabela 13. Supozimet e rritjes së pensioneve për modelin.....	121
Tabela 14. Supozime për kolonën e dytë të plotë.....	135
Tabela 15. Supozime për kolonën e dytë të pjesshme 10%.....	136
Tabela 16. Supozime për kolonën e dytë të pjesshme 5 %.....	137

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

PAYG	Skemë Pensioni mbështetur në parimin	Pay- as- you- go
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore	
PBB	Prodhimi i Përgjithshëm Bruto	
INSTAT	Instituti i Statistikave	
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar	
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës	
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara	
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik	
CIS	Komonuelthi i Shteteve të Pavarura	
DB	Përfitim i Përcaktuar	
CD	Kontribut i Përcaktuar	
NZ	Normë Zvëndesimi	
NVS	Norma e Varësisë së Sistemit	
FSSH	Fondi i Sigurimit Shoqëror	
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave	
FPP	Fondi Privat i Pensioneve	
KMA	Kompani Menaxhimi Asetesh	
BK	Bankë Kujdestare	
FSHA	Fondi Shtetëror i Akumulimit	
VSP	Sistemi Vullnetar Suplementar	
OSS	Sistem i Detyrueshëm Vullnetar	

KAPITULLI I → HYRJE

Procesi i zhvillimit të sistemit të sigurimeve shoqërore në Shqipëri i korrespondon transformimit të saj nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë. Në qendër të sistemit të sigurimeve shoqërore është skema e pensioneve. Aktualisht me pensione trajtohen rreth 20 përqind e popullsisë, me tendenca të qarta drejt rritjes së numrit të tyre. Sistemet e pensioneve janë të projektuara për të siguruar të ardhura për ata individë që vuajnë një humbje në kapacitetin e të ardhurave, si rezultat i moshës së thyer, aftësisë së kufizuar ose vdekjes së mbajtësit të familjes. Si pasojë e ndryshimeve ekonomike, sociale dhe demografike, mënyra tradicionale e organizimit të pensioneve iu nënshtrua reformave që u ndërmorrën për t'i dhënë një formë të re e më moderne sistemit të pensioneve. Megjithëse sistemi i pensioneve në Shqipëri ka kaluar një seri reformash të rëndësishme, në vitet 1993, 2002, 2005, dhe 2014 ai ende përballet me një numër sfidash. Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, krijoi një sistem të detyrueshëm, publik, me mbulim universal të sigurimeve shoqërore dhe një shtyllë suplementare vullnetare, e cila megjithëse ka një kuadër ligjor të plotësuar nuk paraqitet ende e zhvilluar. Aktualisht, sistemi i pensioneve në Shqipëri dominohet nga skema e detyrueshme publike, e cila sot menaxhohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Analiza e sistemit bën evidente problemet e funksionimit të tij në kushtet aktuale të zhvillimit ekonomik të vendit tonë. Me qëllim që sistemi të plotësojë funksionet për të cilat është ngritur, të jetë i qëndrueshëm financiarisht dhe t'i përshtatet zhvillimeve të ardhshme social-ekonomike të vendit, si alternativë e vetme mbetet vazhdimi i reformimit të tij. Nevoja më e madhe për reformim lind tek rikonceptimi i skemave. Mundësitë për të ndërmarrë reforma dhe llojet e tyre janë të shumta, por suksesi apo

dështimi i tyre varet nga sasia dhe masat që merren për sigurimin e mjeteve financiare që do të financojnë sistemin. Reformat e pensioneve, pavarësisht nga ndryshimet që kanë midis tyre, shtrihen dhe realizohen përmes kontribuesve dhe përfituesve, të cilët konsiderohen si “përfitues dhe kontribues”. Për të reformuar sistemin duhet të ndërhyhet në të dy krahët e balancës, si tek kontribuesit ashtu dhe tek përfituesit. Çdo reformë strukturore duhet të mbajë mirë parasysh rregullimet parametrike, të cilat do të jenë të nevojshme për të mbajtur në balancë skemat e pensioneve. Njerëzit që përfitojnë nga kjo, i kanë merituar të drejtat e fituara dhe natyrisht kanë të drejtë të kërkojnë më shumë për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre. Detyra e brezit aktual të punësuar, por edhe e inisiatorëve të reformave në radhë të parë është t’i garantojnë këto të drejta, t’i bëjnë ato më të qëndrueshme, por edhe të krijojnë inisiativa.

I.1. Formulimi i problemit

Një prej problemeve që hasen në skemat e pensioneve sot është plakja e popullsisë, e cila shkaktohet nga ulja e pjellorisë dhe rritja e jetëgjatësisë. Reformat që sugjerohen të ndërmerren në sistemet e pensioneve vlerësohen në lidhje me qëndrueshmërinë financiare të skemave dhe drejtësinë rishpërndarëse midis brezave dhe brenda brezave. Si pikë referimi për rishpërndarjen, kërkohet që të gjithë brezat me pjellorinë dhe jetëgjatësinë e njëjtë duhet të paguajnë proporcionin e njëjtë të kontributit për pensionet për të fituar në të njëjtën shkallë të drejtat dhe moshën e daljes në pension. Meqenëse faktorët demografikë ndryshojnë nga një gjeneratë në tjetrën duhet gjithashtu të përfitojnë pensionet dhe/ose normën e zëvendësimit të ndryshme. Sistemi Shqipëtar i pensioneve i modelit PAYG, është gjithmonë i qëndrueshëm nëse kontributet janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet në të njëjtin moment kohor. Në situatën ku

plakja e popullsisë sa vjen e rritet kjo paraqet një barrë të padrejtë për ndarjen midis brezave. Një sugjerim në këtë model do të ishte, ai brez i cili redukton pjellorinë dhe/ose jeton më gjatë së paraardhësit e tij, duhet të paguajë përkatësisht më shumë për të njëjtën shkallë zëvendësimi dhe/ose moshe dalje në pension. Kështu kur kemi kohën e përfitimit, të ardhurat nga kontributet duhet të tejkalojnë shpenzimet e pensioneve, duke krijuar një fond. Kjo nënkupton që normat e kontributeve në vazhdim duhet të rriten në mënyrë drastike, duke çuar në akumulimin e fondeve të pensioneve mbi 150% të PBB-së për gjatë shumë vitet të ardhshme.

Madhësia e fondit të parashikuar për shpërndarjen e kontributeve duhet të jetë e madhe, por duke qenë se normat e kërkuara të kontributeve janë mjaft të larta kjo e bën reformën të pa mundur për tu realizuar dhe jorealiste si një propozim për reformën e sistemit të pensioneve. Megjithatë, kuptimi dhe mesazhi i këtij parashikimi të kësaj skeme të sistemit të pensioneve është tejet i rëndësishëm: të gjithë individët duhet të informohen për atë se çfarë duhet të paguajnë në sistemin e pensioneve publike nëse duan të ruajnë nivelin e përfitimeve aktuale dhe moshën e pensionit dhe gjithashtu nëse duan të jenë të drejtë ndaj brezave të ardhshme. Nëse ata nuk janë të përgatitur për të paguar këtë çmim, atëherë ata duhet - individualisht dhe kolektivisht - të pranojnë reformat e pensioneve në të cilën do të përfshihet reduktimi i shkallës së zëvendësimit dhe/ose rritjen e moshës së daljes në pension.

Futja e kolonës së dytë rezulton jo shumë e prekur nga kjo rritje, pasi reduktimi i shkaktuar i shpenzimeve të pensioneve dhe rritja e të ardhurave të kontributeve në afat të shkurtër nuk duhet menjëherë të sjellin norma më të ulëta të kontributit. Përkundrazi, suficiti i shkaktuar duhet të ruhet për mbulimin e shpenzimeve të ardhshme.

Sapo të vendoset rasti me një shtyllë të dytë, lind pyetja rreth menaxhimit të fondeve akumuluese, përveçse rastit kur qeveria ka një borxh të madh dhe përdor fondet akumuluese për zvogelimin e borxhit. Në raste të tjera, mund të krijohen institucione të veçanta për t'i vendosur këto fonde.

Pavarësisht nga qëndrimet ndaj rolit të shtetit, futja e një shtylle të dytë duke devijuar një pjesë të pagesave të kontributeve në të mund të bëhet tërheqëse. Një shtyllë e dytë plotësisht e financuar e bën lidhjen më të fortë midis kontributeve dhe përfitimeve, prandaj është aktualisht e drejtë dhe zvogëlon shtrebrërimet e tregut të punës. Duhet të theksohet, megjithatë, se kjo arrihet në kurriz të përkeqësimit të shtyllës së parë të menaxhuar publikisht në të njëjtat aspekte.

I.2. Synimi dhe qëllimi i studimit .

Ky punim nëpërmjet një analize përshkruese të sistemit të pensioneve në Shqipëri, synon të identifikojë problematikat dhe sfidat për zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të pensioneve në kontekstin e zhvillimit social-ekonomik të vendit. Qasja e re e paraqitur në këtë punim për reformimin e një sistemi me shtyllë të dytë përkrah asaj PAYG është e dobishme pasi ndihmon në diversifikimin e rreziqeve të ndryshme është një shtesë dhe përforcon rastin për zbatimin e parafinancimit. Për më tepër, fondet mund të lehtësojnë shtrebrërimet e tregut të punës, të rrisin kursimin e përgjithshëm dhe PBB-në, dhe gjithashtu të çojnë në kthime më të larta në përfitimet e pensioneve. Këto janë efekte shtesë pozitive të futjes së kolonës së dytë.

I.3 Objektivat e Studimit

Objektivi i këtij studimi është analiza e sistemit Shqipëtar të pensioneve dhe ballafaqimi me modelet e vendeve të tjera të ngjashme me vendin tonë. Nëpërmjet kësaj analize synojmë të vërtetohet aftësia e sistemit të pensioneve për të përballuar sot edhe në të ardhmen pagesën e pensioneve (qëndrueshmëria financiare) si dhe të ofrohen alternativa për arritjen e tij. Për arritjen e këtij objektivi ky punim ka për synim të identifikojë :

- Studimin e modeleve më të aplikuara në fushën e sigurimeve shoqërore dhe identifikimin e modelit që përafrohet në realitetin shqipëtar.
- Analizimin e faktoreve që ndikojnë në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e skemës së sigurimeve shoqërore.
- Analizimin dhe vlerësimin e skemës egzistuese në lidhje me qëndrueshmërinë financiare.
- Sugjerimi i reformave të mëtejshme në sistemin e pensioneve duke përmirësuar modelin aktual nëpërmjet futjes së kolonës së dytë për krahasim me sistemin PAYG egzistues.

I.4. Hipoteza dhe pyetjet e kërkimit

Hipoteza: Reformimi i mëtejshëm i sistemit të pensioneve duke futur kolonën e dytë përmirëson qëndrueshmërinë financiare të skemës së pensioneve në shqipëri.

Për arritjen e këtij qëllimi kemi përcaktuar pyetjet kërkimore si më poshtë:

1. Cilat do të jenë kontributet, përfitimet, të ardhurat dhe nevojat potenciale për subvencione afatgjata për mbulimin e defixhitit ? Do të jetë i zbatueshëm dhe i qëndrueshëm sistemi në periudha afatgjata?

2. Çfarë lloj përfitimesh mund të presin njerëzit për të marrë në të ardhmen? A do të sigurojë sistemi i pensioneve të ardhura të mira pas daljes në pension për kategori të ndryshme të njerëzve?
3. Sa të mëdha janë detyrimet e nënkuptuar të qeverisë për sistemet e pensioneve me futjen e shtyllës së dytë? A do të jete në gjendje qeveria për të plotësuar këto detyrime?

I.5. Metodologjia

Metodologjia e studimit

Në përputhje me qëllimin e këtij studimi është bërë një analizë e hollësishme e sistemit të pensioneve, bazuar edhe në të dhënat statistikore publikuar nga ISSH, për të parë ndikimin e ndryshimeve sistematike dhe parametrike mbi qëndrueshmërinë financiare të sistemit. Gjithashtu janë përdorur metoda statistikore në përpunimin e të dhënave, për të përcaktuar shkallën e ndikimit të faktorëve demografike dhe makroekonomikë mbi mënyrën e konceptimit të skemave të pensioneve dhe të qëndrueshmërisë financiare të tyre.

Faza e parë - Studimi i literaturës

Studimet në fushën e pensioneve në vendin tonë janë të kufizuara. Shumica e atyre të kryera janë të vetë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Literatura botërore është shumë e pasur me studime dhe artikuj në fushën e sigurimeve, të kolonave të sigurimeve e të fondeve të pensioneve. Ne jemi munduar të shfrytëzojmë të gjithë literaturën sidomos atë që ka lidhje me vende të ngjashme me Shqipërinë, jo vetëm me vendet e Europës lindore por edhe me vende të tjera.

Sistemi bazë për hartimin e këtij studimi është ai i mbështetur gjerësisht nga Banka Botërore pra, sistem shumë kolonësh. Ne jemi mbështetur gjithashtu në studimin teorik të klasifikimit të sistemit të pensioneve në plane të pensioneve, fonde të pensioneve, ente të pensioneve si dhe në dy qasje kryesore, atë funksionale dhe atë institucionale dhe më pas puna jonë ka vijuar me përcaktimin e variablave kryesore që duhet të shqyrtoheshin në studim.

Gjatë punimit jemi përpjekur t'u japim përgjigje hipotezave që kemi ngritur në fillim të kapitujve.

Faza e dytë - Mbledhja e të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave kanë qenë raportet dhe statistikatat e ISSH-së. Duke dashur të përfshijmë të dhëna të një periudhe sa më të gjatë kohore në studim kemi arritur të sigurojmë të dhëna nga ISSH që nga viti 1994, vit kur u prezantua për herë të parë sistemi aktual i pensioneve në Shqipëri. Gjithashtu një burim tjetër i rëndësishëm i të dhënave tona ka qenë INSTAT. Po ashtu është shfrytëzuar database i Bankës së Shqipërisë, FMN-së, Bankës Botërore etj.

Faza e tretë – Analiza e të dhënave

Punimi është bazuar në analiza dhe parashikime për të cilat janë bërë shumë përllogaritje dhe në përfundim është gjykuar që të gjitha përllogaritjet të përdoren për analizën aktuariale mbi bazën e së cilës është bazuar dhe vërtetimi i qëndrueshmërisë të skemave të pensioneve.

Gjithashtu nëpërmjet programit statistikor PROST u realizua analiza sasiore e të dhënave për një periudhë 50 vjeçare, duke përdorur metodën e regresionit të thjeshtë dhe të shumëfishtë linear duke treguar ndikimin probabilitar dhe strukturor të disa treguesve ekonomikë si variabla të pavarur në defiçitin e skemës si variabël i varur.

I.6. Rëndësia e studimit

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të kontribuojë në drejtim të debatit mbi reformat e sistemit të pensioneve në Shqipëri, veçanërisht në lidhje me rregullimin e mundshëm parametrik të sistemit aktual. Ky studim ngre debatin për hartim të një sistemi shumë shtyllësh dhe në vendin tonë. Pikërisht futja e kolonës së dytë do të sillte një risi në sistemin shqipëtar dhe do të sillte dhe një qendrueshmëri më të lartë financiare dhe një garanci për të ardhmen e skemës.

I.7. Kufizimet e studimit

Ky studim ka dhe kufizimet e tij.

Së pari, është supozuar që në projektimin afatgjatë të sistemit të merren parashikime për tregues të ndryshëm demografike dhe makroekonomike. Pavarësisht supozimeve të marra për këta tregues, ata mund të mos ecin me ritmet e parashikuara të supozimeve dhe për këtë arsye të ketë kufizime në parashikimet e programit për tregues të ndryshëm të skemës së pensioneve.

Së dyti, është parashikuar që për kolonën e dytë të egzistojnë dhe strukturat mbështetese të nevojshme për ecurinë e këtyre kolonave, mos egzistenca e tyre është një pengesë. Ngritja e tyre kërkon një kohë dhe dëshirë politike, e cila çon në kufizimin e zbatimit të futjes së kolonës së dytë përkrah kolonës PAYG egzistuese.

Së treti, reformimi i skemave të pensioneve në Shqipëri është më shumë dëshirë politike sesa një alternative e nevojshme dhe e domosdoshme socio-ekonomike. Prandaj ky impenjim politik e bën të vështirë zbatimin dhe marrjen në konsideratë të përfundimeve dhe sugjerimeve të studimit.

KAPITULLI II → VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI SIGURIMET SHOQËRORE DHE SISTEMET E PENSIONIT

II.1 Parimet dhe funksionimi i sigurimeve shoqërore

II.1.1 Koncepti i sigurimeve shoqërore

Termi "sigurime shoqërore" e ka origjinën e vet në politikën e mirëqenies të presidentit Franklin D. Roosevelt gjatë viteve 1930. Në vitin 1934 Roosevelt anoncoi një program për "sigurimin ndaj rreziqeve dhe peripecive të jetës" (Partsch, 1983: 14). Në 1935 ky anoncim u pasua nga "Akti i Sigurimeve Shoqërore".¹ Në vitin 1948 sigurimet shoqërore u shpallën zyrtarisht si e drejtë e njeriut në nenin 22 të Deklaratës së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara. Në vitin 1952, ILO paraqiti një përkufizim përfundimtar të sigurimeve shoqërore në Konventën Nr.102. Në ditët tona ato janë një komponent i rëndësishëm i politikave të mirëqenies të të gjitha vendeve të industrializuara.

Në vitin 2001, ILO përkufizoi sigurimet shoqërore si mbrojtja që një shoqëri ofron për individët dhe familjet në sigurimin e aksesit në kujdesin shëndetësor dhe për të garantuar sigurinë e të ardhurave, sidomos në rastet e pleqërisë, papunësisë, sëmundjeve, invaliditetit, lëndimeve në punë, shtatzanive ose humbjeve të mbajtësit të familjes.

Në Qershor 2012, Konferenca 101 e ILO-s miratoi një standart të ri ndërkombëtar për sigurimet shoqërore, Rekomandimin mbi Nivelet Minimale të Mbrojtjes Shoqërore,

¹ Emertimi i Aktit të Sigurimeve Shoqërore është një tregues të asaj që është kuptuar tashmë për sigurimet shoqërore: "Një akt për të siguruar mirëqenien e përgjithshme, duke krijuar një sistem të përfitimeve të pleqërisë, dhe duke bërë të mundur që disa shtete të marrin masa më adekuate për personat e moshuar, personat e verbër, fëmijët në ngarkim dhe të gjymtuar, mirëqenien nënës dhe fëmijës, shëndetin publik, si dhe administrimin e ligjeve të tyre të kompensimit të papunësisë, për të krijuar një Bord të Sigurimit Social, për të rritur "të ardhurat; dhe për qëllime të tjera" (citim nga Partsch 1983: 15, footnote 10).

2012 (Nr. 202)², e cila plotëson strategjinë e sigurimeve shoqërore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Ky Rekomandim shoqëron standardet egzistuese të sigurimeve shoqërore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe ofron “një udhëzim fleksibël, por të qartë, për vendet anëtare në ndërtimin e Niveleve Minimale të Mbrojtjes Shoqërore brenda sistemeve të plotë të sigurimeve shoqërore, të ndërtuara në përputhje me situatat dhe nivelet e zhvillimit kombëtar”³(ILO, 2013).

Strategjia dy-dimensionale e ILO-s jep udhëzime të qarta mbi zhvillimin e ardhshëm të sigurimeve shoqërore të vendeve, pavarësisht nivelit të zhvillimit të tyre. Strategjitë efektive kombëtare për shtrirjen e sigurimeve shoqërore, në përputhje me rrethanat e vendit, duhet të synojnë të arrijnë mbrojtje universale për popullatën duke siguruar të paktën nivelin minimal të sigurimit të të ardhurave dhe mundësisht të kujdesit shëndetësor elementar (dimensioni horizontal) dhe duke siguruar në mënyrë progresive nivele të larta mbrojtje, të udhëhequra nga standardet e fundit të ILO-s për sigurimet shoqërore (dimensioni vertikal) (Figura 1).

Në përputhje me prioritetet, burimet dhe rrethanat kombëtare, këto strategji dy-dimensionale duhet të synojnë në ndërtimin dhe mbajtjen e sistemeve të plotë dhe të përshtatshëm të sigurimeve shoqërore.

² Rekomandimi në lidhje me bazat kombëtare të mbrojtjes shoqërore (Rekomandimi për Bazat e Mbrojtjes Shoqërore), 2012 (Nr. 202).

³ Rezoluta dhe konkluzionet në lidhje me diskutimet periodike mbi mbrojtjen shoqërore (sigurimet shoqërore), 2011, para. 31.




Figura 1. Strategjia dy-dimensionale për zgjerimin e sigurimeve shoqërore.

II.1.2 Parimet e sigurimeve shoqërore

Të gjitha instrumentet e fundit ILO-s mbi sigurimet shoqërore ndajnë të njëjtin vizion dhe për këtë arsye kanë të përbashkëta një numër parimesh⁴. Ata implementojnë të drejtën e njeriut për siguri sociale të përfshirë në traktatet e ndryshme të OKB-së. Ato janë të bazuara mbi solidaritetin dhe pjesëmarrjen; mbulimi i tyre është universal dhe sigurimi i tyre është mjaft fleksibël për t'u aplikuar në vende të ndryshme; ato financohen nga pagesat e llogaritura në bazë të pagës ose nga tatimet, dhe menaxhohen nga institucionet përgjegjëse. E drejta e përfituesve ndjek të njëjtin model (Servais, 2014).

⁴ Parimet janë parashtruar në Rekomandimin e ILO-s, Nr. 202, para.3.

Parimi i Universalitetit — Që nga vitet 2000, universaliteti ka ri-hyrë në axhendën e zhvillimit. Tani është koha për mbrojtje sociale universale. Për Bankën Botërore dhe Organizaten Nderkombetare të Punës, mbrojtja sociale universale i referohet një grupi të integruar të politikave të hartuara për të garantuar sigurinë e të ardhurave dhe mbështetje për të gjithë njerëzit gjatë gjithë ciklit të jetës - duke i kushtuar vëmendje të veçantë të varfërve dhe grupeve vulnerabel (ILO & World Bank, 2015).

Të gjitha sistemet e sigurimeve shoqërore ndërtohen ose funksionojnë sipas këtij parimi. Një sistem sigurimi shoqëror duhet të mbulojë dhe të ofrojë mbrojtje shoqërore për të gjithë individët e një shteti dhe të shmangë diskriminimin për sa i përket aksesit në shërbime. Me këtë parim nënkuptohet që të gjithë qytetarët që janë në një marrëdhënie pune, sigurojnë të ardhura nga puna e vet nëpërmjet pagës, ose ndryshe të gjithë personave ekonomikisht aktivë, duhet të mbulohen dhe të kenë akses në shërbimet dhe përfitimet që ofrojnë sigurimet shoqërore. Personat ekonomikisht aktivë janë të vetëpunësuarit, punëmarrësit dhe punëdhënësit. Në respekt të këtij parimi nuk mund të mbeten pa mbulim dhe pa akses në shërbime të sigurimeve shoqërore asnjë individ apo grupim ekonomikisht aktiv.

Ky parim nuk do të thotë që të gjithë njerëzit në nevojë ose që kanë nevojë për mbështetje dhe mbrojtje do të përfitojnë nga sigurimet shoqërore. Sipas këtij parimi sistemi ju ofron mbrojtje të gjithëve pa dallim, por kur kanë plotësuar kriteret e përcaktuara për përfitim ose mbrojtje nga sigurimet shoqërore. Ky parim nuk bie ndesh me parimet e tjera dhe nuk kufizon përfitimin e mbrojtjes nga struktura të tjera qofshin sigurime private kolektive apo individuale.

Parimi i Uniformitetit — Sipas këtij parimi sistemi i sigurimeve shoqërore duhet të jetë uniform për të gjithë shtetasit, që do të thotë që të gjithë shtetasit duhet të trajtohen

njëlloj përsa i përket sigurimeve shoqërore. Ky parim nuk do të thotë që të gjithë duhet të trajtohen “në mënyrë të barabartë”, por të trajtohen të gjithë sipas të njëjtave standarde dhe bazë ligjore. Pavarësisht nga statusi shoqëror që ka një individ ai trajtohet në bazë të të njëjtave rregulla, kritere dhe mënyre llogaritje dhe përcaktimi të një përfitimi. Edhe sipas këtij parimi nuk përdoren standarde të ndryshme për kategori të ndryshme qytetarësh, grupesh, etnish, racash dhe gjinie. Edhe ky parim nuk bie ndesh me përfitimin e ndihmave të ofruara nga sisteme të tjera sipas parimit “as sa është nevoja”, karakteristikë e sistemeve që financohen nga taksat e përgjithshme.

Parimi i Kompleksitetit — Sipas këtij parimi mbulimi i personave ekonomikisht aktivë realizohet jo vetëm nga një skemë ose përfitim, por nga një sërë përfitimesh ose skemash. Sigurimet shoqërore nuk ofrojnë mbrojtje vetëm për një paaftësi p.sh., nuk ofrojnë vetëm pension pleqërie, si rezultat i paaftësisë moshore, por edhe për paaftësi të tjera të që mund të jenë; përfitime paaftësie, përfitime aksidenti, përfitime papunësie etj . Gjithashtu, përveç përfitimeve bazë ofrohen edhe përfitime të tjera të kombinuara, më qëllim që të realizohet një mbrojtje shoqërore më e mirë dhe e sigurtë. P.sh., përveç pensionit ofrohen edhe një sërë kompensimesh të tjera ose përfitime nga skema të tjera. Invalidët e punës që përfitojnë pension invaliditeti për arsye të paaftësisë së tyre për të punuar, përfitojnë edhe një përfitim tjetër që ofrohet nga buxheti i shtetit për të përmbushur nevojat e tyre jetësore.

Parimi i mjaftueshmërisë — Tre parimet e mësipërme sigurojnë një mbulim tërësor të popullsisë, trajtim të njëjlojtë (jo të barabartë) dhe mbulim kompleks. Por nga ana tjetër, përfitimi ose shërbimi që merr një individ duhet të jetë edhe i mjaftueshëm. Megjithëse mund të zbatohen parimet e tjera në mënyrë perfekte, n.q.s. përfitimi ose shërbimi është i pamjaftueshëm, atëherë sistemi nuk është efektiv dhe efikas. Sipas këtij parimi masa

e përfitimit duhet të jetë në nivel të tillë që të plotësojë nevojat kryesore jetësore të përfituesit.

Mjaftueshmëria e përfitimit është një nga parimet bazë sepse sistemi i sigurimeve shoqërore luan një rol shumë të rëndësishëm në ombrellën e mbrojtjes shoqërore. Në rast se përfitimet e dhëna nga sigurimet shoqërore janë të pamjaftueshme, atëherë qytetarët do të drejtoheshin dhe do të kërkonin përfitime nga skemat e tjera të mbrojtjes sociale, si ndihma ekonomike, etj. Kjo pamjaftueshmëri do të minonte qëllimin e sigurimeve shoqërore dhe në vend të uljes së barrës sociale të shoqërisë, do ta shtonte atë. Gjithashtu, pamjaftueshmëria do të kishte efekte shumë negative përse i përket numrit të kontribuesve pjesëmarrës në skemë, besueshmërisë së sistemit, si dhe efekte në informalitetin e tregut të punës.

Parimi i Garancisë — Ky parim ka të bëjë me garancitë që duhet të ofrojë një sistem i sigurimeve shoqërore ndaj pjesëmarrësve të tij. Individët që janë pjesëmarrës direkt dhe indirekt në sigurimet shoqërore duhet të kenë garancitë e nevojshme për të vazhduar kontributin dhe pjesëmarrjen në këtë sistem. Garancitë ndahen në dy kategori, ligjore dhe ekonomike.

Garancitë ligjore nënkuptojnë që pjesëmarrësit duhet të kenë garancinë që ndryshimet e mundshme që mund t'i bëhen ligjit që administron sigurimet shoqërore nuk do t'i prekin të drejtat dhe nuk do të ndikojnë në marrëdhëniet tashmë të realizuara. Rasti më tipik është bërja e një reforme në sistemin e sigurimeve shoqërore. Në rast se bëhet reforma dhe kemi ndryshime të kriterëve për llogaritje ose ndryshime të parametrave të sistemit, atëherë këto ndryshime nuk mund të reflektohen tek përfitimet e llogaritura dhe të marra sipas kriterëve të mëparshme. P.sh., nëse ndryshon mosha e daljes në pension nga 65 në

67 vjeç, atëherë për të gjithë pensionistët që kanë dalë në pension para hyrjes në fuqi të ndryshimit të ligjit nuk mund të aplikohet kriteri i ri i moshës (67 vjeç).

Aspekt tjetër i këtij parimi është garantimi i të drejtës së individit për zgjidhjen e pretendimeve personale nëpërmjet ndjekjes së rrugës ligjore të përcaktuar.

Garancia ekonomike ka të bëjë me garancinë që ndryshimet e ligjit nuk mund të prekin nga pikëpamja ekonomike përfitimet tashmë të caktuara dhe paguara. Në rast të ndryshimeve të masave për përfitime ose të kriterëve ekonomike të ligjit, përfitimet e lidhura nuk mund të ndryshohen. Një e drejtë e fituar nuk mund të rishikohet dhe të ndryshohet. Ky parim shprehet në garancinë që jep shteti në rast të pamjaftueshmërisë financiare të sigurimeve shoqërore për të paguar përfitimet e përcaktuara, nëpërmjet subvencioneve të buxhetit të shtetit, si dhe të garancive të stabilitetit ekonomik të një vendi. Ky parim është një parim i rëndësishëm sidomos në vende me ekonomi të pazhvilluar mirë ose të vendeve në zhvillim.

Parimi i pjesëmarrjes — Ky parim ka të bëjë me pjesëmarrjen e individëve në sistemin e sigurimeve shoqërore dhe ka dy aspekte: Pjesëmarrjen ligjore dhe Pjesëmarrjen ekonomike

Pjesëmarrja ligjore nënkupton të drejtën që kanë individët, grupimet e individëve, shoqatat e ndryshme jo qeveritare, për t'u bërë pjesëmarrës nëpërmjet iniciativave ligjore në kontrollin dhe drejtimin e sigurimeve shoqërore. Sipas këtij parimi nuk do të thotë që individët apo grupimet e ndryshme mund të hyjnë në çdo kohë dhe në çdo aspekt të drejtimit apo kontrollit të veprimtarisë së sigurimeve shoqërore. Të drejtën për të marrë nisma ligjore e ka qeveria, vetë institucioni që administron skemën, bordet drejtuese, pushteti legjislativi, etj. Por, këtë të drejtë e kanë edhe pjesëmarrësit në skemë, nëpërmjet iniciativave individuale ose të grupimeve të ndryshme që ata kanë, si

p.sh., sindikatat, shoqatat e biznesit, etj. Gjithashtu, organet drejtuese janë të kompozuar sipas parimit të pjesëmarrjes trepalëshe (three partite), që do të thotë se në to ka pjesëmarrje të shtetit, të punëmarrësve dhe të punëdhënësve

Pjesëmarrja ekonomike realizohet nëpërmjet pagimit të kontributeve nga personat ekonomikisht aktivë. Që një sistem i sigurimeve shoqërore të funksionojë, duhet që pjesëmarrësit e tij të paguajnë kontributet. Pjesëmarrës është edhe shteti nëpërmjet subvencionimit ose financimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore. Pagimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore është burimi kryesor i financimit të sigurimeve shoqërore. Mospagimi i tyre do të vinte në vështirësi sistemin, rritjen e subvencionit nga buxheti i shtetit dhe humbjen e qëllimit të krijimit të vetë sistemit, që është financimi i përfitimeve që merr individi nga sigurimet shoqërore, nga vetë ai nëpërmjet kontributit mujor.

II.2 Roli i sistemeve të pensionit

II.2.1 Origjina dhe sistemet e para të pensioneve në botë

Planet e pensioneve kanë një histori të hershme⁵, por u bënë më të njohura në prag të industrializimit dhe urbanizimit. Holzmann & Hinz (2005) paraqesin krijimin e sistemeve moderne të pensioneve, si një reagim ndaj ndryshimeve social-ekonomike të shekullit të nëntëmbëdhjetë, duke theksuar se “meqenëse individët u larguan nga struktura tradicionale e familjes bujqësore, ishte e nevojshme të krijoheshin marrëveshjet formale të manaxhimit të riskut që mund të zëvendësonin marrëveshjet informale që u shkatërruan përballë tranzicionit”⁶. Programet e transferimit të të

⁵ Në Mbretërinë e Bashkuar skema e parë e pensionit për oficerët e Marines Mbreterore u krijua në vitin 1670 (BBC, 2002).

⁶ Caucutt etj., (2007) shpjegon gjithashtu shfaqjen e sigurimeve shoqërore në SHBA në aspektin e levizjes së popullsisë nga zonat rurale në ato urbane. Ky migrim konsiderohet të ketë çuar në mbështetjen politike

ardhurave shtetërore tek personat e moshuar mund të gjurmohen në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë, për herë të parë në Gjermani dhe Danimarkë. Arsytet pse pensionet janë të krijuara në këto dy vende duket se ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Në Gjermani, kancelari Bismark ishte i interesuar “për të lidhur” interesat e punëtorëve me shtetin e ri gjerman (Palacios & Sluchynsky, 2006), ndërsa skema Daneze u prezantua si një menyrë e administrimit në nivel lokal - skemë e testuar për qytetarët në nevojë mbi moshën 60 vjec. Ky dallim pasqyron dy qëllime dukshëm të ndryshme, në rastin Gjerman: një nevojë për stabilitetin e të ardhurave gjatë jetës - sigurisht, dhe në rastin e Danimarkës: nevojën për të zbutur varfërinë gjatë pleqërisë. Këto dy synime kanë karakterizuar sistemet e pensioneve gjatë dekadave, dhe ndërsa disa sisteme mbeten në retorikën e politikës fokusuar në një qëllim të veçantë, në ditët e sotme, shumica e sistemeve të pensioneve ju shërbejnë të dy qëllimeve.

Pas dekadave të debatit dhe, në disa raste, ngecjeve politike, shumë vende filluan reforma të rëndësishme të pensioneve, duke përfshirë moshat e daljes në pension, ndryshimet në mënyrën e llogaritjes së përfitimit dhe masa të tjera për të futur kursimet në sistemet e tyre pensionale (OECD, 2013). Vende të ndryshme kanë skema shumë të ndryshme të pensioneve, por vala e reformave përballet me shumë sfida të ngjashme: si për të siguruar që sistemet e pensioneve janë financiarisht të qëndrueshme, ashtu edhe për t’u dhënë qytetarëve të ardhura të mjaftueshme pas daljes në pension.

II.2.2 Përse shërbejnë sistemet e pensioneve?

Në shumicën e shoqërive tradicionale, janë familjarët që kujdesen për individët të cilët arrijnë në moshë të vjetër, bëhen të paaftë, apo vuajnë nga humbja e një anëtarit të

për sigurimet shoqërore duke qenë se individët nuk do të mund të mbështetet më në toka si një burim për të ardhurat e pleqërisë.

familjes. Megjithatë, edhe në këto raste, jo të gjithë individët kanë fëmijë që të kujdesen për ta ose komuniteti apo familja janë shumë të varfër për të ofruar kujdesin e duhur, ose e thënë ndryshe nuk janë në gjendje apo të gatshëm për të bërë këtë (Schëartz, 2006). Ashtu si kundër shoqëritë modernizohen dhe njerëzit lëvizin nga komunitetet në të cilat ato janë rritur, lidhjet brenda komunitetit dhe familjes dobësohen dhe mund të lënë të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, pa një rrjet sigurie të përshtatshëm. Individët mund të përpiqen për të shpëtuar nga mungesa e kësaj sigurie sociale në mënyra të ndryshme, si grumbullimi i vlerave monetare, i pasurive të ndryshme apo dhe investimeve për të përfituar prej tyre më vonë. Por, në mungesë të tregjeve të sigurta financiare për personat që realizojnë të ardhura, kursimet shpesh investohen në formën e pasurive të patundshme, të cilat vuajnë në sigurinë e tyre nga luhatjet e çmimeve dhe pasiguria afatgjatë. Për këto arsye, qeverite shpesh ndërtojnë disa lloje të sistemeve të mbrojtjes sociale në dispozicion të individit.

Edhe në vendet e zhvilluara, në të cilat tregjet e sigurta financiare ekzistojnë, qeveritë shpesh mbështetjen ndaj individit e shohin në pensionet e drejtpërdrejtë ose në planet e pensioneve të ofruara nga fondet ose ofruesit e pensioneve private. Schëartz (2006) rendit dy arsyet me të cituara, të cilat zakonisht shtyjnë qeveritë për t'i përfshirë ato në ngritjen e sistemeve të pensioneve për të parashikuar apo dhe detyruar personat për të marrë pjesë në sistemet e mbrojtjes sociale apo thënë ndryshe në skemat e pensioneve shtetërore apo private. Së pari, punëtorët mund të vuajnë nga "miopi" dhe nuk mendojnë për moshën e vjetër, kur ata janë të rinj dhe të shëndetshëm. Deri në kohën që ata të fillojnë të shqetësohen për moshën e vjetër, kjo mund të jetë tepër vonë për ta që të marrin masa për të siguruar për veten e tyre.

Sipas Feldstein (1987), çdo shoqëri duhet të zgjidhë problemin e mbështetjes për ata individë që bëhet shumë të vjetër për të punuar, por nuk kanë bërë përgatitje adekuate për moshën e tyre të vjetër, duke kursyer kur ata ishin të rinj. Gjetja e zgjidhjeve për këtë problem është, në një masë të madhe, e varur nga kushtet specifike të shoqërive të veçanta, faza e tyre në tranzicionin demografik dhe zhvillimin ekonomik, si dhe nga natyra e institucioneve.

Së dyti, punonjësit mund të bëhen subjekt i “pengesave morale (moral hazard)” sepse konsumojnë më shumë kur janë të rinj, me shpresën se shoqëria do të kujdeset për ta, kur ata janë të vjetër. E vetmja mënyrë që qeveritë mund të kufizojnë shpenzimet sociale të kujdesit për të moshuarit është të kërkojnë pjesëmarrje në një plan pensioni për ata individë të cilët mund ta përballojë atë gjatë periudhës së punës dhe me transfertat e drejtpërdrejta të qeverisë për të ata njerëz që janë shumë të varfër dhe nuk kanë qenë në gjendje për të ruajtur nëpërmjet siguracioneve të detyrueshme gjatë viteve të tyre të punës.

II.2.3 Objektivat e një sistemi pensioni

Një vlerësim i politikës së pensioneve kërkon një përcaktim të qartë të setit të objektivave si një benchmark për performancën e sistemeve të implementuara (Mattil, 2006:7). Sistemet e mbrojtjes sociale dhe në veçanti sistemet pensionale janë ngritur me qëllim që të realizojnë disa objektiva, ato mund të jenë të shumta dhe varen nga lloji i skemës së projektuar, por të gjithë kanë disa objektiva dhe më kryesoret mund t'i përmbledhim më poshtë:

Së pari, sistemi i pensioneve ka një karakter ndihmës: ai përpiqet për të lehtësuar varfërinë (Barr dhe Diamond, 2008). Ky funksion përfshin mbështetjen financiare të

njerëzve të paaftë për të punuar për shkak të moshës apo aftësisë së kufizuar. Një sasi minimale e të ardhurave duhet të jetë e garantuar për ata njerëz edhe pse ata nuk paguajnë nivelin e nevojshëm të kontributit për të marrë përfitimin përkatës minimal.

Së dyti, sistemi i pensioneve përfshin një funksion parandalues i cili duhet të garantojë të njëjtat standarde të jetesës si gjatë aktivitetit të punës edhe pas daljes në pension për popullatën në pension. Përndryshe, njerëzit e moshës në pension nuk kanë mjetet e nevojshme për të ruajtur një nivel të njëjtë të pasurisë për vete dhe për familjet e tyre (Passini, 2004). Në fakt, Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO, 1952) sugjeron një standard minimal prej 40 për qind e pagës së një individi për 30 vjet punë⁷.

Së treti, një sistem i pensioneve përmban një funksion social – ekonomik: kontributet e akumuluarat të pensionit mund të investohen në favor të zhvillimit ekonomik të vendit dhe të kthehen për të punësuarit në një periudhë të mëvonshme në kohë, në formën e lehtësimit të varfërisë apo shpërndarjes të rregullt të ardhurave të pensionit (Passini, 2004).

Ndërsa objektivi i parë mund të vlerësohet si një mekanizëm për të luftuar varfërinë dhe si një rishpërndarje në një shoqëri, objektivi i dytë plotëson atë të vazhdimësisë në të ardhura: ata njerëz që fitojnë më shumë dhe që konsumojnë më shumë gjatë viteve të tyre të punës duhet të vazhdojnë të marrin më shumë dhe të konsumojnë më shumë gjatë viteve të tyre të daljes në pension. Ky funksion e bën sistemin e pensioneve të ndryshëm nga pothuajse të gjitha format e tjera të shpenzimeve qeveritare apo nga format e ndryshme të rishpërndarjes. Për shembull, po të marim rastin e shpenzimeve për arsimin, ideale do të ishte, që të mos kishte ndryshime në shpenzimet për nxënës, të bazuar në nivelin e të ardhurave të nxënësve, ose, nëse ka, qeveria duhet të

⁷ Article 65, ILO Convention No. 102, Social Security (Minimum Standards) Convention.

përqëndrohet në shpenzimet e saj për nxënësit e varfër, me argumentin se shpenzimet qeveritare mendohen për të plotësuar nevojat e personave më të varfër. Një argument i ngjashëm mund të bëhet për shpenzimet e kujdesit shëndetësor, ose shpenzimet e investimeve për rrugë apo energji elektrike. Idealisht, nga shpenzimet e qeverisë duhet të përfitojnë të gjithë anëtarët e shoqërisë në mënyrë të barabartë ose ato duhet të jetë të targetuara për individët me të ardhura më të ulta.

Ndërsa objektivi i parë i sistemit të pensioneve, që është reduktimi i varfërisë, mund të realizohet përmes shpenzimeve të përgjithshme, objektivi i dytë i skemave të pensioneve realizohet zakonisht nga kontributet e punonjesve. Zakonisht, punonjësit derdhin kontribute të bazuar në të ardhurat e tyre dhe presin të marrin pensionet, që janë të bazuara në derdhjet e tyre të bëra gjatë gjithë kohës së tyre të punës. Megjithatë, financimi i sistemeve të pensioneve me kontribute, të cilat janë llogaritur në bazë të pagave, paraqet një seri të re të problemeve nga pikëpamja e varfërisë dhe ndikimit social. Ai bën pothuajse të pamundur mbledhjen e kontributeve nga punonjësit të cilët nuk janë pjesë e sektorit formal. Përcaktimi i të ardhurave për grupe të tilla si fermerët dhe të vetë-punësuar është i vështirë. Informaliteti i lejon punëdhënësit për të shmangur jo vetëm kontributet që lidhen me punësimin dhe tatimin mbi të ardhurat, por edhe plotësimin e kushteve minimale të sigurisë teknike dhe zbatimin e rregullave dhe ligjeve në fuqi për punonjësit. Si rezultat, shumë punonjës në vende të ndryshme nuk mbulohen nga sistemet e pensioneve kontribuese. As një nga dy objektivat e sistemit të pensioneve, as reduktimi i varfërisë dhe as zbutja e konsumit, nuk është domosdoshmërisht të jetë e preferuar mbi tjetrën, ato thjeshtë paraqesin prioritete të veçanta shoqërore, vende të ndryshme i japin përparësi një nga këto dy objektiva⁸.

⁸ Whitehouse (2007) klasifikon skemat e pensioneve të vendeve të ndryshme në bazë të këtyre dy funksioneve.

KAPITULLI III → STRUKTURA E PENSIONEVE

III.1 Llojet e skemave të pensioneve dhe administrimi i tyre

Sigurimet shoqërore në vetvete nuk përmbajnë vetëm skemën e pensioneve, e cila rëndom identifikohet me sigurimet shoqërore. Skemat e pensioneve zenë pjesën kryesore të sigurimeve shoqërore, por nuk janë të vetmet. Përveç tyre janë edhe disa skema të tjera që funksionojnë në sistemin e sigurimeve shoqërore, si paaftësia e përkohshme, barrëlindjet, aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, papunësia, kompensimet e të ardhurave për familje, kompensimet për fëmijët, kompensimet për shkollim të fëmijeve, etj. Objekt i studimit të këtij punimi është vetëm skema e pensioneve, e cila zë dhe pjesën më të madhe të shpenzimeve të skemës së sigurimeve shoqërore.

Skemat e pensioneve ndahen sipas:

A. Mënyrës së financimit, në skema që financohen:

1 — nga të ardhurat që grumbullon shteti (Modeli Beveridge). Sipas këtij modeli punëmarrësit paguajnë kontribute fixe dhe marrin një pension për të plotësuar nevojat e tyre jetike. Të gjithë qytetarët janë të mbrojtur dhe kanë të drejtë të përfitojnë, pavarësisht nga niveli i kontributeve. Pjesëmarrës në këtë model është shteti, i cili plotëson ose kontribuon për pagimin e përfitimeve që jepen. Në këtë model niveli i rishpërndarjes të të ardhurave është shumë i lartë.

2 — nga kontributet e paguara nga gjithsecili (Modeli Bismark). Sipas këtij modeli sistemi financohet nga kontributet e paguara nga individët dhe masa e kontributit është e lidhur me të ardhurat që fitohen nga punësimi. Edhe përfitimet janë të lidhura me të

ardhurat dhe kontributet e paguara. Ky model ka rishpërndarje të të ardhurave më të ulët se Modeli Beverdgian.

B. Mënyrës së administrimit, në skema:

1 — publike, ku administrimi është publik nëpërmjet shtetit ose strukturave që ndërtohen nga shteti (Këshillat drejtues ose Bordet). Në këto skema roli i shtetit është primar dhe garantues nëpërmjet financimit dhe menaxhimit të tyre. Këto skema janë universale dhe mbrojnë me elementë të sigurimeve shoqërore gjithë shoqërinë.

2 — private, ose skema që nuk janë universale, por që ofrojnë mbrojtje për grupe të caktuara. Këto skema bazohen mbi parimin e sigurimit të pastër dhe niveli i rishpërndarjes së të ardhuravë është shumë i ulët. Ato operojnë sipas parimit të llogarive individuale dhe gjithësecili merr si përfitim kontributet e paguara ndër vite sipas llogaritjeve aktuariale.

3 — publike me menaxhim privat, që janë miksim i dy skemave të para. Skemat janë publike, ofrojnë mbulim për të gjithë, por për të rritur efektivitetin dhe mirëmenaxhimin, ato menaxhohen në mënyrë private. Skemë tipike publike me menaxhim privat janë kollonat e dyta ose me vetëkapitalizim. Përparësia e tyre qëndron në maksimizimin e fitimit nga investimi i fondeve të akumuluar.

C. Kontributit të paguar, në skema:

1 — të detyrueshme, të cilat financohen nga kontribute që janë të detyrueshme për të gjithë kategoritë e përcaktuara. Sipas legjislacionit të çdo vendi përcaktohen kategoritë e punëtorëve që janë të detyruar të paguajnë kontributin, si dhe norma kontributive. Në përgjithësi janë të detyruar të paguajnë kontribut të gjithë personat ekonomikisht aktivë, si punëmarrësit, të vetëpunësuarit dhe punëdhënësit.

2 — vullnetare, ku pjesëmarrësit nuk janë të detyruar të marrin pjesë, por pjesëmarrja është mbi baza vullnetare. Rast tipik për këtë lloj sigurimi janë kollonat e treta ose skemat private vullnetare. Të gjithë individët që dëshirojnë të kenë të ardhura më të mëdha në kohën e pleqërisë, paguajnë në mënyrë vullnetare kontribute, të cilat do të përkthehen në përfitime sipas kontratës së lidhur dhe plotësimit të kushteve të përcaktuara.

D. Shkallës së kapitalizimit të kontributeve, në skema:

1 — pay as you go (PAYG) ose që nuk kapitalizojnë. Këto skema nuk kapitalizojnë kontributin e paguar dhe të investojnë atë, por kontributet e paguara shkojnë për të paguar përfitimet e po asaj periudhe. Me fjalë të tjera, kontributet e paguara nga kontribuesit pjesëmarrës në skemë në muaj ose viti shkojnë për të paguar pensionistët për atë muaj apo vit. Kjo lloj skeme quhet pay as you go dhe ka nivel të lartë rishpërndarje midis brezave, brenda brezit dhe midis gjinive. Në rastet që kontributet e paguara janë më të mëdha se përfitimet që duhet të paguhen, teprica kalon në fondin rezervë, që është një fond që përdoret në rastet e mungesës së të ardhurave dhe shërben si garanci e skemës dhe e përfitimeve tashmë të përcaktuara.

2 — me kapitalizim ose me akumulim të kapitalit. Në këto skema kontributi i paguar është i personalizuar dhe administrohet në llogari individuale. Gjithë kontributet individuale akumulohen dhe investohen ndër vite. Edhe interesi i realizuar nga investimet shtohet në llogaritë individuale. Përfitimi kur plotësohen kushtet llogaritet në bazë të kontributeve dhe interesave të investimit në llogaritë individuale sipas kalkulimeve aktuariale.

E. Mënyrës së dhënies së përfitimit, në skema:

1 — me përfitim të përcaktuar (Defined Benefit - DB). Përfitimi i dhënë për këto skema llogaritet si pjesë e të ardhurave nga puna për periudha të caktuara në ligj. Dmth përfitimi për pension është pjesë e pagës mbi të cilën janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore. Në përgjithësi masa e përfitimit llogaritet si përqindje e pagës së vitit të fundit ose e pagës mesatare të tre ose më shumë viteve të fundit. P.sh., 70 % e pagës mesatare të tre viteve të fundit të punës ose e pagës mesatare e tre viteve më të mirë në dhjetë vitet e fundit të punës. Kjo skemë është e mirë për përfituesit, por krijon vështirësi në qëndrueshmërinë financiare të skemës, pasi pagat në vitet e fundit të jetës janë më të larta se pagat në fillimet e karrierës.

2 — me kontribut të përcaktuar (Defined Contribution - DC). Përfitimi për këto skema llogaritet duke patur parasysh gjithë kontributin e paguar gjatë gjithë karrierës së punës ose viteve të siguruara dhe jo vetëm kontributin e paguar në vitet e fundit. Sipas kësaj skeme përfitimi është i lidhur me masën e kontributit të paguar dhe krijohen incentiva për të paguar gjatë gjithë karrierës kontribute të larta për të përfituar pension të lartë. Kjo skemë lidh në mënyrë të drejtë kontributet e paguara me përfitimet e marra.

F. Rishpërndarjes të të ardhurave midis individeve ose shkallës së solidaritetit, në skema:

1 — me solidaritet të madh dhe rishpërndarje midis brezave ose midis individëve të një brezi, që ndërtohen sipas parimit pay as you go dhe riskun individual e shpërndajnë në të gjithë pjesëmarrësit në skemë. Ato kanë avantazhin që ofrojnë një mbrojtje më të mirë, jo vetëm për pleqërinë, por edhe për degët e tjera të sigurimit, si invaliditeti, humbja e mbajtësit të familjes, etj.

2 — me nivel solidariteti dhe rishpërndarje të ulët (actuarial). Këto janë skema me akumulim kapitali, ku përfitimi varet nga gjendja e llogarisë individuale. Përderisa

përfitimi llogaritet nga shuma e akumuluar, niveli i solidaritetit dhe rishpërndarjes të të ardhurave është shumë i ulët. Skemat private me vetëkapitalizimi janë skema të tilla.

Gati të gjitha skemat e sigurimeve shoqërore që funksionojnë sot në botë janë të ndërtuara mbi parimin e pagimit të kontributeve, që do të thotë që të gjithë individët paguajnë kontribute të sigurimeve shoqërore gjatë aktivitetit të vet të punësimit dhe përfitojnë përfitime nga skemat e sigurimeve shoqërore, kur janë të paaftë për të punuar dhe krijuar të ardhura. Ajo që vihet re në shumë vende, sidomos të Europës, është ndërthurja midis skemave që financohen nga të ardhurat e përgjithshme dhe skemave që financohen nga kontributet e paguara. Tendenca në këtë lloj industrie është zvogëlimi i financimit të tyre nga të ardhurat e përgjithshme dhe rritja e pjesës së financimit nga kontributet e paguara ose kalimi i riskut nga publik tek individ.

Niveli i rishpërndarjes të të ardhurave në skemat që financohen nga të ardhurat e përgjithshme është shumë i lartë, në krahasim me skemat e financuara nga kontributet e paguara. Kjo nuk do të thotë që në skemat publike të financuara nga kontributet e paguara nuk kanë rishpërndarje të të ardhurave sepse kontributet e paguara nga individë të ndryshëm janë të ndryshme dhe përfitimet që jepen nuk janë në korrelacion të drejtë me kontributet e paguara. Nivel të ulët të shpërndarjes të të ardhurave ka vetëm në skemat private ose vullnetare.

III.2 Mekanizmat mbështetës për personat e moshë së tretë.

III.2.1 Sistemet kontribuese: kostot dhe risku

Metoda parësore për sigurimin e mbështetjes në pleqëri është nëpërmjet sistemeve të pensionit kontribues. Sistemet e pensionit kontribues janë përshkruar shpesh ose në bazë të mënyrës së financimit ose të përfitimeve që ka struktura. Mekanizmat e financimit në

përgjithësi janë dy lloje: *pay as you go* ose nëpërmjet mekanizmave plotësisht të financuar.

Me pay as you go, punonjësit e tanishëm kontribuojnë bazuar në të ardhurat e tyre aktuale. Këto kontribute përdoren menjëherë për të paguar përfituesit e tanishëm; punonjësi, i cili jep kontribut merr vetëm një premtim nga qeveria se ajo do të paguajë përfitime të lidhura me këto kontribute, kur punonjësit t'i lindë e drejta për një pension.

Në atë që njihet si *sistemet e pensioneve të financuara plotësisht*, kontributet e punëtorëve investohen, në vend që të shpenzohen, dhe të ardhurat e investimeve janë një pjesë integrale e përfitimeve që paguhen. Këto investime mund të menaxhohet nga një agjenci publike ose konkurrese, me pjesëmarrjen e sektorit privat.

Mekanizmat e përfitimit janë gjithashtu dy lloje: *mekanizmi i përfitimit të përcaktuar dhe mekanizmi i kontributit të përcaktuar*. Sipas mekanizmit të përfitimit të përcaktuar, pensioni që merret është zakonisht një funksion i të ardhurave, i shprehur si përqindje e të ardhurave për vit kontributi ose mund të përcaktohet edhe në disa forma të tjera. Dallimi qëndron te fakti që përfitimi i dhënë është i specifikuar në një farë mënyre. Në rast se financimi ulët, dikush, ose qeveria në një plan publik ose punëdhënësi bazuar në një plan të tij, ka përgjegjësinë për të siguruar pensionin.

Nga ana tjetër, në bazë të mekanizmit të kontributit të përcaktuar, kontributi përcaktohet si përqindje e pagave, dhe përqindjet janë të specifikuara për punonjësit, punëdhënësit dhe, potencialisht për qeverinë, por pensioni final përcaktohet nga shuma në llogarinë e pensionit të dikujt në kohën e daljes në pension, i cili përfshin si kontributet dhe të ardhurat e krijuara nga investimet e kontributeve. Sipas këtij sistemi, asnjë përfitim specifik nuk është i premtuar; pensioni është plotësisht e varur nga gjendja e llogarisë

dhe nuk ka nevojë për një garantues të fondit. Financimi është thjesht një kthim i parave që gjenden në llogari.

Në një botë “të stilizuar” në mënyrë strikte, karakteristikat e riskut të dy llojeve të sistemeve të pensionit do të jenë shumë të ndryshme, me qeveritë apo punëdhënësit mbartës të riskut në sistemet me përfitim të përcaktuar, dhe punonjësit mbartës të riskut në sistemet me kontribut të përcaktuar. Megjithatë, në praktikë, këto dallimet janë mjaft të paqarta. Parametrat në sistemet me përfitim të përcaktuar mund të ndryshojnë, kryesisht duke ndryshuar natyrën e përfitimit të premtuar.

Shumë vende e gjejnë veten të paaftë për të paguar pensionet në kohën e duhur, paaftësi e cila imponon rreziqe të konsiderueshme për pensionistët gjatë viteve të tyre më vulnerabël. Shumica e sistemeve me kontribut të përcaktuar, nga ana tjetër, marrin garanci qeveritare për pensione minimale, ose janë vetëm një komponent në një strategji më të gjerë të pensioneve, ku komponentët e tjerë zbusin riskun tek punonjësit, që i atribuohet marrëveshjes së kontributit të përcaktuar .

Zakonisht, sistemet me përfitim të përcaktuar janë sistemet pay as you go dhe sistemet me kontribut të përcaktuar janë të llojit të financuara plotësisht. Një sistem me përfitim të përcaktuar është e mundur që të financohet plotësisht, sepse garantuesi mban aktive të mjaftueshme financiare për të mbuluar detyrimet në përputhje me planin.

III.2.2 Sistemet e pensioneve jo kontribuese: kostot dhe risku

Edhe në rastet kur ekziston një sistem kontribues, gjithmonë do të ketë njerëz të cilët nuk marrin pjesë në tregjun e punës, të mbuluar nga sistemi i sigurimeve shoqërore, të cilët nuk marrin pjesë rregullisht për t'u kualifikuar për përfitime, apo të ardhurat e ulta gjatë jetës së tyre i lënë ata me përfitime edhe më të ulëta të pensioneve. Kjo është

veçanërisht e vërtetë për shumë punonjes të sektorit informal të vendeve me skema jo rishpërndarëse. Në shumë raste, grupet e punonjësve, të tillë si fermerët ose të vetëpunësuarit, nuk janë të mbuluar nga sistemi kombëtar i pensioneve, për shkak se është konsideruar shumë e vështirë për të vlerësuar të ardhurat dhe mbledhjen e kontributeve nga këto grupe.

Këto grupe janë në rrezik të varfërisë në pleqëri në qoftë se ata nuk kualifikohen për një pension nëpërmjet kontributeve ose në qoftë se ata kualifikohen vetëm për një pension shumë të vogël. Si rezultat, shumica e vendeve me të ardhura të larta ose mesatare me sisteme kontributesh, ofrojnë përfitime minimale për ata njerëz që nuk përfitojnë nga sistemet kontributive. Ky përfitim mund të marrë forma të ndryshme, për shembull, një sistem ku të gjithë personat mbi një moshë të caktuar marrin përfitim në bazë të kërkesave të lidhura me lejeqëndrimin ose shtetësinë. Përfitimi në shumicën e rasteve financohet direkt nga të ardhurat nga taksat e përgjithshme. Ky përfitim ka tendencën për të ulur varfërinë në të moshuarit.

Qëllimi i pensioneve nga sistemi jokontribues është qartësisht reduktimi i varfërisë, pa përpjekje për zbutjen e konsumit dhe disa vende zgjedhin të integrojnë këtë ndihmë sociale për të moshuarit me asistencën sociale për moshat të afta për punë, por që nuk zotërojnë një punë, duke rezultuar në një sistem asistence sociale kombëtare. Një integrim i tillë është ideal që burimet të rrjedhin tek ata që janë më në nevojë, pavarësisht nga mosha, megjithatë, nga një vështirësi administrative dhe sociale mund të ketë argumente për ndarjen e këtij përfitimi. Qëllime, të tilla si nxitja e individëve në moshë pune për të rifilluar punë, nuk janë çështje që prekin të moshuarit; kontrole të përvitshme mund të jenë të nevojshme për individët në moshë pune për të cilët situata mund të ndryshojë në mënyrë dramatike nga një vit në tjetrin, por më pak e nevojshme

për individë të moshuar që jetojnë vetëm ose në çift dhe situata e të ardhurave nuk ka gjasa të përmirësohet në të ardhmen. Së fundi, të moshuarit të cilët nuk ishin të varfër gjatë viteve të tyre të punës, mund të ndihen veçanërisht të stigmatizuar për shkak se ata tani duhet të kërkojnë ndihmë sociale.

III.3 Ndikimi rishpërndarës dhe social i sistemeve të pensionit

Çdo program social ka ndikim të konsiderueshëm në ekonomine në të cilën ai aplikohet. Sistemet e pensioneve mund të ndikojnë mbi varfërinë tek të moshuarit. Ato mund të ndikojnë në marrëdhëniet midis grupeve të të rinjve dhe të moshuarve, si dhe në marrëdhëniet në familje. Ato gjithashtu kanë një ndikim të konsiderueshëm mbi tregun e punës dhe punësimin, veçanërisht në qoftë se ato janë të financuara nëpërmjet sistemeve kontributive. Ato mund të ndikojnë mbi kursimet kombëtare dhe zhvillimin e tregjeve financiare, si dhe në nivelin e përgjithshëm të shpenzimeve të qeverisë. Një literaturë e gjerë që rrjedh nga studimet e rasteve dhe të dhënat në Shtetet e Bashkuara dhe vendet e tjera të OECD ekziston për secilin prej këtyre çështjeve (Corsetti & Schmidt-Hebbel, 1997; Diamond & Hausman, 1984; Disney, 1996; Gruber & Eise, 1999; Koitz, 1988).

Në këtë punim ne do të fokusohemi në ndikimin e drejtpërdrejtë të shpërndarjes të sistemit të pensionit, duke injoruar ndikimet dytësore që rrjedhin nëpërmjet ekonomisë. Ndikimi i shpërndarjes do të varet nga lloji i sistemit të pensioneve ekzistues në vend.

Çështja kryesore me të cilën Titmuss⁹ na sensibilizon është nëse një politikë ose një program i caktuar është realisht rishpërndarës. Në përmbledhjen që Shteti i mirëqënies, i impenjuar për një drejtësi parimore, kërkon njëfarë niveli rishpërndarjeje të burimeve,

⁹ Titmuss, Income Distribution and Social Change(1965)

autori provon politikat në terma të rishpërndarjes në kohë, mes grupeve të ndryshme dhe mes zonave të ndryshme të një vendi (“drejtësia territoriale”). Papërshtatshmëria e pjesës më të madhe të të dhënave të disponueshme është e njohur. Zbulimi thelbësor dhe nganjëherë befasues është se, në përgjithësi, ka pasur shumë më pak rishpërndarje të asaj që besohet në përgjithësi dhe se shumë nga programet e Shtetit të mirëqënies, në mënyrë të veçantë ato më të kushtueshmet, favorizojnë klasat e mesme dhe të larta. Rezultatet kombinohen me një sistem fiskal që është në rënie në mënyrë frekvente. Planifikuesi që do të zbatojë një politikë që është njohëse e rishpërndarjes duhet të adaptojë mjete specifike për ta bërë atë.

Të përshtatësh objektivin e rishpërndarjes – në vetvete haset në një epokë në të cilën të ardhurat reale rriten nga viti në vit – nuk i zgjidh të gjitha problemet. Njësia dhe ndarja në kohë e kësaj rishpërndarjeje janë variabla që ndryshojnë nga vendi në vend. Zgjedhja nëse duhet niveluar drejt majës ose drejt fundit ka pasoja të konsiderueshme. Në fakt, lihen “të pasurit” atje ku janë, duke shpërndarë më gjerësisht rezultatet e një rritjeje të prodhueshmërisë tek shtresat më në nevojë. Në veçanti, për shembull, mbahen dallimet tradicionale midis “ritjes të kapitalit” dhe “të ardhurave” kur flitet për rishpërndarje të të ardhurave. Po për shpërndarjen e keqe të të ashtuquajturave përfitime shtesë?

S. M. Miller¹⁰ bashkohet me ata që mbështesin se koncepti i varfërisë është relativ duke vënë re se problemi që po lind mund të mos ketë të bëjë më nivelet specifike të të ardhurave, por pabarazitë. Në Shtetet e Bashkuara, varfëria karakterizohet nga një numër i vetëm i të ardhurave. Por autori argumenton se ekziston një mënyrë më e dobishme për të matur këtë privim që është “*përrjashtimi social*”. Në Evropë, qeveritë gjithnjë e më shumë po përpiqen ta matin atë dhe të dalin me politika për ta kufizuar atë.

¹⁰ Social Exclusion The European Approach to Social Disadvantage S.M. Miller

Në kohët moderne, komunikimi masiv dhe mobiliteti fizik kanë krijuar një ndërgjegjshmëri të përçarjeve të mëdha në të ardhura, në aksesin e burimeve dhe në të mirat ose në stilin e jetesës së njerëzve. Ky këndvështrim i ri ndriçon mundësitë rishpërndarëse, por nuk fikson strategjinë dhe taktikat që duhet të ndiqen.

Së fundmi politikanët gjenden përballë faktit nëse duhet kërkuar barazia apo niveli i barabartë? Barazia përfshin nivelimin në një pikë të barabartë nisjeje (“barazia e mundësive”). Cilat janë elementët që e përbëjnë? Deri tani, zgjedhja thuajse universale, që janë bëra në shtetet të tregut të lirë, ka qënë në favor të një standardi minimal të garantuar dhe të një impenjimi drejt barazisë të mundësive, sesa drejt barazisë absolute. Të gjitha shtetet pranojnë dhe disa risjellin se nismat e nivelimit ekstrem janë të papërshtatshme.

Meqënëse disa mekanizma rishpërndarës veprojnë vetëm si pasoja dytësore për qëllime të tjera të rëndësishme, ndërsa të tjera janë përshtatur lirshmërisht në funksionin rishpërndarës, ngelet ende shumë për të vendosur përpara se të mund të vijohet me pikëpamjen mbi këtë argument në lidhje me politikën rishpërndarëse që duhet ndërmarë. Një listim i shkurtër i masave potenciale në të dyja kategoritë sugjeron diçka nga rrezja e interesave të rishpërndarjes si në vendet e industrializuara ashtu dhe në ato më pak të zhvilluara. Listimi duhet gjithashtu edhe për të nxjerë në pah llojin arbitrar të secilës përpjekje për të ndarë politikën ekonomike nga ajo sociale. “Ekziston rrallë herë një politikë qeveritare që nuk ndikon në njëfarë mënyrë mbi shpërndarjen e të ardhurave ose mbi nivelin e jetesës”¹¹ Secili buxhet qeveritar ndikon në shpërndarjen e drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë të të ardhurave të një vendi.

¹¹ World Economic Situation and Prospects 2015 .The report is a joint product of the United Nations Department of Economic and Social Affairs (UN/DESA), the United Nations Conference on Trade and Development (UNCTAD) and the five United Nations regional commissions (Economic Commission for Africa (ECA), Economic Commission for Europe (ECE), Economic Commission for Latin America and

III.3.1 Rishpërndarje nëpërmjet kontributit

Ndërsa qëllimi i një përfitimi të përcaktuar, sipas sistemit pay as you go është në dukje për të bazuar përfitimin tek kontributet, duke krijuar një institucion që do të lejojë individët për të lehtësuar konsumin gjatë jetës së tyre në kushtet e mungesës së një institucioni të sigurt në treg, ky lloj i skemës së pensioneve gjithmonë ka pasoja shpërndarëse brenda brezave, disa të qëllimshme, dhe të tjerat të paqëllimshme. Vendet shpesh përpiqen të rishpërndajnë në drejtim të të varfërve dhe për të siguruar një mekanizëm kursimi brenda këtyre sistemeve. Megjithatë, ekziston një tension i natyrshëm mes rishpërndarjes në një sistem kontributiv dhe stimuljeve të individit për të kontribuar, duke i lidhur përfitimet me kontributet.

Vlerësimi i Tinbergen¹² është: *“Problemi për të gjetur regjimin optimal është problemi qëndror i ekonomisë së mirëqënies. Në këtë sektor të ekonomisë dimë se një funksion i mirëqënies sociale është elementi i parë midis të dhënëve për problemin. Kjo nënkupton se supozojmë njohjen e dy gjërave: e para, preferencat e subjekteve ekonomike dhe e dyta, se si të balancojmë interesat e individëve të ndryshëm në përcaktimin e mirëqënies sociale ose veprimit social. Në gjuhën e zakonshme ekonomike kjo do të thotë se pasoja në radhë të parë të funksioneve të shërbimeve për individët, dhe në radhë të dytë për shoqërinë. Bëhët fjalë për supozime thuajse disi të rrezikshme, sepse njohuria jonë për funksionet në dobi të individëve është shumë e limituar dhe funksioni i mirëqënies sociale varet nga mënyra se si i mbulojmë shërbimet që kanë lidhje me persona të*

the Caribbean (ECLAC), Economic and Social Commission for Asia and the Pacific (ESCAP) and Economic and Social Commission for Western Asia (ESCWA)). The United Nations World Tourism Organization (UNWTO) also contributed to the report. 2015, p 25

¹² Central planning . Neë Haven : Yale University Press. 1964. Development planning: the sector phase, with different gestation periods. Tinbergen, J. Rotterdam: Netherlands Economic Institute, 1964 .p 82

ndryshëm. Tani për tani ajo që kryhet është vetëm instiktive ndaj ka hapësirë për larmishmëri opinionesh”

Vështirësia shkon përtej problemit për të hedhur një urë midis botëve të zgjedhjes së sistemit dhe të vlerës. Në botën “reale” të zgjedhjes, shpesh zgjidhet midis programeve dhe politikave që bashkojnë vlera në gradë dhe kombinime të ndryshme. Sakrifikohet niveli i dikujt për të ngritur nivelin e dikujt tjetër. Nuk ka asnjë rrugë që sistemi i pensionit mund të ndjekë për të fiksuar objektivat ose vlerat marginale përveç se në aspektin e disa politikave të veçanta që janë në diskutim. Për më tepër, persona që nuk mund absolutisht të arrijnë një marrëveshje mbi vlerat abstrakte, shpesh mund të arrijnë në një konsensus, ose të nënshkruajnë një kontratë ose një kompromis, mbi problemet praktike që kanë lidhje me politikën që duhet ndjekur në lidhje me perfitimin e pensionit.

Ka edhe kufizime se sa rishpërndarja e vërtetë mund të realizohet brenda një sistemi kontributiv për sa kohë pjesa me e madhe e rishpërndarjes ndodh nga një grup i kontribuesve në një tjetër. Nëse mbulimi është i ulët, të dy grupet tashmë mund të marrin të ardhura relativisht të ngjashme, për rrjedhojë ata kanë më shumë gjasa të bëjnë pjesë në një segment të ngushtë të popullatës aktive.

III.3.2.1 Rishpërndarja e qëllimshme

Rishpërndarja e qëllimshme në një skemë përfitimi të përcaktuar bëhet përmes të paktën tre mekanizma. Shumica e sistemeve me përfitim të përcaktuar kanë një *pension minimal*, por individët duhet të kontribuojnë për një periudhë kohe para se ata mund të marrin këtë pension minimal. Pensioni minimal pothuajse gjithmonë përfshin disa forma rishpërndarje, sepse në pensionin minimal, punëtorët me paga minimale që

kontribuojnë për periudha minimale kontributi pothuajse gjithmonë marrin pensione më të larta se pensionet që do të kishin përfituar në bazë të formulës. Sigurisht, kjo e lë të hapur mundësinë që punonjësit të mashtrojnë sistemin duke kontribuar vetëm për aq sa është e mjaftueshme për t'u kualifikuar për pension minimal, por objektivat për reduktimin e varfërisë të sistemeve të pensioneve zakonisht parandalojnë këto shqetësime.

Një mekanizëm i dytë për rezultatet e rishpërndarjes krijohet nëpërmjet *formulës së përfitimit progresiv*. Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë një nga disa vende ku në mënyrë të qartë sipas formulës së përfitimit progresiv, ka një normë rënie të përfitimit me rritjen e të ardhurave. E ngjashme me këtë qasje, por zakonisht më pak progresive, janë skemat që ofrojnë norma të veçanta përfitimi për grupe të ndryshme të punonjësve, zakonisht duke kredituar më shumë vjet shërbim për vit kontributi. Në Serbi, për shembull, grave ju është dhënë 15 për qind më shumë vite se vitet e tyre të kontributit. Në të tjera vende, ky përfitim i veçantë i është dhënë profesioneve të veçanta, të tilla si mësuesit ose minatorët.

Një mekanizëm i tretë i rishpërndarjes, më i zakonshëm se i dyti, është rasti kur *per 10-15 vitet e para të shërbimit të jepen norma më të larta të përfitimit sesa në vitet pasuese*. Punëtorët më të ardhura më të ulëta kanë më shumë të ngjarë të ndërpresin karrierën e tyre të punës, veçanërisht në sektorin formal të punës dhe nuk ka gjasa për të grumbulluar sasi të konsiderueshme kohë pune në sektorin formal. Në qoftë se vitet e para të kontributit të shpërblehen më shumë, këta punëtorë do të jenë ende në gjendje të dalin në pension me pensione të relativisht të larta. Si në rastin e pensioneve minimale, lindin diskutime, të tilla si: nëse njerëzit mund të fitojnë pensione të arsyeshme në vetëm 10-15 vjet kontribute, atëherë pse duhet që ata të kontribuojnë gjatë gjithë

karrierës së tyre? Megjithatë, ky mekanizëm vazhdon të përdoret në emër të rishpërndarjes.

III.3.2.2 Rishpërndarja e paqëllimshme

Përveç rishpërndarjes së qëllimshme, ka tipare brenda sistemeve me përfitim të përcaktuar që kanë pasoje rishpërndarjen e paqëllimshme. Një nga karakteristikat kryesore është periudha mesatare e pagave e përdorur për llogaritjen e pensioneve. Pensionet janë shprehur si një përqindje e pagave, por pagat mund të përkufizohet si paga e fundit e fituar, si paga mesatare e pesë viteve të fundit, ose si paga mesatare e ndonjë periudhe tjetër edhe më të gjatë deri tek paga mesatare e të gjithë jetës në punë. Nëse periudha mesatare është çdo periudhe kohe më pak se gjithë periudha e plotë e punës, atëherë rishpërndarja është përfshirë. Individët paguajnë kontribute për pagat gjatë gjithë karrierës së tyre; nëse pensionet nuk janë të lidhura me pagën mesatare të karrierës, atëherë pensionet nuk janë as të lidhur me kontributet mesatare. Për më tepër, ka një ndikim sistematik baza e të ardhurave në atë masë që punonjësit e mirëarsimuar në përgjithësi përjetojnë rritje më të shpejtë të pagave, në veçanti drejt fundit të karrierës së tyre. Kështu, për periudhë mesatare sa më e shkurtër, aq më shumë rishpërndarja ka në sistem nga punëtorët për pensionistët aktuale dhe më e madhe rishpërndarjes drejt pensionistëve më të ardhura të larta të cilët fitojnë pagat më të larta në fund të karrierës.

Problemi i dytë është diferenca në jetëgjatësinë e individëve midis klasave të të ardhurave. Individët me të ardhura të larta priren të jetojnë më gjatë. Kjo diferencë ka tendencë për të bërë skemat e përfitimit regresive, duke pasur parasysh se individet me të ardhura më të larta do të marrin përfitime për një periudhë më të gjatë, për shkak të

jetëgjatësisë së tyre më të gjatë, duke rezultuar në një përfitim më të lartë të përgjithshëm të paguar edhe nëse pensioni mujor është identik.

Një problem i fundit është diferenca e jetëgjatësisë midis meshkujve dhe femrave. Skemat me përfitim të përcaktuar nuk bëjnë dallim midis normës së përfitimit të paguar për meshkujt dhe atë që paguhet për femrat, edhe pse femrat priren të marrin përfitime për më shumë vite për shkak të jetëgjatësisë së tyre. Si rezultat, ka një rishpërndarje automatike nga burrat tek gratë, e fshehur në skemën me përfitim të përcaktuar. Praktika e zakonshme që lejon gratë të dalin në pension më herët me të njëjtat përfitime vetëm sa intensifikon këtë rishpërndarje.

III.3.2.3 Rishpërndarja midis brezave

Ndërsa pasojat e shpërndarëse zakonisht përfshijnë rishpërndarjen brenda grupit, ndikimi i rishpërndarjes në skemat me përfitim të përcaktuar është më i madh mes brezave të ndryshëm. Rrallë kostot e skemave janë të tilla që të jene realisht të drejta. Zakonisht, një normë kontributi përzgjedhet, shkalla e përfitimit përzgjedhet dhe kushtet për të përfituar përcaktohen. Këto parametra pothuajse asnjëherë nuk janë të qëndrueshëm. Duke qënë se skemat janë të përcaktuara normalisht kur përfituesit janë të rinj, parametrat janë zgjedhur shpesh që të mbajnë një ekuilibër midis të ardhurave dhe shpenzimeve në vitet e para, ndoshta me një tepriçë të vogël të akumuluar.

Në fillim, shumë kontribues janë të rinj, dhe pak të moshuar marrin përfitime, normat e kontributit zakonisht janë të ulëta, dhe përfitimet janë mjaft bujare. Si rezultat i kësaj, në fillim, kontributet rrallë mbulojnë përfitimet e ardhshme që paguhet për këta kontribues, pra pritet që kontributet e gjeneratave të ardhshme do të përdoren për të paguar përfitimet punonjësve të sotëm. Për sa kohë që popullsia vazhdon të rritet me

shpejtësi, skema është e zbatueshme, aq sa mund të jenë të zbatueshme të gjitha skemat piramidale. Por, kur popullsia që ka paguar fillon të stabilizohet në madhësi, ose kur ajo bie, shfaqen deficite të mëdha. Përpjekjet për të rregulluar deficitet fiskale duke rritur normat e kontributeve dhe reduktuar përfitimin përkeqësojnë problemet e rishpërndarjes midis brezave.

Grupit të të rinjve u kërkohet që të paguajnë kontribute më të larta dhe marrin më pak përfitime; ata shpesh janë të detyruar të shtyjnë daljen në pension, e cila gjithashtu rezulton në më pak përfitimeve në total. Edhe pse mund të ketë disa justifikime për transferimin e të ardhurave nga njëri grup te tjetri, sidomos kur grupe të veçanta janë goditur rëndë nga luftërat, recesionet, apo një tranzicion drejt ekonomisë së tregut, sistemi i rishpërndarjes nën sistemin me përfitim të përcaktuar jo vetëm që përfshin transferimin vetëm një herë, por do të rezultojë në shpërndarje të padëshiruara dhe të papritura me kalimin e kohës. Edhe në qoftë se sistemi ishte aktualisht i balancuar në fillimin e tij, ndryshimet që vijnë nga jetëgjatesia dhe lindjet do të kërkojnë ndryshime të vazhdueshme për të ruajtur balancën.

III.4 Rishpërndarja në sistemin me kontribut të përcaktuar

Shumë pak rishpërndarje ndodh në një sistem të pastër me kontribut të përcaktuar. Me daljen në pension, individët marrin kontributin e tyre me interesin e investimit që këto kontribute kanë krijuar. Gjithsesi, shumica e sistemeve nuk janë sisteme të pastra me kontribut të përcaktuar, ato përmbajnë një element rishpërndarje. Shumë sisteme të tilla si ato të Kilit dhe Meksikës, të cilat ofrojnë garanci minimale për pensionet e punëtorëve, të tilla që pas një periudhe të caktuar të kontributit një pension minimal do të sigurohet nga qeveria. Sistemi të tjera, ofrojnë një normë minimale kthimi të

garantuar, e cila mund të rishpërndahet në varësi të nivelit. Në qoftë se norma minimale e kthimit është e lartë padyshim rishpërndahet nga garantuesi, që zakonisht është qeveria, për pensionistët po pa marrë parasysh nivelin e pensionit. Nga ana tjetër, ka pak raste ku norma e kthimit është e fiksuar që me përpara dhe në qoftë se fondi krijon të ardhura më të larta se norma e kthimit atëherë individët humbasin këto të ardhura në favor të fondit. Megjithatë humbja nuk varet nga niveli i të ardhurave.

Një element tjetër i rishpërndarjes indirekte është i lidhur me politikën e investimit të fondit të pensioneve. Në shumë vende, asete, vecanërisht kur menaxhohen nga organet publike, investohen kryesisht në strehim ose në programe që sjellin përfitime sociale. Në këtë rast, ndodh një transferim nga punëtorët tek përfituesit e investimit dhe zakonisht nuk është një transferim progresiv për sa kohë që shpërblen ata që janë politikisht të fuqishëm dhe jo ata që janë të varfër.

III.5 Rishpërndarja nëpërmjet фондеве vullnetare ose suplementare

Në pensionet me përfitim të përcaktuar dhe në pensionet me kontribut të përcaktuar, zakonisht qeveritë përcaktojnë nivele tavan të të ardhurat për të cilat llogaritet kontributi dhe zakonisht i njëjti tavan përdoret për të llogaritur përfitimin. Ndërkohë që qeveritë duan të reduktojnë varfërinë dhe të zbusin konsumin tek të moshuarit, ato nuk janë të shqetësuara nëse shumë të pasur në botë kanë ulur mjaftueshëm të ardhurat e tyre. Për sa kohë të gjitha kushtet reduktojnë lirinë e individit, një nivel tavan për kontribute kufizon impaktin e asaj që është e nevojshme për të ndaluar varfërinë tek të moshuarit. Tavani zakonisht vendoset tre deri në pesë herë të pagës mesatare. Pra, sistemi i detyrueshëm nuk siguron zbutje të konsumit tek individët me të ardhura të larta.

Qeveritë kompesojnë këtë situatë duke ofruar avantazhe me taksat për pensionet vullnetare ose suplementare. Zakonisht qeveritë nuk taksojnë kontributet për pension vullnetar ose kthimet e fituara nga këto kontribute, ato taksojnë vetëm përfitimet në momentin e marrjes. Kjo politikë përfaqëson një përpjekje të qeverive për të inkurajuar kursimet afatgjata, të cilat mund të investohen dhe të stimulojnë rritjen në ekonomi. Njerëzit të cilët përfitojnë nga avantazhet e këtyre skemave, janë individë me të ardhura të larta. Nga këndvështrimi i rishpërndarjes kjo lloj politikë vlen në rast se rritja që vjen nga kursimet afatgjata do të ndihmonte të varfërit. Gjithsesi të dhënat sygjerojnë se individët me të ardhura të larta nuk i rrisin kursimet e tyre që të fusin në fondit e pensionit me avantazhe taksash por thjesht zhvendosin kursimet e tyre nga një instrument në tjetrin. Në këtë rast politika thjesht ul taksat për të pasurit, pa ndonjë përmirësim të dukshëm në uljen e varfërisë.

III.6 Sistemi shumëhyllësh i Bankës Botërore

Në vitin 1994, Banka Botërore publikoi: “Shmangia e krizës së moshës së vjetër - Politikat për të mbrojtur moshën e vjetër dhe për të nxitur rritjen”. Fjalët e hapjes së Michael Bruno përmbledhën gjithë kuptimin e sistemit të propozuar të pensioneve. Sistemet që ofrojnë siguri financiare për të moshuarit janë nën një rritje të tendosur në të gjithë botën (World Bank, 1994)¹³. Këto fjalë janë ende të përshtatshme sot, veçanërisht në vendet në zhvillim dhe për këtë kanë kontribuar një sërë faktorësh:

- Ndërsa raportet e varësisë vazhdojnë të rriten, reforma nuk ka qenë e lehtë për t’u zbatuar, kështu që kostot fiskale të sistemeve në vendet në zhvillim kanë vazhduar të rriten gjithashtu për një pjesë të madhe të tyre.

¹³ Averting the Old Age Crisis Policies to Protect the Old and Promote Growth . Published for the World Bank Oxford University Press 1994. Foreëord

- Në disa vende tronditjet e krizave ekonomike kanë përkeqësuar pamjen fiskale nëpërmjet një ulje të rritjes, si dhe rritjes së borxhit publik.
- Së fundi, trendi në qëllimet e politikave ekonomike ndaj inflacionit të ulët, politikat e forta fiskale dhe ndërvlerësia në rritje e sistemeve monetare, ka vendosur në një fokus të mprehtë borxhet e nënkuptuara të skemave të pensioneve.

Që nga publikimi i “Shmangia e krizës së moshës së vjetër”, në fushën e reformës së pensioneve kanë ndodhur shumë ngjarje për një kohë të shkurtër. Diskutimet për reformën e pensioneve referohen tek sistemet “shumëkolonëshe”.

Çfarë përmban ekzaktësisht një kolonë (shtyllë)?

Autorët e përcaktojnë këtë term në mënyra të ndryshme, duke u përpjekur të kapin dimensionet kyçe në projektimin e sistemeve kombëtare të pensioneve. Shumë autorë i kanë konsideruar elementët e mëposhtëm si të rëndësishëm në përshkrimin e sistemeve:

— Mbulimi: A është ai universal?

— Pjesëmarrja: A është e detyrueshme apo vullnetare?

— Kontributet: Ku është sistemi duke i parë të derdhen pagesat: në një sistem të përgjithshëm pagesash apo në një sistem të bazuar në përfitimet individuale?

— Përfitimet: Deri në çfarë mase përfitimet në pension reflektojnë në jetëgjatësinë e pensionistit?

— Financimi: Deri në çfarë mase asetet mbulojnë detyrimet e ardhshme?

— Menaxhimi: A është publik, privat apo ka një përzjerje midis të dyjave?

Kategorizimi i sistemeve në bazë të këtyre kritereve nuk është çështje e lehtë.

III.6.1 Përkufizimet e shtyllave.

Shtylla e parë: Sistemet e mëdha, të detyrueshme publike ose pothuajse publike me rishpërndarje ndër dhe brenda breznor, të cilat mund të financohen plotësisht (Danimarka, Hollanda)¹⁴, pjesërisht (p.sh, Maroku, SHBA, India)¹⁵ ose të pa financuara (p.sh., Gjermania dhe Brazili)¹⁶, ku përfitimet janë të përcaktuara nga një DB ose një formulë DC.

Shtylla e dytë: Sistemet e financuara plotësisht, me kontribute të përcaktuara, ku përfitimet varen nga asetet në llogarinë e individit që del në pension. Këto mund të jenë:

- a) Sisteme të fondit të pensioneve, të cilat janë të centralizuara, të menaxhuara nga qeveria dhe zakonisht ofrojnë përfitime “lump sum”, por mund të ofrojnë dhe një pensioni .
- b) Sistemet individuale të llogarive financiare, ku paratë e pjesëmarrësit janë investuar në tregje financiare të menaxhuar privatisht.

Këto dy shtylla mund të plotësohen me një garanci minimale: një garanci pa marrë parasysh se si është formuluar, është financuar nga taksat e përgjithshme dhe sipas përcaktimit të saj thyen lidhjen e drejtpërdrejtë midis kontributeve dhe përfitimeve.

Disa e kanë quajtur garancia e domosdoshme ose “shtylla 0” e pensioneve.

Shtylla e tretë: Vendet gjithashtu sigurojnë një mjet të fundit rrjet sigurie në formën e ndihmës sociale për shumë nevojtarë. Shtyllat e parë dhe e dytë mund të plotësohen me sistemet e qeverisjes të rregulluara, vullnetare ose gjysmë-vullnetare, sistemet e pensioneve të menaxhuara privatisht. Këto sisteme janë shpesh të referuara si Shtylla e tretë (World Bank, 1994).

¹⁴ <http://www.oecd.org/els/public-pensions/PAG2013-profile-Denmark.pdf>

¹⁵ A comparison of US and UK pension security systems . David O. Harris Consultant Watson Wyatt
Ëorldeide International Pensions Seminar 7 June 2001 Brighton, United Kingdom

¹⁶ The German Public Pension System: How it Was, Hoë it Will Be . Axel Boersch-Supan, Christina B. Eilke NBER Ëorking Paper No. 10525

Në fillim të vitit 1994, shumica e botës kishte Shtyllën e parë të sistemeve. Në kuadër të Shtyllës së parë, prirja është drejt shtrëngimit të lidhjes midis kontributeve dhe përfitimeve. Ndryshimi më thelbësor dhe inovativ ka qenë zbatimi i skemave DC deri tani në gjashtë vende: Itali, Kirgistan, Letoni, Mongoli, Poloni dhe Suedi¹⁷. Në kuadër të Shtyllës 2, risitë janë drejtuar tek shpenzimet në drejtimin të sistemeve me llogari individuale financiare.

¹⁷ Pension Reform: Issues and Prospects for Non-financial Defined Contribution (NDC) Schemes, edited by Robert Holzmann, Edward E. Palmer

KAPITULLI IV → REFORMIMI I SISTEMIT TE PENSIONEVE

IV.1 Arsye për reformimin e sistemit të pensionit

Arritja e “qëndrueshmërisë”, ka qenë objektivi kryesor që hartuesit e politikave kanë synuar kur kanë ndërmarrë reformimin e sistemit të pensioneve. Rëndësia e arritjes së qëndrueshmërisë afatgjatë të sistemeve të pensionit dhe sfidat e mëdha me të cilat përballen, ka bërë të domosdoshme që hartuesit e politikave duhet të miratojnë një përkufizim më të plotë të qëndrueshmërisë. Duke parë nga e ardhmja, politikëbërësit duhet të sigurojë jo vetëm që presioni mbi kufizimet po menaxhohet si duhet, por edhe sistemi e pensioneve mbetet në fuqi dhe është në gjendje për të arritur qëllimet që pritet. Politikëbërësit duhet të jenë në gjendje të ndajë ndikimin e reformave në zbutjen e varfërisë dhe në funksion të uljes së konsumit, në veçanti për grupet me të ardhurat e ulëta dhe/ose karrierë të pjesshme, së bashku me ndikimin që reformat kanë në madhësia relative e transfertave midis brezave, si në aspektin e pasurisë neto të pensioneve që rrjedh për gjeneratat e ardhshme dhe normat e kontributeve të nevojshme për të financuar këto transfertat.

Qëllimi kryesor i një sistemi pensioni duhet të jetë sigurimi i përfitimeve, të përshtatshme, të përballueshme dhe të qëndrueshme gjatë pleqërisë (Holzmann & Hinz, 2005). Bankat synojnë të realizojnë të gjitha këto dhe arsyeja e madhe e përfshirjes së Bankës në reformat e pensioneve është për shkak të implikimeve fiskale, kryesisht tek sistemet me përfitim të përcaktuar, edhe pse ndonjëherë mund të përfshihen edhe përfitimet e asistencës sociale për të moshuarit. Sistemet rrallëherë janë të projektuara që në fillim të ekzistencës së tyre në mënyrë të përkryer, pasi me plakjen e popullsisë dhe ndryshimet në kontributin e fuqisë punëtore, sistemet fillojnë të shfaqin probleme.

Deficitet e sistemit të pensioneve mund të jenë relativisht të mëdha në raport me prodhimin e përgjithshëm të brendshëm bruto dhe deficitet e përgjithshme të një vendi.

Këto deficite të mëdha kanë ndikime të mëdha në shpërndarje, sidomos në vendet me mbulim të ulët të fuqisë punëtore. Në qoftë se vetëm 5-10 për qind e fuqisë punëtore është pjesë e sistemit të pensioneve, dhe sistemi krijon deficit që duhet të financohet nga të ardhurat e përgjithshme, vlerat monetare nga të gjithë individët që kontribuojnë në të ardhurat e përgjithshme do të transferohen në 5-10 për qind të popullsisë që është e mbuluar nga sistemi i pensioneve, duke e bërë një sistem të projektuar në mënyrë progresive të jetë potencialisht regresiv. Duke pasur parasysh transferimin e madh që ndodh midis brezave në sistemet me përfitim të përcaktuara dhe mbulimin e ulët, kombinuar me financimin e deficiteve nga të ardhurat e përgjithshme, shtyn koston e sigurimit të pensioneve jo vetëm te grupi i të rinjve të mbuluar nga sistemi, por edhe te grupmoshat e të rinjve të cilët nuk janë të mbuluara nga sistemi, duke e bërë ndikimin më regresiv. Si rezultat, fokusi i Bankës Botërore në reformën e pensioneve është ulja e deficitit fiskal, në mënyrë që sistemi i pensioneve, në qoftë se është i kufizuar në mbulim, të financohet nga kontributet e kësaj popullsie të kufizuar dhe jo përmes transfertave nga popullsia në tërësi.

Reformat e pensioneve janë përpjekur dhe synojnë të rrisin mbulimin si një mjet për të garantuar sigurinë për personat e moshuar, për një segment të gjerë të popullsisë, por shumica e përpjekjet për rritjen e mbulimit nuk kanë qenë të suksesshme. Një rezultat fillestar pozitiv ka ndodhur në Meksikë¹⁸, ku qeveria jep një kontribut të sheshtë për ditë të kontributit të punëtorit në sistemin me kontribut të përcaktuar, i cili arrin në rreth 5.5 për qind e pagës minimale. Kontributi i qeverisë dyfishon kontributin që shkon te

¹⁸ OECD Reviews of Pension Systems: Mexico 2016

fondi i pensioneve për punëtorët me të ardhura të ulta, gjë që rrit nxitjen për punëtorët me të ardhura të ulëta për të kontribuar. Prej implementimit të këtij kontributi qeveria ka nxitur mbulimin midis personave me të ardhura të ulta.

Por, për shkak se ka pak shembuj të suksesshëm, qeveritë janë kthyer tek pensionet e asistencës sociale, si një mjet për të siguruar mbështetje për personat e moshuar të cilët nuk janë të mbuluara nga programet me kontribut social, në vend të gjenden zgjidhje për të zgjeruar mbulimin. Këto programe ndihmash sociale, në disa raste, janë të përfshira brenda asistencës së përgjithshme sociale dhe në raste të tjera, ata ekzistojnë si programe më vete, ose janë të lidhura me sistemin kontributiv të pensioneve.

Vendet me sisteme me kontribut të përcaktuar që me vështirësi krijojnë kthime nga investimet, hasin shumë vështirësi nëse një numër i konsiderueshëm i të moshuarve bie nën nivelin e varfërisë. Mbikëqyrja dhe rregullimi i përshtatshëm i këtij lloji të fondit të pensionit dhe të sistemeve të pensioneve vullnetare duhet të bëhet së bashku me fleksibilitetin në investimin e aseteve, në mënyrë që fondet e investimeve të furnizojnë një kthim të mjaftueshëm për punëtorët që sigurojnë kontribute. Në disa raste, qeveritë i shohin rezervat e fondit të pensionit si një burim të gatshëm për financimin e çfarëdo investimi të motivuar politikisht që ata dëshirojnë të bëjnë. Përmirësimet në funksionimin e tregjeve të kapitalit mund të jenë të nevojshme përpara se fondet e pensioneve të mund të ofrojnë mbështetjen e duhur në pleqëri.

IV.2 Llojet e reforma në sistemet e pensioneve dhe pasojat e shpërndarjes

Arsyeja kryesore, deri tani, për reformat e sistemeve të pensionit ka qenë për të adresuar ndikimin fiskal, reformat janë përqendruar kryesisht në përmirësimin e deficitit fiskal. Nga pikëpamja e shpërndarjes, ky është fokusi i duhur duke pasur parasysh mbulimin jo

të plotë dhe potencialin për shpërndarjen regressive të të ardhurave nga grupet e pambuluara me të ardhura të ulëta tek grupet me të ardhura dhe mbulim më të lartë. Çdo reformë që ul deficitin fiskal do të jetë e dobishme nga një perspektivë shpërndarje.

Reformat e pensioneve mund të grupohen në të paktën katër kategori të ndryshme: reformat parametrike, të cilat përfshijnë ndryshime në parametrat e sistemit aktual të pensioneve; reforma sistematike, të cilat përfshijnë futjen e një lloji të ri të sistemit të pensioneve për të zëvendësuar apo plotësuar sistemin ekzistues; reforma rregullatore, të cilat përfshijnë ndryshime në rregullat e investimeve për fondet që kanë asete, të cilat mund të investohen; dhe reformat administrative.

VI.2.1 Reformat parametrike

Sistemet e pensioneve mbështetet në tri nëngrupe të parametrave: *parametrat e kontributeve*, *parametrat e përfitimit*, dhe *kushtet për marrjen e pensionit*. Shumë reforma parametrike përfshijnë ndryshime në të tre nëngrupet. Secili nga këto nëngrupe parametrash ka ndikim distributiv midis kontribuesve dhe përfituesve. Reforma duhet të ndikojë edhe në qëndrueshmërinë fiskale të sistemit të pensioneve, dhe qëndrueshmëria fiskale ndikon në rishpërndarjen nga jashtë sistemit të pensioneve në kontribuesit dhe përfituesit e sistemit të pensioneve.

1. Parametrat kontribut – të ardhura zbatohen si për sistemin me përfitim të përcaktuar dhe në sistemet me kontribut të përcaktuar, si dhe tek sistemet vullnetare. Megjithatë, ndikimi në qëndrueshmërinë fiskale kryesisht ndodh në sistemet me përfitim të përcaktuar. Parametrat përfshijnë:

- *Normat e kontributeve* - Rritja e normave të kontributeve ul në mënyrë të qartë pagat që punëtorët çojnë në shtëpi, si dhe përfitimet neto që punëtorët marrin

nga sistemi i pensioneve. Rritja e kostove të punës mund të zvogëlojë ose të shkaktojë stanjacion në nivelin e punësimit në sektorin formal. Këto kanë një ndikim negativ tek punëtorët, por mund të jenë të nevojshme për të ruajtur bilancin fiskal. Normat e kontributeve mbi 15 për qind kanë të ngjarë të kenë ndikim negativ në tregun e punës.

- *Pagat që janë subjekt i kontributeve* - Rritja e tavanit të pagave që janë subjekt i kontributeve, një tjetër masë e zakonshme, që ka tendencë të ketë ndikim pozitiv në shpërndarje nëse punëtorët me pagë më të lartë paguajnë më shumë nga të ardhurat e tyre në fondin e pensioneve, edhe pse në terma afatgjatë ata do të marrin gjithashtu përfitime më të larta. Kështu, ndërkohë që mund të ketë një efekt pozitiv rishpërndarës në afat të shkurtër, do të ketë pak ndikim në afat të gjatë përderisa përfitimet e individëve me të ardhura më të larta do të rritet, veçanërisht nëse përfitimet e larta afatgjata nuk janë të qëndrueshme nga ana fiskale.

2. Parametrat e përfitimit përfshijnë:

- *Norma e mbledhur* (shkalla e përfitimit për vit shërbimi) - Ulja e normës së mbledhur në mënyrë të qartë përkeqëson pozitën e pensionistëve dhe ul normen e tyre neto të kthimit nga sistemi, por kur sistemi shkon drejt deficitit, ajo ndihmon për të shmangur transferimet nga grupi i të rinjve dhe njerëzve që nuk mbulohen nga sistemi.
- *Periudha mesatare për pagat* - Periudha mesatare e pagave idealisht do të ishte mbi pagat e gjithë jetës, e cila e lidh në mënyrë më të mirë kontributin mesatar të paguar me përfitimin mesatar. Kalimi drejt periudhës mesatare të pagës ka

tendencë të jetë progresiv, pasi punonjësit që fitojnë të ardhura të larta do të fitojnë pensione bazuar në këto të ardhura.

- *Rivlerësimi i pagave* - Pagat duhet të rivlerësohet në bazë të rritjes mesatare të pagave në mënyrë që të sigurojnë stimuj për punëtorët për të kontribuar gjatë viteve të tyre të hershme. Kjo mund të mendohet si një mjet për të siguruar normën e kthimit të kontributeve. Rivlerësimi i pagave në raport me rritjen mesatare të pagës është i nevojshem për t'u dhënë puntorëve një normë kthimi të kontributeve të tyre që është i barabartë me rritjen e pagave. Rivlerësimi më i ulët i pagave, mundet teorikisht, të çojë në qëndrueshmëri më të madhe fiskale, por zakonisht rezulton në më shumë evazion, pasi punëtorët fitojnë normë kthimi të ulët për kontributet e hershme dhe kjo minon qëndrueshmërinë fiskale.
- *Indeksi i pensioneve pas daljes në pension* - Indeksi i pensioneve pas daljes në pension në mënyrë ideale duhet të ndërmerret në lidhje me inflacionin për të mbrojtur fuqinë blerëse të pensionistëve pas daljes në pension. Mungesa e rezultateve të indeksimit në marrjen e pensionit tek të moshuarit në moshë krijon më pak mbrojtje sesa tek të moshuarit, të cilët sapo kanë dalë në pension dhe mund të jenë në gjendje për të punuar akoma. Gratë, të cilat në përgjithësi jetojnë më gjatë se burrat, janë gjithashtu në disavantazh në mënyrë disproporcionale nga mungesa e indeksimit, pasi pensionet e tyre në të vërtetë do të shpërndahen mbi një numër më të madh vitesh. Indeksi i rritjes së pagave është në thelb i papërbalueshëm për shumicën e vendeve dhe jo i justifikueshëm nga këndvështrimi që pensionistët nuk kanë nevojë për të rritur konsumin e tyre gjatë viteve të pensionit, duke supozuar se shpenzimet shëndetësore janë mbuluar, pavarësisht se si ndryshon paga mesatare në raport

me pensionin. Indeksimi i pensioneve pas daljes në pension është një çështje edhe në sistemet me përfitim të percaktuar dhe në sistemet me kontribut të percaktuar si dhe e përfitimeve jo kontributive.

- *Pensioni minimal* - Niveli i pensionit minimal është vendosur mjaft lart në shumë vende, ndonjëherë aq i lartë apo edhe më i lartë se minimumi i pagës. Duke pasur parasysh se punëtorët me paga minimale japin kontribute nga pagat e tyre, kanë familje për të mbështetur dhe paguajnë tatimet nga të ardhurat, ndërsa pensionistët nuk japin kontribute, kanë më pak anëtarë në familje për të mbështetur dhe zakonisht nuk paguajnë asnjë taksë për të ardhurat, nuk ka kuptim t'ju jepet pensionistëve më shumë se paga neto që ata kanë fituar kur ata ishin në punë. Ulja e pensionit minimal mund të çojë disa pensionistë në varfëri, por kjo duhet të jetë e balancuar kundrejt qëllimit për të kufizuar transferimet jashtë sistemit dhe për të inkurajuar derdhjen e kontributeve lidhur me përfitimet. Pensioni minimal ndikon në të dy sistemet me përfitim të percaktuar dhe kontribut të percaktuar, si dhe në përfitimet jo kontributive, të cilat janë një formë e pensionit minimal.

3. Kushtet për përfitim përfshijnë:

- *Moshën e daljes në pension* - Në mënyrë ideale, mosha e daljes në pension do të rritet me rritjen e jetëgjatësisë dhe aftësinë e popullsisë më të vjetër për të punuar me rritjen e moshës, duke kufizuar përfitimet e pensioneve për ata njerëz që janë konsideruar shumë të vjetër për të punuar. Qëllimi i sistemit të pensioneve është të sigurojë një mesatare prej 15 vjet në pension. Në shumicën e rasteve, duke ngritur moshën e pensionit mund të zvogëlohet numri i individëve me të ardhura të ulëta të cilët kontribuojnë për pension. Barazimi i moshës së

pensionit për burra dhe gra ka tendencë të jetë pro grave, pasi ajo në thelb ngre nivelet e pensionit për shumicën e grave. Ndryshimet në moshën e pensionimit ndikojnë të dy sistemet, si ato me kontribut të përcaktuar dhe ato me përfitim të përcaktuar, por gjithashtu edhe sistemet me kontribut vullnetar dhe pa kontribute. Në sistemet me përfitim të përcaktuar dhe ato pa kontribute, ndryshimet në moshën e daljes në pension përmirësojnë qëndrueshmërinë fiskale, ndërsa, në rastin e sistemeve me kontribut të përcaktuar dhe sistemet vullnetare, ngrejnë nivelin e pensioneve.

- *Vitet e shërbimit të nevojshme para marrjes së pensionit* - Rritja e numrit të viteve të nevojshme para se një individ mund të marrë një pension të plotë në mënyrë të ngjashme mund të diskriminojë individët me të ardhura të ulëta, të cilët në përgjithësi kanë karrierë pune më të shkurtër, por përsëri, dallimet në popullsinë e mbuluar nuk mund të jenë aq të mëdha dhe ky problem mund të adresohet duke siguruar pensione të pjesshme.
- *Vlerësimin e mjeteve në dispozicion* - Në rastin e përfitimeve pa kontribut, shtetet shpesh vlerësojnë mjetet në dispozicion të individëve për të ulur koston fiskale dhe për të përcaktuar kushtet kualifikuese për përfitim. Këto dy mënyra reduktojnë numrin e përfituesve, duke ulur transferimin nga forca e punës tek të moshuarit.

Në pothuajse të gjitha rastet, reformat parametrike, veçanërisht ato në sistemet me përfitime të përcaktuara, do të reduktojnë nivelin e pensioneve dhe kështu potencialisht të riskojnë më të moshuarit nga varfëria ose të kërkojnë kontribute më të mëdha nga punonjësit, duke riskuar edhe pjesën tjetër të popullsisë nga varfëria. Pavarësisht kësaj, këto masa janë ende thelbësore për ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit të pensionit.

Pa këto masa, sistemi i pensioneve do të kalojë krizën fiskale të tij në sektorë të tjerë, do inkurajojë përdorimin e inflacionit për të mbuluar shpenzimet e deficitit ose do të fillojnë të grumbullojnë borxhe. Asnjë nga këto mundësi nuk ka pasoja pozitive për shoqërinë. Akumulimi i borxheve është veçanërisht i dëmshëm për individët të cilët kanë arritur moshën e pensioneve dhe papritmas e gjejnë veten pa përfitime.

Qëndrueshmëria e sistemit të pensioneve bëhet edhe më shumë një çështje sociale, kur mbulimi me pension nuk është i plotë dhe burimet fiskale duhet të nxirren nga pjesa tjetër e popullsisë, zakonisht nga individët me të ardhura të lartë. Për më tepër shumë masa përmirësojnë pasojat e rishpërndarjes së sistemeve të pensioneve dhe rregullojnë pasojat negative të paqëllimshme. Ato mund të bëjnë sistemet e pensioneve më të drejtë duke lidhur drejtpërdrejt pensionin e përfituar me kontributin e derdhur dhe një perceptim më i lartë i drejtësisë mund të përmirësojë përmbushjen e kontributit.

IV.3 Reformat e pensioneve në Europën Qendrore dhe Lindore

Në fund të viteve 1990 dhe fillim të viteve 2000 u pa një valë reformash pensionale në Europën Qendrore dhe Lindore. Në ekonomitë në tranzicion, shpërndarja e të ardhurave në mënyrë dramatike gjatë dekadës së parë të tranzicionit, dhe në përgjithësi, varfëria ishte e lartë, veçanërisht në zonat rurale. Raportet e sistemit të varësisë nga rreth 2.5 punëtorë për pensionist në vitin 1980 bien në rreth 1.5 në vitin 1990. Kalimi nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e tregut solli një varg problemesh të reja për diskutim në reformën e pensioneve, si:

— Borxhi i lartë fillestar i nënkuptuar. Të drejtat dhe angazhimet e fituara për përfituesit ishin të pandryshuara pas tranzicionit, por mjetet në dispozicion të

qeverive për të mbledhur të ardhurat për të përmbushur angazhimet aktuale dhe të ardhshme kishin ndryshuar në mënyrë dramatike.

- Kapacitete të dobëta të administratës. Institucionet administrative që mund të punojnë në një ekonomi të tregut ishin të nevojshme për t'u krijuar.
- Rënie e numrit të kontribuesve. Pas rënies së komandës së ekonomisë, fatura e pagave të mbuluara mbeti relativisht e larta në vendet e pasura në tranzicion, (Europa Qendrore), por ra në mënyrë dramatike në vendet e varfëra, (ish-CIS). Kjo u shkaktua nga rënia e aktivitetit ekonomik, rënia në pjesëmarrjen e femrave në fuqinë punëtore, dhe lëvizje të konsiderueshme në ekonominë informale.
- Pagesa për shumë grupe të avantazhuara. Trashëgimitë dhe privilegjet e veçanta për grupe të zgjedhura krijuan probleme në lëvizjen drejt sistemit të pensioneve të detyrueshme, të përshtatshme për ekonominë e tregut.
- Mosha e ulët e daljes në pension. Në të gjitha vendet post-sovjetike dhe të Europës Lindore, mosha e pensioneve ishte 60 vjec për meshkujt, dhe vetëm 55 vjec për femrat, edhe pse hendeuku në jetëgjatësi midis meshkujve dhe femrave është 7-10 vjet në favor të femrave, dhe pjesëmarrja në forcat e punës e burrave dhe grave deri në moshën e pensionit është shpesh pothuajse e njëjtë.

Tabloja në zhvillim në vitin 1990 nuk ishte plotësisht e zymtë. Një arsye ishte sepse me kalimin erdhi edhe pritja publike dhe kërkesa për ndryshim e orientuar drejt tregut. Një tjetër është se presioni demografik do të vijë më vonë se në vendet OECD, duke siguruar një dritare të shkurtër demografike të mundësive për reformën e sistemit.

Fillimisht, politika e ndjekur nga këto vende ishte kryesisht reaktive. Ato ishin të detyruara të shkurtonin pagesat e përfitimeve për të përmbushur burimet financiare. Rezultati i përgjithshëm ishte shfaqja e përfitimeve të sheshta të indeksimit të çmimeve,

kur kjo ishte e përballueshme. Në vendet e varfëra, edhe pas stabilizimit, përfitimet ende vareshin në çfarëdo mënyre në dispozicion, në vend të respektimit të formulës së përfitimit. Pas viteve 1990 politika u bë proaktive.

Hapi i parë është marrë në fazën e privilegjeve për grupe të veçanta, ku vihen re dy qasje. Qasja e parë, e cila është ndjekur nga shumica e vendeve, ndërpret dhënien e të drejtave të reja dhe konvertimin e të drejtave tashmë të fituara në skemën e vjetër, në të drejta në një skemë publike të reformuar.

Qasja e dytë kthen të drejtat e fituara në skemat e reja të krijuara në punë. Kjo qasje është ndjekur në Poloni¹⁹, duke bërë konvertimin e të drejtave të fituara të një grupi të madh të minatorëve në një skemë punësimi.

Rritja e moshës së pensionit ka provuar të jetë një çështje veçanërisht e vështirë. Hungaria²⁰ ishte ndër vendet e para që ka futur me sukses një rritje graduale në një moshë më të lartë të daljes në pension (62 vjec) për të dyja gjinitë, burrat dhe gratë. Kroacia ka ndjekur po këtë model. Propozimet për të barazuar moshën e pensionit të grave dhe burrave në Poloni dhe Rusi u përballën me mbrojtjen e zhurmshme (dhe mbajtjen) e status quo-së. Letonia²¹ jep një model tjetër. Në vitin 1995, sipas legjislacionit ishte planifikuar një rritje e moshës minimale të pensionit për gratë me një vit e gjysmë në vit në moshën 60 vjec, por për shkak të protestave, Parlamenti ndryshoi mendje për të lejuar gratë të vazhdojnë të marrin pensione të vogla nga mosha 55 vjec. Si rezultat, shumica e grave merrte një përfitim të reduktuar nga mosha 56 vjec, shpesh

¹⁹ Pension reform in Poland impact on retirement incomes Agnieszka Chlon-Dominczak Ministry of Labour and Social Policy Helsinki, December 4, 2006

²⁰ The sustainability of the Hungarian pension system: a reassessment (A magyar nyugdíjrendszer enttarthatósága) Ęritten by: Gábor Orbán–Dániel Palotai (Economics Department, Magyar Nemzeti Bank) December 2005

²¹ Latvian Pension Reform. Louise Fox Edëard Palmer .August 1999

në një shumë minimale. Këto gra do të përfitojnë më shumë se do të jetojnë më gjatë se burrat e tyre me rreth shtatë vjet. Për fat të keq, ky model, i cili është i ngjashëm në shumë nga vendet në tranzicion, ka të ngjarë të rrisë numrin e të varfërve afatgjatë.

Në mes të viteve 1990, vendet filluan të punojnë në ndryshimet sistematike. Në legjislacionin e miratuar në vitin 1995 dhe zbatuar në vitin 1996, Letonia u bë vendi i parë që krijoi shtyllën e parë nga konvertimi i angazhimeve pay as you go të fituara gjatë regjimit të mëparshëm në llogaritë DC në sistemin pay as you go. Në vitin 1997, Hungaria pati ligjëruar reformën tjetër sistematike, që lidh kontributet për përfitime nëpërmjet futjes, në vitin 1998, të një sistemi të llogarisë financiare për të plotësuar sistemin pay as you go. Hyrje të reja janë mandatuar në sistemin e llogarisë financiare. Për një punëtor në sistemin e ri, 1/3 e sistemit pay as you go është zëvendësuar nga një llogari financiare me një fond pensional²². Gjatë periudhës së zgjedhjes, njerëzve u jepet informacion për të ndihmuar ata të vendosin se cilat alternative ka të ngjarë të jetë më e mirë për ta. Në vitin 1997, Kazakistan²³ u bë i pari vend (dhe deri më sot i vetëmi) nga ekonomitë e tranzicionit që ndoqi shembullin e Kilit në kalimin nga sistemi pay as you go publik në një sistem fondi pensional të kontributeve dhe mbajtjen e angazhimeve të sigurimeve shoqërore nga ana e shtetit me anë të lëshimit të bonove qeveritare. Në vitin 1998, Polonia miratoi ligje për një reformë për shtyllën e dytë të skemës së vjetër pay as you go, me në krye një sistem të detyrueshëm të llogarisë financiare, që ka për qëllim të japë një ndarje 50:50 të kontributeve midis skemave të llogarive financiare të shtyllës së dytë. Me zbatimin në vitin 1999, polakët nën 30 vjeç në vitin 1999, janë mandatuar për të marrë pjesë (me një normë të kontributit 9%) në sistemin e shtyllës së dytë, dhe personat 30-50 vjeç kanë fituar mundësinë për t'ju bashkuar asaj.

²² The Hungarian Pension Reform: A Preliminary Assessment of the First Years of Implementation Author: Roberto Rocha, Dimitri Vittas. 2002

²³ Pension System Reform in Emerging Countries *The Case of Kazakhstan* Meiram Zhandildin. 2015

Në Kroaci²⁴, shtylla e dytë është e detyrueshme për personat nën 40 vjec, dhe me dëshirë për personat 40-49 vjec. Letonia ndoqi reformën e saj së shtyllës së dytë me legjislacionin e llogarisë financiare të miratuar në fillim të vitit 2000. Në vitin 2001, Letonia filloi në një ndarje të normës së kontributit prej 20% në mes të skemave të llogarive financiare të shtyllës së dytë.

Vendet e tjera kanë ndërmarrë reforma sistematike të sistemeve Shtyllave të para, pa përfshirë Shtyllat e dyta. Këto vende kanë reduktuar rrugët për dalje të hershme, sidomos midis grupeve të veçanta, dhe kanë shtrënguar formulën e përfitimit në sistemet pay as you go. Shembujt përfshijnë Republikën Çeke²⁵ (një nga të parat e fazës së privilegjeve të veçanta), Estoninë, Gjeorgjinë (me pensionet e sheshtë dhe një rritje në moshën e pensionit me 5 vjet), Lituaninë, Moldavinë dhe Rumaninë. Disa nga këto vende tani po punojnë për të shtuar fondet për sistemet e tyre, duke përdorur hapësirën fiskale të krijuar nga reformat.

Edhe pse ka pasur një valë inovacioni në disa prej vendeve në tranzicion, reforma ka qenë e ngadalshme në pjesën më të madhe të popullsisë në këtë zonë (kryesisht për shkak se Rusia nuk e ka reformuar akoma sistemin). Dekada që vjen pritet të sjellë edhe më shumë risi, në të gjitha këto vende në tranzicion. Sfidat janë projektimi i sistemeve të përfitimit që minimizojnë kostot afatgjata, duke ofruar stimuj për punëtorët e rinj për të marrë pjesë në skemat e pensioneve, por edhe për të ofruar siguri për punëtorët aktual në kufijtë e tranzicionit. Kjo nënkupton që të lidh fort përfitime me kontributeve e paguara, për punëtorët e rinj, duke krijuar një mesazh të qartë për ata që nuk paguajnë kontributet e tyre, ndoshta do të mbeten përgjithmone jashtë këtyre skemave dhe mund

²⁴ Pension Reform in Croatia. Zoran Anusic, Philip O'Keefe, and Sanja Madzarevic-Sujster . February 05, 2003

²⁵ Pension Reform Issues and Prospects for Non-Financial Defined Contribution (NDC) Schemes Edited by Robert Holzmann and Edëard Palmer

të përfitojnë vetëm nga skemat e asistences kur të mbushin moshën e tyre për pension. Në disa pjesë të rajonit, edhe pse janë futur skemat e të ardhurave, shumica e popullsisë mund të jetë kryesisht ose tërësisht jashtë sistemit për shkak të rritjes të sektorëve urbane informale dhe rurale.

Në shtyllën e dytë të sistemeve të llogarisë financiare janë përdorur mekanizma të ndryshëm, që përfshijnë:

- reduktimin e angazhimeve pay as you go për pensionistët – zakonisht nëpërmjet ndryshimit të formulave të indeksimit;
- reduktimin e angazhimeve pay as you go për të paraqitur punëtorët - duke forcuar rregullat e përfitimit;
- përfitimin nga ciklet demografike;
- lëvizjen e pasurive të tjera në sistemin e pensioneve, për të ndihmuar në financimin e tranzicionit;
- mbledhjen e më shumë kontribute sesa janë kredituar në llogaritë individuale, e cila është vetëm një formë e taksimit të përgjithshëm,
- reduktimin e formave të tjera të shpenzimeve për konsum nga qeveria (duke krijuar një suficit buxhetor, për të ndihmuar financimin e angazhimeve të vjetra pay as you go).

IV.4 Treguesit kryesorë të skemave të pensionit

Norma kontributive - është një tregues që lidhet drejtpërdrejt me nivelin e të ardhurave të skemës së pensioneve. Ajo shprehet në përqindje dhe tregon se sa përqind e pagës do të shkojë për kontribute të sigurimeve shoqërore. Pjesa kryesore e saj shkon vetëm për degën e pensionit, ndërsa pjesa e mbetur shërben për degët e tjera të sigurimit. Shuma e

kontributit që paguhet mbi bazën e normës kontributive dhe pagës quhet masë e kontributit dhe shprehet në njësi monetare. Ky tregues është i rëndësishëm pasi në bazë të tij llogariten pensionet dhe treguesve të tjerë, llogariten të ardhurat që shkojnë për pagimin e pensioneve dhe detyrimet e mëvonshme të skemës për këtë përfitim.

Norma e zëvendësimit - është një tregues që tregon se në ç'masë pensioni zëvendëson të ardhurat nga paga. Ajo llogaritet si raport i pagës me pensionin dhe shprehet në përqindje. Ky tregues është gjithmonë më i vogël se 100%. Në vende të ndryshme norma e zëvendësimit është e ndryshme, por në bazë të Konventës Nr. 102 të ILO-s, ky tregues nuk duhet të jetë më i ulët se 40%. Norma e zëvendësimit llogaritet për tërë skemën e pensionit si normë mesatare zëvendësimi, si dhe për nivele të ndryshme page, si p.sh., për pagën minimale dhe pagën maksimale. Kur ky tregues është në nivelin e 50-60%, mund të themi se skema e pensionit jep pensione të kënaqshme, që krijojnë mundësinë për një jetesë të mirë për moshën e tretë.

Jetëgjatësia në lindje - është një tregues i rëndësishëm për të kuptuar periudhën në të cilën individët punojnë dhe paguajnë kontribute, si dhe periudhën në të cilën trajtohen me pension. Një nivel i lartë i jetëgjatësië na lejon të kuptojmë që individët gëzojnë pension për një periudhë të gjatë dhe jep indikacione për ndryshimet që mund t'i bëhen skemës përsa i përket periudhës së punës, moshës së daljes në pension si dhe nivelit të pensionit. Ky tregues llogaritet si mesatare e jetës të gjithë qytetarëve në një kohë të caktuar.

Jetëgjatësia në moshën e pensionit - është një tregues i rëndësishëm për skemën e pensionit pasi tregon për vitet e gëzimit të pensionit. Ajo llogaritet për çdo vit si mesatare e gëzimit të pensionit për të gjithë pensionistët e një vendi. Tendenca e këtij treguesi është në rritje në çdo vend të botës dhe vendi ynë nuk bën përjashtim nga kjo

tendencë. Në bazë të këtij treguesi llogariten detyrimet e skemës në periudha afatgjata, niveli i pensionit, norma kontributive, periudha kontributive, si dhe qëndrueshmëria financiare e skemës në periudhën afatgjatë.

Vjetërsia në punë - kupton periudhën gjatë së cilës një individ punon dhe paguan kontribute të sigurimeve shoqërore dhe ndryshe quhet periudha kontributive. Për llogari të sigurimeve shoqërore dhe pensionit në veçanti, vjetërsi në punë quhet periudha për në cilën janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe jo periudha e punës në tregun informal të punës, ku nuk janë paguar kontributet.

Norma e varësisë së sistemit (NVS) - është raporti midis numrit të kontribuesve me numrin e pensionistëve në një periudhë të caktuar që zakonisht është viti. Ajo varet nga numri i kontribuesve në skemë dhe nga numri i pensionistëve që përfitojnë nga skema. Sa më i madh të jetë ky tregues aq më të qëndrueshme financiarisht janë skemat e pensionit sepse të ardhurat janë më të larta se shpenzimet. Në vendet me popullsi të re dhe me nivel të lartë punësimi përgjithësisht është e lartë dhe skemat e pensionit nuk vuajnë nga pikëpamja financiare. Në madhësinë e këtij treguesi nuk ndikon vetëm mosha mesatare e popullsisë, por edhe faktorë të tjerë ekonomikë dhe sociale, si niveli i papunësisë, niveli i ekonomisë informale, etj. Ky tregues është i rëndësishëm për skemat publike që funksionojmë sipas parimit pay as you go dhe më pak tek skemat me akumulim kapitali.

Shkalla e mbulimit - llogaritet si raport i numrit të kontribuesve me numrin e forcave të punës (numri i individëve me moshë nga 16 vjeç deri në moshën e daljes në pension)²⁶.

Ajo tregon se ç'pjesë e popullsisë aktive për punë është e mbrojtur nga elementë të sigurimeve shoqërore. Sa më i lartë të jetë ky tregues aq më të mbrojtur janë qytetarët e

²⁶ Kodit i Punes (nenet 98, 99) mosha minimale per pune e femijeve eshte 16 vjec. Femijet nga 14-18 vjec mund te punojne ne pune te lehta gjate pushimeve shkollore. Punet e lehta dhe oraret e tyre percaktohen nga Keshilli i Ministrave.

një vendi. Ky tregues varet nga aksesit që kanë individët në tregun e punës, niveli i zhvillimit dhe vëllimi i tregut të punës dhe nga struktura moshore e popullsisë.

IV.5 Tipet, llogaritja dhe niveli i përfitimeve

IV.5.1 Tipet e përfitimeve

— Pagesa një-herëshe në dorë

Përfitimet e pleqërisë zakonisht marrin formën e pagesave periodike (pensionet); sidoqoftë, në disa skema ose në disa raste, ato paguhen edhe në formën e një pagesë një-herëshe në dorë. Megjithatë sipas instrumentave të ILO-s (Konventat Nr. 102 dhe 128), përfitimet e pleqërisë duhet të jenë në formën e pagesave periodike, fondet kombëtare të kursimeve zakonisht bëjnë një pagesë të vetme një-herëshe në dorë. E njëjta gjë zbatohet tek disa skema private suplementare në vende të ndryshme. Egzistojnë gjithashtu skema të ndryshme, të cilat paguajnë pagesën një-herëshe në dorë në rastin kur personi i siguruar nuk plotëson kushtet e kërkuara për marrjen e një pensioni.

— Fondet kombëtarë të kursimeve

Fondet kombëtarë të kursimeve ofrojnë për moshën të veçantë pagesën një-herëshe në dorë, me një shumë të barabartë me shumën e grumbulluar të kontributeve të paguara nga personi i siguruar dhe nga punëdhësi i tij, së bashku me interesat e grumbulluara. Disa legjislacione lejojnë që ky kapital mund të përdoret për të blerë një pagesë vjetore, ndonëse kjo praktikë është zbatuar shumë pak. Në raste shumë të rralla, edhe skemat e sigurimeve shoqërore e bëjnë pagesën një-herëshe në dorë. Disa mendojnë se pagesa një-herëshe në dorë mund të jetë një procedurë që i përshtatet nevojave të vendeve në zhvillim; p.sh., kur një rrogëtar i zonës urbane, pas daljes në pension, e përdor këtë kapital për të ndërtuar një aktivitet ekonomik në mjedisin ku ai jeton. Sidoqoftë,

eksperienca tregon se ka rrezik të konsiderueshëm që kapitali mund të përdoret për konsum ditor dhe për këtë arsye ai do të mund të asistojë pensionistin për shumë më pak kohë nga ç'mund të pritej nga pagesa e një përfitimi periodik. Si rrjedhim, përgjithsisht mendohet se pagesa një-herëshe në dorë e bërë nga fondet e kursimeve, ka pak gjasa të përballojë nevojat në vazhdim të përfituesve, kur ata dalin në pension dhe japin vetëm një kontribut të pjesshem për garantimin e të ardhurave për vjetët e mbetur të tyre.

— *Skemat e pensioneve private*

Një numër në rritje i të ashtuquajturave skema “pensioni” (pavarësisht emrit të tyre), në fakt paguajnë përfitimin një-herësh në dorë dhe jo pension. Ashtu si edhe në rastin e fondeve të kursimeve, ndonëse me më pak pasoja të rënda kur një skemë private plotëson një skemë publike që paguan pensione, kjo shumë e paguar një-herësh mund të shpenzohet sapo ajo të merret dhe ndaj ajo nuk mund të konsiderohet si element që e bën të mundur sigurinë ekonomike në pleqëri.

— *Moshat e ndryshme të llogaritjes së pensioneve*

Përsa i takon llogaritjes së pensioneve, në legjislacionet kombëtare hasen dy modele kryesore formulash (shpesh të kombinuara), në varësi të konceptit të rolit të pensioneve të pleqërisë.

Në modelin e parë, kushdo që plotëson kushtet e kërkuara (moshën dhe shpesh kohëzgjatjen e rezidencës në vend) merr pension në një normë të barabartë dhe uniforme, pavarësisht pagës ose të ardhurat gjatë karrierës profesionale të personit.

Në modelin e dytë, shuma e pensionit llogaritet mbi bazën e karrierës profesionale të personit të siguruar: për këtë arsye ajo lidhet me pagat dhe të ardhurat dhe mban gjithashtu në konsideratë kohëzgjatjen e karrierës së përfituesit.

Në rastin e parë, koncepti është që komuniteti duhet të kufizohet në garantimin për të gjithë të moshuarit të një egzistence minimale të denjë dhe, të paktën, ti mbajë ata larg skamjes. Ky lloj formule rrjedh nga koncepti i asistencës. Sidoqoftë, llogaritja e të ardhurave që kushtëzohet prej këtij koncepti, nuk është marrë në konsideratë me përjashtim të rastit të dhënies së suplementëve të veçantë të lidhur me pensionin bazë.

Në dallim me këtë, modeli i dytë përdoret në sigurimet shoqërore. Ai pranon faktin se mbrojtja reale e të moshuarve presupozon ruajtjen e standardit të jetesës në krahasim me atë që personi i siguruar kishte para daljes në pension dhe prandaj është e nevojshme, në të gjithë rastet, të evitohet rënia e ndjeshme e këtij standardi jetese. Në një masë të caktuar kjo formulë përputhet me konceptin e pensionit, i cili, në një farë mënyre, ofron shpërblim për shërbimet e shkuara.

Një formulë e ndërmjetme, që është diku midis dy formulave të përshkruara më lart, përcakton shumën e pensionit sipas gjatësisë së sigurimit, por pa marrë në konsideratë pagat dhe fitimet e personit të siguruar. Zbatimi i këtij lloji të formulës është i kufizuar.

Në fakt, egziston një prirje konverguese që mund të shihet në shumë legjislacione. Në vendet që kanë adoptuar formulën e përfitimit të sheshtë, dëshira për një të ardhur pensioni e krahasueshme me të ardhurat e realizuara gjatë punësimit, ka inkurajuar përpjekje suplementare. Kjo shpesh ka kushtëzuar solidaritetin kolektiv dhe ka rezultuar në vazhdim të një niveli të dytë mbrojtje. Në këto skema suplementare, e ardhura profesionale merret zakonisht në konsideratë kur llogariten pensionet në po të njëjtën mënyrë si ajo në ato vende që vendosën që në krye të herës një pension të lidhur me të ardhurat.

Vendet e rastit të dytë, në shqetësimin e tyre për të garantuar pensionistët më modestë me një shumë të denjë përfitimi, kanë prezantuar shpesh pensionet minimalë dhe kanë

formalizuar (p.sh., për ata me karrierë të pa kompletuar) përfitimet jo-kontributive, të cilat janë subjekt i llogaritjes së të ardhurave personale.

Rrjedhojat e këtyre tendencave janë shumë të ngjajshme me njëra tjetrën. Ato e bëjnë të mundshme rritjen e efektivitetit të mbrojtjes për të moshuarit, nëpërmjet garantimit për këdo të një egzistencë minimale të denjë; marrjen në konsideratë të burimeve të tyre dhe, për ata që kanë një histori punësimi, mbajtjen e një përqindje të të ardhurave të tyre të mëparshme profesionale.

— *Pensionet uniforme*

Pensionet uniforme janë ato të paguara në skemat që zbatohen ndaj të gjithë rezidentëve. Skema të tilla janë në shumicën e rasteve jo-kontributive. Sidoqoftë, disa skema të sigurimeve shoqërore paguajnë pensione të sheshta. Mund të ndodhë gjithashtu që e njëjta skemë të paguajë një pension të përbërë nga një bazë e sheshtë dhe nga një komponent i lidhur me të ardhurat. Kjo i referohet shpesh asaj që quhet formula e përfitimit dy-shtresash.

Duhet të vihet gjithashtu në dukje se shumat e “sheshta” mund të jenë objekt reduktimesh ose rritjesh. Kjo zbatohet në veçanti në skemat (aktualisht të pakta në numër) të cilat e vendosin metodën e llogaritjes mbi të ardhurat personale ose tek të gjithë personat e moshuar, ose tek ata që nuk e kanë arritur akoma një moshë të caktuar (p.sh., 70 vjeç). Shumë më shpesh, metoda e llogaritjes mbi të ardhurat personale do të zbatohet tek suplementët e pensionit, që i shtohen përfitimeve minimale.

Në shumicën e rasteve, pensioni është i pagueshëm kur përfituesi i ka plotësuar kushtet minimale të kualifikimit. Këto përgjithsisht përfshijnë një periudhë rezidence dhe në disa skema ajo është një periudhë e gjatë rezidence, p.sh., 40 ose 50 vjet, me synim marrjen e pensionit të plotë. Në ato skema sigurimi që paguajnë pensione të sheshtë, një

reduktim në shumën normale mund të bëhet për çdo person të siguruar që nuk ka pasur një karrierë profesionale të plotë në skemën e sigurimit. Përfitimi mund të vendoset në një masë uniforme për të gjithë ata që e kanë fituar këtë të drejtë. Gjithsesi në përgjithësi, bëhet dallim midis shumës së pensionit të pleqërisë të pagueshëm për një person të vetëm, dhe shumës së pagueshme për një çift të martuarish (kjo shumë është zakonisht më e vogël se dyfishi i shumës së pagueshme për personin e vetëm).

Së fundmi, masa e pensionit mund të variojë në mënyrë të konsiderueshme nga vendi në vend. Në disa vende ajo është ende nën nivelin e mbijetesës, kurse në vende të tjerë nivelet e përfitimeve janë ose në këtë nivel, ose sipër tij.

— *Pensionet jo të lidhura me të ardhurat që ndryshojnë në varësi të periudhës së sigurimit*

Një nga formulat e përdorura për përcaktimin e shumës së pensionit është llogaritja e kësaj shume vetëm në lidhje me gjatësinë e sigurimit, pa marrë në konsideratë pagat dhe të ardhurat e personit të siguruar. Kjo është një rrugë e mesme midis shumave të sheshta dhe atyre të lidhura me të ardhurat, ndonëse është më e afërt me sistemin e pensionit të sheshtë, veçanërisht kur flitet për reduktim në nivelin normal, po që se karriera e të siguruarit është e pakompletuar. Është rast i rrallë që kjo formulë të zbatohet në skemat statutoire të pensioneve.

— *Pensionet e lidhura me të ardhurat*

Skemat e pensioneve të lidhura me të ardhurat janë sot më të përhapura në botë, në vendet në zhvillim, vendet e industrializuara dhe në ekonomitë në tranzicion.

— *Periudhat kualifikuese*

Në të njëjtën mënyrë si për pensionet e sheshtë, dhënia e përfitimeve është subjekt i një periudhe minimale kualifikuese në shumicën e skemave të pensioneve që lidhen me të

ardhurat. Periudha kualifikuese e shpallur zakonisht varet nga periudhat e kontribuimit, sigurimit apo punësimit.

Megjithëse disa vende nuk shpallin një periudhë kualifikuese minimale me synim marrjen e së drejtës për përfitim, pjesa më e madhe e legjislacionit të sigurimit për pleqëri përcakton se e drejta për pension, qoftë edhe në një masë të reduktuar, varet nga periudha minimale kualifikuese. Kjo periudhë kualifikuese mund të jetë e shkurtër, por në shumicën e rasteve, ajo është një periudhë e gjatë, kështu që ajo eviton mundësinë për abuzim nga ana e atyre që do të kontribuonin thjeshtë për të shfrytëzuar sistemin. Në shumë vende, kjo periudhë mund të jetë e gjatë deri në 20 vjet, ndonëse, nën Konventat e ILO-s (Nr. 102 dhe 128), një përfitim i reduktuar duhet të garantohet për personat që kanë plotësuar 15 vjet kontribute ose punësim. Disa skema shpallin që përfituesi duhet të demonstrojë që ai ka qenë i regjistruar për të paktën 20 vjet, me një numër të caktuar muajsh sigurimi gjatë një periudhe të përcaktuar, që i paraprin datës së lindjes të së drejtës për pension.

Shumica e skemave specifikojnë një periudhë kualifikimi të vetme të lidhur me një moshë të vetme të përfitimit të pensionit. Gjithsesi, janë disa skema që shpallin një numër moshash përfituese të lidhura me periudha të ndryshme kualifikimi, ku moshat më të mëdha janë të lidhura me periudhat kualifikuese më të shkurtëra.

Disa skema shpallin një farë rregullsie të kontributeve. Të tjerat mund të specifikojnë që periudha kualifikuese duhet të plotësohet gjatë një periudhe të shpallur që paraprin menjëherë moshën e titullimit për pension. Periudha kualifikuese minimale mund të reduktohet në ato sisteme ku mosha e përfitimit të pensionit për kategori të veçanta përfituesish është më e vogël sesa mosha normale, p.sh., gratë apo personat që kanë bërë punë të cilësuar si tepër të vështira ose të pashëndetshme.

Në shumë vende, periudhat e tjera jashtë atyre të punësimit, mund të merren në konsideratë në ndërtimin e periudhës minimale kualifikuese (dhe gjithashtu për llogaritje pensioni, siç do të shihet edhe më poshtë). Këto njihen si periudha të asimiluara. Për shembull: periudhat gjatë të cilave personi i siguruar ka marrë përfitime të sigurimeve shoqërore për sëmundje, dëmtim në punë, barrë lindje, papunësi; periudhat e shërbimit të detyrueshëm ushtarak; periudhat e studimeve apo trajnimeve; periudhat kushtuar rritjes së fëmijve dhe kështu me rradhë.

Në vendet ku ka skema të ndryshme pensionesh, shumë legjislacione i lejojnë personat e siguruar që të marrin në konsideratë të gjithë periudhat e sigurimit, të fituara nën skema të ndryshme, kur është fjala për llogaritjen e periudhës kualifikuese.

Derisa institucionalizimi i periudhave kualifikuese relativisht të gjata do t'i përjashtojë nga mbrojtja ata që janë pranë moshës së përfitimit të pensionit në kohën kur prezantohet skema e pensioneve të pleqërisë, masat tranzitore janë shpesh të vendosura në interes të tyre. Për shembull, gjatësia e periudhës kualifikuese mund të shkallëzohet në raport me moshën në kohën që skema hyn në fuqi, apo periudhat e punësimit dhe aktivitetit profesional (real ose i prezumuar), që i paraprin ngritjes së skemës, llogariten si periudha sigurimi. Personat e siguruar që nuk plotësojnë kushtet kualifikuese shpesh marrin një pagesë të vetme, e cila mund të llogaritet gjithashtu në raport me të ardhurat e tyre dhe me vitet e sigurimit.

Në rast të mosplotësimit të periudhës minimale të sigurimit, qytetari nuk titullohet me pension pleqërie dhe, ose duhet të vazhdojë të punojë deri në plotësimin e këtij kushti, ose do të kontribuojë në mënyrë vullnetare (të blejë periudha sigurimi në mënyrë vullnetare), ose duhet t'i drejtohet skemës së ndihmës ekonomike. Periudha minimale për t'u titulluar për pension pleqërie ka qenë 20 vjet, por është ndryshuar në 15 vjet, së

pari për të plotësuar kërkesat e Konventës Nr.103 të ILO-s, si dhe për të mos përjashtuar qytetarët nga e drejta e një pensioni pleqërie. Për efekt të pensionit të pleqërisë njihen si periudha sigurimi edhe periudha të tjera jashtë punësimit.

IV.5.2 Formula e llogaritjes së përfitimit

Shuma e një pensioni të lidhur me të ardhurat bazohet zakonisht në dy faktorë kryesore: të ardhurat mesatare referuese dhe gjatësia e sigurimit. Formulatat për llogaritjen e pensioneve të lidhur me të ardhurat janë shumë të ndryshme. Megjithatë mund të bëhet dallim midis dy llojeve kryesore të formulave, secila prej tyre ka një numër variantesh.

Në llojin e parë, raporti midis pensionit dhe të ardhurave të mëparshme nuk ndryshon në lidhje me nivelin e të ardhurave; në vend të kësaj, ai zakonisht ndryshon sipas gjatësisë së sigurimit ose të punësimit. Kjo është metoda më e përhapur e llogaritjes. Në disa vende ku aplikohet kjo metodë, shuma e pensionit llogaritet si përqindje e përcaktuar e të ardhurave për çdo vit të sigurimit apo punësimit. Kjo përqindje shpesh lëviz midis 1.33 dhe 2%. Kështu, një normë akumulimi i atribuohet çdo viti sigurimi dhe shuma e pensionit llogaritet duke përdorur formulën:

$$\text{Pensioni} = \text{Të ardhurat referuese} \times \text{Norma e akumulimit} \times \text{Numri i viteve të sigurimit}$$

Në vende të tjera, pensioni përbëhet nga një shumë bazë (përqindje e dhënë e të ardhurave referuese), e cila arrihet sapo plotësohet periudha minimale kualifikuese, dhe një shtesë (e llogaritur si përqindje e të ardhurave) për çdo periudhë shtesë sigurimi.

Në vende të tjerë, pensioni bazohet në një përqindje fikse të të ardhurave referuese në rast se periudha kualifikuese është mjaftueshëm e gjatë për të bërë të mundur marrjen e pensionit të plotë (p.sh. 40 ose 45 vjet). Pensioni reduktohet proporcionalisht po qe se periudha kualifikuese nuk është plotësuar.

Lloji i dytë i formulës favorizon ata përfitues me të ardhura të vogla, dmth, kur pensioni është përqindje e të ardhurave të mëparëshme dhe kur kjo përqindje ulët ndërsa shuma e të ardhurave të mëparëshme rritet. Të ardhurat referuese ndahen në breza dhe përqindja e llogaritur për pension është goxha më e madhe për brezin e parë në krahasim me brezin e fundit. Në vende të tjera, pensioni përbëhet nga një shumë bazë fikse, që nuk lidhet me të ardhurat, dhe asaj i shtohet një suplement që është proporcional me të ardhurat dhe periudhën e sigurimit. Metoda më komplekse janë përdorur gjithashtu me synim garantimin e një pensioni, në të cilin norma ulet ndërsa të ardhurat referuese rriten.

Krahas këtyre dy formulave llogaritëse mund të gjendet gjithashtu metoda më novatore e quajtur metoda e “pikëve”. Kjo përdoret në vende të ndryshme, ndonëse në mënyra të ndryshme. Për shembull, në disa vende frëngjisht-folës të Afrikës, çdo vit personi i siguruar fiton një numër pikësh të llogaritura mbi bazën e shumës së kontributeve të paguara. Pensioni i pleqërisë është i barabartë me numrin e pikëve të fituara nga personi i siguruar në kohën kur kërkohet përfitimi i tij, i shumëzuar me vlerën e pikëve të pensionit. Vlera e pikëve, qoftë kjo pikë kontributi apo pikë pensioni, specifikohet çdo vit nga autoriteti kompetent duke përdorur të dhëna teknike dhe financiare të parashtruara në skemë.

Të ardhurat dhe e periudhat referuese

Pagat dhe të ardhurat referuese të përdorura për llogaritjen e pensionit formojnë një nga faktorët kyç që ndikojnë në nivelin e pensionit. Të ardhurat referuese do të varen, nga njëra anë, nga komponentët e ndryshëm të të ardhurave të marra në konsideratë dhe nga ana tjetër, nga periudha e marrë në konsideratë.

Përkufizimi i të ardhurave ndryshon nga vendi në vend. Në disa vende përkufizimi është shumë i gjerë dhe mbulon të gjithë komponentët e pagave, përfshirë shtesat që paguhen

për kohën shtesë të punës, kompensimet, bonuset, përfitimet në natyrë, dhe kështu me radhë; në vendet e tjera, merret në konsideratë vetëm pjesa fikse e pagës së paguar në intervale të rregullt.

Shumica e skemave vendosin një kufi të sipërm, të cilit i referohen si tavan i shumës së pagave dhe i të ardhurave që mund të shqyrtohen kur llogaritet shuma e pensionit. Pagat dhe të ardhurat tej këtij tavani, nuk merren në konsideratë. Shumë shpesh ky tavan vendoset si një shumë fikse. Sidoqoftë, në raste të veçanta, llogaritjet bëhen duke iu referuar një shume tjetër, siç është paga minimale. Në vend të përdorimit të tavanit për të ardhurat e marra në konsideratë, disa legjislacione specifikojnë në mënyrë të qartë shumën maksimale të pensionit. Ndryshimet e nivelit të tavanit nga vendi në vend – në krahasim me PBB për frymë, pagën mesatare apo pagën minimale – janë të konsiderueshme. Kjo si pasojë e faktit se në çdo vend, niveli i tavanit i konsideruar i përshtatshëm lidhet me konsiderata ekonomike, financiare dhe sociale dhe reflekton interesat e grupeve të ndryshme. Duhet vënë në dukje gjithashtu se, në disa skema të caktuara, vendoset edhe një “dysHEME”, dmth shuma e të ardhurave e marrë në konsideratë nuk mund të jetë më e ulët se një minimum i dhënë.

Sistemi i “klasave të pagave”, ku çdo klasë përbëhet nga një shumë minimale dhe maksimale, mbi të cilin shpërndahen të ardhurat e personave të siguruar, ishte shumë i përhapur në skemat e mëparshme të sigurimeve shoqërore. Ai është eliminuar në shumicën e vendeve, por ende egziston në disa në vende. Në këtë sistem, e ardhura referuese nuk është paga aktuale e personit të siguruar, por paga mesatare e klasës ku ai bën pjesë. Po qe se numri i klasave është shumë i madh, paga aktuale është pranë pagës mesatare të klasës së tij.

Të ardhurat e personave të vetpunësuar që përdoren në sigurimin e pensionit, mund të përcaktohen sipas legjislacionit mbi tatimin mbi të ardhurat. Por gjithashtu, mund të përdoren edhe zgjidhje të tjera, shumë të ndryshme midis tyre. P.sh., në disa vende në zhvillim, të vetpunësuarit klasifikohen sipas një shkalle të të ardhurave të sheshta, ose mund të zgjedhin shumat e sheshta që ata dëshirojnë. Në mënyrë alternative, shumat e sheshtë mund të jetë e njëjtë për të gjithë..

Shumat e pensionit zakonisht llogaritet mbi të ardhurat mbi një periudhë referuese, gjatësia e së cilës ndryshon ndjeshëm nga një skemë në tjetrën. Në shumë skema, periudha referuese lidhet me zgjatjen tërësore të sigurimit ose me karrierën profesionale personale. Në disa skema, vitet e fundit më të favorshme përjashtohen nga llogaritja. Në disa të tjerë, gjatësia e kohës së marrë në konsideratë është shkurtuar. Në skema të veçanta, kjo periudhë kohe përbëhet nga vitet e sigurimit ose punësimit (zakonisht nga 1-10 vjet). Paga referuese mesatare mund të llogaritet gjithashtu bazuar në vitet “më të favorshme”. Disa herë këto vite duhet të jenë vijues apo të përfshirë në një periudhë të caktuar.

Në shumë vende legjislacioni jep edhe një alternativë për llogaritjen e periudhës së marrë në konsideratë, ose duke specifikuar që duhet të zbatohet zgjidhja më e favorshme, ose nëpërmjet lënies në dorë të përfituesit të zgjedhjes së metodës së zbatueshme.

Kur periudha referuese është e gjatë ose kur kjo periudhë shtrihet mjaft mbrapa në kohë, egziston një rrezik që të ardhurat nominale të regjistruara për periudhat më të largëta nuk i korrespondojnë më nivelit të të ardhurave të kohës kur kërkohet lidhja e pensionit. Për të trajtuar këtë problem, shumë vende kanë marrë masa për të rivlerësuar të ardhurat e marra në konsideratë për llogaritjen e pensionit duke përdorur sistemi e indeksimit të pagave dhe sjellja e tyre në kohë për sa i përket vlerës.

Periudhat e sigurimit

Nje faktor tjetër i rëndësishëm në formulat e përdorura për llogaritjen e shumave të pensionit, është gjatësia e përgjithshme e sigurimit apo periudhave të punësimit. Periudha e sigurimit është ajo në të cilën janë derdhur kontributet ose është periudha e punësimit. Në shumë raste, legjislacioni asimilon periudha të tjera në periudhat e kontributeve. Në shumë skema, numri i viteve të sigurimit që mund të merret në konsideratë për llogaritjen e shumës së pensionit, është i kufizuar. Kështu periudhat e sigurimit tej këtij maksimumi nuk të japin mundësinë për të pasur një shtesë pensioni, edhe po qe se në këto vite janë paguar kontribute. Ka skema ku periudhat tej maksimumit mund të merren në konsideratë, por vetëm për llogaritjen e të ardhurave mesatare referuese. Periudhat maksimale të sigurimit ndryshojnë nga skema në skemë, por zakonisht janë midis 30 dhe 45 vjetëve. Në disa skema periudhat ndryshojnë sipas gjinisë së personit të siguruar. Në këto raste, për të ardhura referuese të barabarta, gratë do të marrin të njëjtën shumë pensioni me më pak vite sigurimi.

Pensionet minimale

Formulat e pensionit shpesh hartohen në mënyrë që të sigurojnë një shumë minimale për përfituesit. Ky minimum mund të vendoset në mënyra të ndryshme. Në skemat që kanë një “dysHEME” për të ardhurat e marra në konsideratë për llogaritjen e pensionit, pensioni do të llogaritet automatikisht mbi bazën e këtij minimumi kur të ardhurat referuese janë më të ulta sesa dysHEMEJA. Shumë skema japin një shumë fikse minimale, e cila mund të vendoset sipas një shume tjetër referuese. Për shembull, në shumë vende të Amerikës Latine dhe frëngjisht-folëse të Afrikës, ajo është llogaritur si një përqindje e pagës minimale. Si rregull i përgjithshëm, shuma e pensionit minimal duhet të

vendoset e tillë që të mund të garantojë marrjen nga ana e pensionistit të një të ardhure minimale që garanton mbijetesën.

Pensionistet që vazhdojnë punësimin fitimprures

Dispozitat lidhur me marrjen e pensionit të pleqërisë në kombinim me të ardhurat nga punësimi fitimprurës ndryshojnë ndjeshëm nga vendi në vend, si edhe nga një skemë në tjetrën, për një vend të dhënë. Shumë skema e ndalojnë tërësisht një bashkim të tillë të të ardhurave, ndërsa të tjera pranojnë një bashkim të plotë, pa asnjë kufizim. Akoma me tej, disa të tjera, ndërsa e pranojnë se kjo mund të ndodhë, i lidhin përfitimet me një tavan të caktuar të të ardhurave ose të shumës së pensionit, për pasojë duke e ndërprerë ose reduktuar këtë pension. Gjithashtu, ka skema që kërkojnë përfundimin e punësimit fitimprurës deri në një moshë të caktuar, pas së cilës personi i mbrojtur mund të marrë pension pa asnjë kufizim të tillë në punësim apo në të ardhura.

Pikëpamjet lidhur me problemin e bashkimit të të ardhurave ndryshojnë ndjeshëm midis tyre. Mund të konsiderohet që vazhdimi i punës është mjet esencial për parandalimin e përshpejtimit të procesit të plakjes, dhe për këtë arsye nuk duhet të dekurajohet. Në mënyrë alternative, është diskutuar se, derisa pensioni synon të kompensojë humbjen e të ardhurave nga punësimi, ai duhet të reduktohet ose të ndalet, tërësisht ose pjesërisht, kur personi i siguruar nuk ka nevojë realisht për të, pasi ai vazhdon të marrë të ardhura nga punësimi. Kjo është zgjidhja shpesh e adoptuar në skemat që japin pensione jo-kontributiv, dmth ato që nuk kërkojnë kontribute nga personat e mbuluar. Është më e vështirë të aprovosh të njëjtin parim kur personave të siguruar u është kërkuar të paguajnë kontribute, gjatë gjithë jetës së tyre të punës, në këmbim të një pensioni, i cili do t'u paguhet në një datë më të vonë.

Problemi i bashkimit të pensionit të pleqërisë dhe i të ardhurave nga punësimi është

bërë më problematik në vende të veçantë me rritjen e papunësisë. Është diskutuar se përfituesit e pensioneve të pleqërisë duhet të dekurajohen për vazhdimin e punësimit fitimprurës, në mënyrë që të lirojnë vende pune. Sidoqoftë, mund të konstatohet se shumë vende që vuajnë nga papunësia e madhe dhe e strukturuar, e autorizojnë bashkimin e të ardhurave pa kufizim, përveç rastit kur pensionet jepen përpara moshës normale të përfitimit të pensionit. Faktet janë të dykuptimta. Një vend që e hoqi të ashtuquajturën provë “daljeje në pension” për pensionistët, nuk gjeti efekt në pjesëmarrjen e fuqisë punëtore të tyre. Për më tepër, e drejta për punë është një e drejtë bazë njerëzore dhe qoftë shkeljet indirekte të kësaj të drejte janë të hapura për kritikë.

KAPITULLI V → SISTEMI I PENSIONEVE NË SHQIPËRI

V.1 Sistemi i pensioneve para viteve '90

Sistemi i Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri mund të konsiderohet si një nga institucionet politike të mbrojtjes shoqërore me historinë më të gjatë. Edhe pse më parë në Shqipëri ka pasur shoqëri të huaja, të cilat zhvilluan në mënyrë vullnetare skema të Sigurimeve Shoqërore për aksidentet në punë, kryesisht për punëtorët e minierave, Institucioni Publik i Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri i ka fillesat e vet në kohën e mbretërisë së Ahmet Zogut. Origjina e sistemit të sigurimeve shoqërore në Shqipëri daton më 15.02.1923 përmes ligjit “Për dorëheqje dhe pension për ushtri dhe gjindarmëri”, i cili vendoste sistemin publik të pensioneve për nëpunësit e administratës ushtarake. Përsa i përket ligjit që njihet edhe si ligji i parë i sigurimeve shoqërore në Shqipëri është Ligji Nr. 129, datë 28 tetor 1927, “Per pensionet civile”, botuar në fletoren zyrtare Nr. 91, të datës 8 nëntor 1927. Sipas këtij akti ligjor, u vendosën themelet e një sistemi të konsoliduar të sigurimeve shoqërore, i cili përfshinte në vetvete mbrojtjen për punonjësit civilë të administratës së atëhershme dhe njihje të drejtën e pensionit për të gjithë punonjësit civilë pas datës 28 nëntor 1912, pra që me njohjen e shtetit të pavarur shqiptar.

Sistemi i Sigurimeve Shoqërore ishte një sistem kontributiv me një fond dhe administrim të veçantë, i ngjashëm me modelet e shteteve të Europës Perëndimore të kohës. Kushtet për përfitimin e pensionit të pleqërisë ishin të lidhura me: a- një minimum periudhe sigurimi (kontribuimi) 10 vjet deri në një maksimum prej 35 vjetësh; b- moshën 60 vjeç, e unifikuar si për femrat dhe për meshkujt.

Në Shqipëri, pensionet përbëjnë historikisht një nga instrumentet më të njohura për mbështetjen e individëve, kur ata nuk kanë mundësi të sigurojnë mjetet e jetesës, për shkak të moshës apo pa aftësisë së përhershme për punë. Forma e parë e pensioneve ka qenë një lloj shpërblimi periodik për veteranët e luftës. Edhe në ditët e sotme pensionet e ushtarakëve mbeten një formë e mbrojtjes shoqërore. Forma e dytë e pensioneve ishte për nëpunësit civilë të shtetit, të cilat jepen në rast pleqërie/invaliditeti, si nderim për shërbimin që ata i kanë dhënë shtetit dhe shoqërisë. Në dallim nga pensionet e tjera mbi bazë profesioni, këto lloj pensionesh nuk kushtëzohen nga ndërprerja e shërbimit publik apo nga mosha. Si karakteristikë kryesore e këtyre përfitimeve është fakti se ato janë edhe jo- kontributive, pasi shihen si vazhdim i shpërblimit që ata merrnin kur kryenin shërbimin ushtarak apo civil ndaj shtetit, që mund të shkonte deri në masën 100 përqind të pagës.

Përsa i përket shtetit Shqiptar, pas Luftës së Dytë Botërore ai mori në mbrojtje familjet dhe të afërmit e dëshmorëve të LANÇ, invalidët e Luftës, si dhe punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në vitin 1947, me miratimin e Ligjit Nr. 528, datë 26.08.1947 “Mbi sigurimet shoqërore të nëpunësve dhe funksionarëve” u vendos një skemë e përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore, e cila u përmirësua sipas modelit sovjetik në vitet 1958 dhe 1959, dhe ishte e ndryshme nga ajo e kohës së mbretit Zog. Ndërsa, një sistem i plotë i Sigurimeve Shoqërore u krijua vetëm në vitin 1966, me miratimin e Ligjit Nr. 4171, datë 13.09.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, i cili vazhdon të ruajë të drejtat e tij edhe në sistemin e ri të Sigurimeve Shoqërore të vitit 1993.

Sistemi i trashëguar i Sigurimeve Shoqërore, i bazuar në ideologjinë marksiste, mbronte të punësuarit në ndërmarrjet shtetërore në të gjitha degët e ekonomisë, si dhe ushtarakët.

Ndërkohë anëtarët e kooperativave bujqësore vetëm në vitin 1972, pas përfundimit të procesit të kooperativizimit, u përfshinë në sistemin e mbrojtjes shoqërore²⁷. Mbulimi i të gjithë popullsisë nga sistemi i sigurimeve nuk nënkuptonte domosdoshmërisht një mbrojtje të njëjtë për të gjitha shtresat sociale dhe profesionet, ai ishte i rënduar nga privilegjet për grupe të ndryshme, si për shembull, minatorët, tekstilistët, metalurgët, deri tek mësuesit.

Sistemi i Sigurimeve Shoqërore përbëhej nga dy skema:

1. Skema për të punësuarit në ndërmarrjet shtetërore
2. Skema për kooperativistët.

Shkalla e lartë e punësimit në vend bashkë me përfitimet nga Sigurimet Shoqërore, u jepte personave të siguruar dhe familjeve të tyre një shkallë të mjaftueshme sigurie për jetën, pra ky institucion në kohën e tij e arrinte qëllimin e plotësimit të nevojës për siguri për të gjithë anëtarët e shoqërisë. Por, sa përshtatej ky institucion me ndryshimet e sistemit?

Ndryshimet ekonomike të shoqëruara me ndryshimet në strukturën sociale dhe lindja e problemit të papunësisë pa dyshim që imponuan ndryshime edhe në sistemin e trashëguar të Sigurimeve Shoqërore në vendin tonë. Përshtatjet e tij në filimet e tranzicionit, pas shkatërrimit të kooperativave bujqësore, përfshijnë transferimin e të drejtave për përfitime nga kooperativistët tek të vetpunësuarit në bujqësi. Në vitin 1991, sistemi i Sigurimit të detyrueshëm u shtri edhe tek sektori privat dhe shumë shpejt ai e shtri mbrojtjen edhe në grupet e tjera shoqërore, si të vetpunësuarit në qytet dhe profesionet e lira.

²⁷ Ligji Nr. 4976, datë 29.06.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore”

Ndërkohë për të vetpunësuarit në bujqësi në Sistemin e Sigurimeve Shoqërore, shteti vendosi kushte të favorshme për ta në lidhje me detyrimet kontributive për Sigurimet Shoqërore. Ata do të paguanin vetëm një përqindje të masës së kontributeve, që duhet të paguanin të vetpunësuarit e tjerë dhe pjesa tjetër do kontribuohet nga buxheti i shtetit.

Në fillimet e vështira të tranzicionit, ku shteti nuk kishte mundësi për politika aktive të mbështetjes së bujqësisë me kredi, etj...ai zbatoi sikurse njihen në literaturën bashkëkohore politikat pasive të *“hidden ëelfare”*, të cilat i referohen përjashtimit nga taksat dhe kontributet shoqërore të grupeve më të riskuara të shoqërisë.

Papunësia masive pas vitit 1991, e detyroi qeverinë të merrte masa emergjente për trajtimin e saj. Sistemi i Sigurimeve Shoqërore ndërhyri nëpërmjet instrumentit të pensionit të parakohshëm, që synonte të mbështeste me të ardhura një pjesë të të papunëve, veçanërisht ata pranë moshës së pensionit, të cilët e kishin të vështirë të përshtateshin me kërkesat e reja të ekonomisë së tregut. Por, edhe kjo alternativë, e cila për atë kohë u duk si një alternativë e mirë politike për trajtimin e problemit emergjent të papunësisë, kishte të metat e saj.

Së pari, pati një kosto të papërballueshme për Sistemin e Sigurimeve Shoqërore, dhe efekti i dytë negativ ishte rritja në mënyrë artificiale e shkallës së varësisë së Sistemit të Sigurimeve Shoqërore. Numri i përfituesve jo vetëm që po rritej me ritme më të shpejta sesa kontribuesit, por edhe numri i kontribuesve po vinte në rënie drastike. Për shembull: Në vitin 1990 ritmi vjetor i rritjes së numrit të pensionistëve ishte 7.8%, ky ritëm vjetor në vitin 1992 u dyfishua në 16.3%, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, duke e çuar numrin e pensionistëve nga 9.8% në vitin 1990 në rreth 13.4% të popullsisë.

Kjo rritje e shkallës së varësisë së sistemit u reflektua edhe në prishjen e bilancit të kostos ndaj përfitimeve dhe për rrjedhojë në uljen e nivelit të përfitimeve. Për periudhën 1990-1993, diferenca midis pensionit shtetëror minimal të pleqërisë dhe atij maksimal nga 2.6 herë u ngushtua në 1.6 herë, duke sjellë kështu që pensionet maksimale të mos ruanin më vlerën e tyre prej 70 përqind të pagës korresponduese, por të bien nën këtë vlerë.

Tendenca për uljen artificiale të moshës mesatare të daljes në pension (nga 57.1 vjeç që ishte në vitin 1975, ajo ulet në 53.2 vjeç në vitin 1993), erdhi si pasojë e pensioneve të parakohshme, që përfshinin gati 8 përqind të popullsisë në moshë pune.

Një fenomen tjetër me pasoja të konsiderueshme negative në Sistemin e Sigurimeve Shoqërore ishte shfaqja e ekonomisë informale, që çonte në shmangien e të punësuarve dhe punëdhënësve të sektorit privat nga detyrimet kontributive ndaj Sistemit të Sigurimeve Shoqërore. Nëse në vitin 1990 popullsia në moshë pune që kontribuonte në Sistemin e Sigurimeve Shoqërore ishte 1,451 mijë vetë, duke lënë jashtë sistemit vetëm 8 përqind të popullsisë në moshë pune, në vitin 1993 numri i kontribuesve zbret në 470 mijë vetë. Nëse në vitin 1990 kontribuonin gati 5 të punësuar për një pensionist, në vitin 1993 për çdo pensionist kontribuon vetëm një i punësuar, kjo për shkak të qëndrimeve indiferente ndaj skemës së Sigurimeve Shoqërore të punëdhënësve privatë apo të vetpunësuarve.

Të gjitha këto zhvillime u shoqëruan me deformim të parimit të drejtësisë sociale, pra në kuptimin që krijuan mospërputhje të përfitimeve me masën e kontributeve.

V.1.1 Elementët pozitivë dhe negativë të sistemit të trashëguar të Sigurimeve Shoqërore

Sistemi i trashëguar i Sigurimeve Shoqërore, i kondicionuar nga sistemi shoqëror, përmbante ne vetvete elemente pozitive dhe negative. Në mënyrë të përmbledhur elementët pozitivë të sistemit, përfshijnë:

- Shtrirjen e mbrojtjes shoqërore në të gjithë popullsinë;
- Mbrojtjen e shtetasve ndaj rreziqeve kryesore dhe garantimin e sigurisë në jetë, nëpërmjet një niveli të kënaqshëm të përfitimeve sociale, në raport me të ardhurat nga punësimi;
- Financimin kontributiv.

Ndërsa, të metat kryesore të sistemit të trashëguar të Sigurimeve Shoqërore, mund të përcaktohen në lidhje me:

- Kriteret e diferencuara në përfitime, që shkelnin parimin e drejtësisë sociale;
- Mungesën e fleksibilitetit të sistemit për ruajtjen e vlerës së përfitimeve në kushtet e inflacionit të lartë dhe të rritjes së çmimeve, të cilat rrezikonin kalimin e pensionistëve në grupin e më të varfërve të shoqërisë;
- Varësinë e financimit nga buxheti i shtetit.
- Mungesën e kapaciteteve institucionale për përballimin e funksioneve të reja në kushtet e ekonomisë së tregut;
- Mosgarantimin e mbrojtjes adekuate të të papunëve. Për këtë arsye kërkohej ndërtimi i një skeme të sigurimit në rast papunësie.

V.2 Sistemi i pensioneve pas miratimit të Ligjit Nr. 7703

Ligji Nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), krijoi një sistem të detyrueshëm, publik dhe me mbulim universal të

sigurimeve shoqërore dhe një kolonë të tretë vullnetare, që momentalisht nuk paraqitet ende e zhvilluar.

V.2.1 Skemat e përfitimeve

Sistemi i detyrueshëm përbëhet nga:

1. *Një skemë sigurimesh shoqërore e detyrueshme*, e cila administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe mbulon të punësuarit në shtet dhe në sektorin privat dhe të vetpunësuarit në zonat urbane dhe rurale, me kusht që ata të kenë kontribuar për një kohë të përcaktuar në skemë.
2. *Një skemë vullnetare*, që përfshin ata që nuk janë më të siguruar, që kanë qenë dhe duan të vazhdojnë të jenë, ata që nuk janë të mbuluar nga ligji, për shkak të pamundësisë së punësimit, si për shembull, emigrantët.
3. *Një skemë suplementare* për funksionet e larta kushtetuese, shërbimin civil dhe ushtarakët e punësuar në ushtri, në polici, në shërbimin informativ dhe akademiket. Pensionet suplementare financohen drejtëprdrejt nga buxheti i shtetit.
4. *Pensione të veçanta* për ata që kanë marrë pjesë në luftë, që kanë tituj në fushën e kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës, si dhe të përndjekurit nga regjimi komunist. Pensionet e veçanta financohen gjithashtu drejtëprdrejt nga buxheti i shtetit.

V.2.2 Llojet e përfitimit

Vetë sistemi i pensioneve përfshin tre lloje pensionesh: pensionin e pleqërisë, të invaliditetit dhe atë familjar. Pensioni i invaliditetit llogaritet me rregulla të ndryshme

nga pensioni i pleqërisë, dhe mund të jetë i plotë ose i pjesshëm në vartësi të gjendjes shëndetësore, si dhe i reduktuar për shkak të mosplotësimit të periudhës minimale të domosdoshme të sigurimit. Pensioni familjar llogaritet edhe ai njësoj si në rastin e pensionit të invaliditetit, por mund të jetë i plotë ose i pjesshëm në vartësi të anëtarëve pjesëmarrës në këtë pension, të cilët mund të jenë: fëmijët, bashkëshortja ose bashkëshorti dhe prindri.

Ligji i sigurimeve shoqërore i jep mbrojtje të punësuarve edhe në rastin e sëmundjeve, papunësisë, aksidenteve në punë dhe në rastin e barrëlindjes. Aktualisht për sigurimet shoqërore, norma e kontributit është 24.5 përqind, dhe nga kjo 21.6 përqind paguhet për degën e pensioneve. Në Tabelen 1 jepet një ndarje e normës së sigurimeve shoqërore dhe e sigurimit shëndetësor.

Tabela 1 Ndarja e normës së sigurimeve shoqërore dhe e sigurimit shëndetësor

Degët e sigurimeve		Perqindja
Pensione		21.6
Sëmundje		0.3
Barrëlindje		1.4
Aksidente në punë		0.3
Papunësia		0.9
Totali i sigurimeve shoqërore		24.5
Sigurimi shëndetësor		3.4
Totali i sigurimeve shoqërore	Punëdhënësi	Punëmarrësi
24.5	15	9.5

Burimi: ISSH, VKM Nr. 77, datë 28.1.2015 (fq.7)

Përfitimet sociale përballohen nga Fondi i Sigurimeve Shoqërore (FSSH) që është strukturë financiare e pavarur nga buxheti i shtetit. Menaxhimi i FSSH i është ngarkuar

ISSH-së, cili është institucion i pavarur publik në vartësi dhe nën kontrollin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Fondi i sigurimeve shoqërore, sikurse tregohet në Tabelen 1, ndahet në pesë degë kryesore: sëmundje, barrëlindje, pensione, aksidente dhe sëmundje profesionale dhe papunësi. Sipas rregullores financiare të ISSH, lejohet huazimi i burimeve financiare nga njëra degë në tjetrën, kundrejt një interesi të përcaktuar. Huazimi pa interes është i lejuar vetëm në rastet kur miratohet nga Parlamenti në buxhetin vjetor të ISSH.

V.2.3 Çështje fiskale dhe financiare të sigurimeve shoqërore

Skema e buxhetit të Sigurimeve Shoqërore paraqitet në Tabelen 2. Duke qenë një institucion i specializuar, ISSH është e ngarkuar të administrojë disa programe të veçanta kompensuese, statutore, apo edhe skema suplementare, të cilat financohen totalisht nga buxheti i shtetit dhe kjo krijon një imazh shqetësues për shkallën e pjesëmarrjes së shtetit në FSSH. Këto transferta duke qenë të konsiderueshme, duket sikur i shërbejnë reduktimit të varfërisë, por duke evidentuar shtresat që i përfitojnë rezulton se ato faktikisht i përgjigjen shumë pjesërisht reduktimit të varfërisë.

Interesi jonë në këtë studim është vetëm mbi degën e pensioneve, e cila përbën dhe komponentin kryesor të sistemit të Sigurimeve Shoqërore.

Tabela 2 Skema e buxhetit të Sigurimeve Shoqërore

Të ardhura të rregullta	Përfitimet
Kontributet	Sigurime për pensione
- nga punëdhënësit	Sigurime për sëmundje
- nga të punësuarit	Sigurime për barrëlindje
- nga të vetpunësuarit	Sigurime për aksidente në punë
- nga buxheti i shtetit	Transferim në buxhetin e sigurimit të papunësisë

Interesa dhe komisione	
Të ardhura të parregullta	Kostot administrative
Transferta nga buxheti i shtetit	Operacionale ose korente
- për indeksimin e pensioneve	Investimet
- për programet speciale	
- për financim të defiçitit të ISSH-së	
Të ardhura të tjera (gjoba, etj.)	
	Fondi Rezervë i Sigurimeve Shoqerore

Burimi:ISSH

Formula e llogaritjes së masës së pensionit mujor

Pensionimujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë.

$$Pp = Shb + Sh$$

ku:

Pp = Pensioni i plotë mujor i pleqërisë

Shb = Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit, që ka realizuar personi, me periudhën e sigurimit të kërkuar, sipas ligjit për vitin në të cilën llogaritet pensioni, shumëzuar me pensionin social;

Sh = Shtesa do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, e llogaritur sipas ligjit;

Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social.

Aktualisht, baza mesatare e vlerësueshme llogaritet si Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për periudhën e sigurimit nga data 01.01.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merret shuma e pagave për

të cilat janë paguar kontributet nga data 01.01.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit.

Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 01.01.1994, përlllogaritjen e bazës së vlerësuar merren pagat referuese, të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merren pagat referuese të caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 01.01.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit si ish-punonjës i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore, përpara vitit 1994, si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht aktiv pas datës 01.01.1994.

Për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 01.01.2015 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese, sipas llojit të punës ose funksionit përpara datës 01.01.1994, si edhe mbi pagat individuale, mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 01.01.1994 deri në 31.12.2014, të indeksuara me indeksin që del nga pjestimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2014 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës. Koeficientët e indeksimit sipas viteve përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

V.3 Sistemi aktual dhe reformat e ndërmarra deri në vitin 2015

Ndryshimet e mëdha social-ekonomike që ndodhën në fillim të viteve '90, është e natyrshme që patën ndikimin e tyre dhe kondicionuan mënyrën e funksionimit të sigurimeve shoqërore.

V.3.1 Ndryshimet e zbatuara në sistemin e sigurimeve shoqërore deri në vitin 1998

Ndër ndryshimet e para regjistrohet përfitimi i të drejtës për një pension familjar, në rast se mbajtësi i familjes nuk kishte më shumë se një vit shkëputje nga sigurimi shoqëror i detyrueshëm. U miratua që të njihej si periudhë sigurimi edhe periudha kur një person trajtohet me pension invaliditeti të pjesshëm.

Reforma e pensioneve të fshatit dhe ndërtimi i një strategjie të barazimit gradual të pensioneve të reja të fshatit me ato të qytetit në një periudhë së paku, 14-15 vjeçare. Reforma e re e miratuar përcaktoi llogaritjen e një pensioni për personat e vetpunësuar në bujqësi, i cili përbëhej nga dy pjesë: një pension fshati (bazë), i cili përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe një shtesë, e cila është 1 përqind e pagës minimale për çdo vit kontributiv. Mbi bazën e kësaj reforme, një person që ka punuar në ish-kooperativat bujqësore dhe ka kontribuar rregullisht nga viti 1994 e në vazhdim, si person i vetpunësuar në bujqësi, në vitin 2006, merrete:

- një pension bazë fshati prej 4110 lekë në muaj, dhe
- një shtesë prej 1 përqind të pagës minimale për çdo vit sigurimi nën këtë skemë, e cila ishte 13140, për 12 vjet sigurimi shtesa rezulton 1580 lekë.

Kështu, për këta persona pensioni në vitin 2006 kishte arritur 5690 lekë dhe përfaqësonte rreth 70 përqind të pensionit të qytetit.

Një masë e tillë parashikohej që të koordinohej dhe harmonizohej me rritjen dhe barazimin gradual edhe të kontributit të fermerëve me atë të vetëpunësuarve në sektorin jo bujqësor. Fakti që pensioni i fshatit ishte sa 70% e atij të qytetit, ndërkohë që kontributi është sa 1/5 e atij të qytetit, tregonte se çështjet, nuk kishin shkuar si duhet.

Nga ana tjetër, disa faktorë të rëndësishëm mbeten për t'u marrë në konsideratë:

- ekzistenca e skemës së pensioneve të fshatit me një volum shpenzimesh prej 15% të shpenzimeve për pensione;
- mbulimi me këtë skemë i rreth 160 mijë personave;
- ekzistenca e të drejtës për të përfituar një pension, qoftë edhe të pjesshëm, për të gjithë personat që kanë lindur në vitin 1956 e më përpara, edhe sikur këta të mos jenë kontribues në skemën;
- niveli shumë i lartë i pjesëmarrjes së shtetit për mbulimin e diferencës së kontributit. Aktualisht me subvecione buxhetore mbuloheshin rreth 70 përqind e shpenzimeve të kësaj skeme.

Nisur nga këto çështje shumë të rëndësishme, skema kërkon një vëmendje të veçantë në kontekstin e të drejtave në fushën e sigurimeve dhe vazhdimin e njohjes së të drejtave të fituara në fushën financiare. Duhet patur parasysh edhe fakti që numri i fermerëve në Shqipëri është shumë i lartë.

V.3.2 Reformat parametrike të vitit 2002

Reforma të rëndësishme të sistemit, të studiuar dhe miratuara në vitin 2002, erdhën si rrjedhojë e një varg faktorësh, ndër të cilët përmendim:

- deficieti i sistemit të pensioneve konsiderohej i lartë, duke arritur në 1% të PBB-se dhe parashikimet aktuariale llogaritnin një përkeqësim të kësaj gjendjeje;
- pensionet rurale, që përfaqësojnë një pjesë të madhe të defiçitit, edhe pse ato luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e varfërisë në fshat;
- përqindja e lartë e kontributit për fondin e sigurimeve shoqërore që arrinte në 42.5% e pagës, i dekurajonte njerëzit për sigurimin formal.

Mbi bazën e studimeve të kryera, dhe me konsulencën e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, u miratuan nga Kuvendi i Shqipërisë dhe filluan të zbatohen:

- Reforma e rritjes graduale të moshës së përfitimit të pensionit, e cila përcakton rritjen me gjashtë muaj në çdo vit të moshës deri në arritjen në vitin 2012 të moshës 65 vjet për burrat dhe 60 vjet për gratë.
- E drejta për të përfituar një pension të reduktuar, para mbushjes së moshës së plotë të kërkuar, por jo më parë se tre vjet nga mosha përfundimtare, duke reduktuar pensionin e plotë, me koeficientin 0.6 përqind në muaj.
- Norma e kontributit të sigurimeve shoqërore u reduktua me 4%, ndërkohë që për të shmangur lëkundjet e mëdha financiare të skemës u realizua rritja e tavanit të pagës mbi të cilën paguhen kontributet nga trefishi në pesëfishin e pagës minimale.
- Në zbatim të strategjisë për sigurimet shoqërore në fshat, për vitin 2002 u rrit me 2.4 herë shuma e kontributit vjetor që paguajnë fermerët, e cila nuk ka vazhduar më të njëjtin ritëm në vitet e mëpasme.
- Reformimi rrënjësor i skemës së kompensimeve të pensionistëve për personat në vartësi.
- Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithëshme të Tatimit Taksave, filloi të zbatohet strategjia e kalimit gradual të mbledhjes së kontributeve nga organet e sigurimeve shoqërore në ato të tatimit taksave.

V.3.3 Proceset e ngushtimit të diferencave në masën e pensioneve

Një reformë e rëndësishme, që tashmë është e përfunduar, ishte ngushtimi i diferencave në masën e pensioneve të caktuara, para e pas vitit 1993, kur u miratua dhe filloi zbatimi

i ligjit i ri të sigurimeve shoqërore, por edhe në periudhën deri në vitin 2005, pra gjatë zbatimit të tij. Këto pabarazi në masën e pensioneve lindën për disa arsye:

- Ndërsa ligji që funksionoi deri më 30.09.1993 jepte një pension sa 70 përqind e pagës së tre viteve rresht në dhjetë vitet e fundit, ligji i ri zbaton një shkallë zëvendësimi pagë/pension, në nivelin minimal 75 përqind.
- Në harkun kohor 1992-2002, për shkak të nevojës së reduktimit të varfërisë tek pensionistët që mernin pensione minimale dhe në kushtet e një tranzicioni ekonomik të vështirë, është realizuar indeksimi i pabarabartë i masës së pensioneve, me prioritet rritjen më shumë të pensioneve minimale. Si pasojë, në vitin 2000 raporti midis pensionit minimal dhe atij maksimal ishte në nivelin 1:1.27, nga 1:2 që ishte parashikuar me ligj.

Për të zbutur dallimet në masën e pensioneve të caktuara me ligjin dhe të atyre të caktuara me ligjin e vjetër, në harkun kohor 2000 -2005 u morrën disa masa të posaçme, të cilat pothuajse rikthyen të drejtat, por pa efekte financiare prapavepruese. Megjithatë, edhe pas këtyre rregullimeve konstatohet se përsëri ka diferenca në masën e pensioneve, për të cilat kërkohet një sistemim ligjor, që do të duhet të jetë përfundimtar, duke shqyrtuar jo vetëm diferencat e krijuara si pasojë e indeksimeve të pabarabarta të të drejtave të fituara, por edhe dukuri të tjera apo mangësi që kanë dobësuar lidhjen midis periudhës kontributive, shumës së kontributeve të paguara dhe masës së pensionit të përfituar etj.

V.3.4 Reformat e sistemit në vitin 2005

Në vitet 2004–2005 janë konstatuar disa probleme që kërkonin zgjidhje, ku ndër kryesoret cilësohen:

- unifikimi i legjislacionit Shqiptar në fushën e sigurimeve me normat dhe standardet ndërkombëtare;
- rregullime e saktësime të legjislacionit, lidhur me llogaritjen e bazës së vlerësuar;
- reduktimi i mëtejshëm i normës së kontributit e cila vazhdon të mbetet e lartë.

Si përgjigje ndaj këtyre problemeve u realizua:

- reduktimi me 9 pikë i masës së kontributit, duke e çuar atë nga 38.5% në 29.5 % të pagës;
- marrja e nje varg masash në funksion të balancimit financiar të sistemit dhe rritjes së performancës së mbledhjes së kontributeve ;
- marrja e masave lidhur me përsosjen e metodikave të llogaritjes së bazës së vlerësuar, si parakusht për harmonizimin e periudhave të ndryshme të sigurimit me kontributet e paguara.

V.3.5 Reformat e sistemit në vitin 2014

Sigurimeve Shoqërore, si dhe në konkluzionet për përmirësimin e parametrave të sistemit në ligjin 7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, iu bënë këto ndryshime:

1. Forcimi i parimit kontributiv dhe krijimi i një sistemi të drejtë, në të cilin përfitimet lidhen drejtpërdrejt me kontributete, nëpërmjet:
 - a. optimizimit gradual të përfitimeve nëpërmjet përmirësimit të formulës së pensioneve, për të siguruar pensione të financuara nga kontributet, duke hequr privilegjet pavarësisht nëse niveli i përfitimeve është minimal apo pak më i lartë;

- b. përmirësimit konceptual të skemës dhe formulës së pensioneve të fshatit, si dhe heqjes graduale të subvecioneve kontributive;
 - c. përmirësimit të procedurave dhe praktikave të mbledhjes së kontributeve dhe të mbledhjes së borxheve.
2. Koordinimi i skemës së përfitimeve bazuar në kontributet e paguara me përfitimet sociale të formës asistenciale të garantuara nga shteti, si dhe zhvillimi i skemave të pensioneve profesionale dhe private, me qëllim shtimin e opsioneve të përfitimeve në moshën e pensionit, rritjen e shkallës së përgjithshme të zëvendësimit të të ardhurave të tyre, si dhe optimizmin e përgjegjesive të shoqërisë dhe individit për sigurimin e të ardhurave të nevojshme në moshën e pleqërisë.
3. Ritargetimi i përfitimeve nga skemat kompensuese, bashkimi i tyre pas datës 1.1.2015 me pensionin, duke mbyllur kështu një praktikë të masave të emergjencës, përmirësimit dhe përcaktimit të rregullave të indeksimit të pensioneve, të cilat do të bazohen mbi ecurinë e indeksit të çmimeve dhe ecurinë e zhvillimit të kontributeve individuale dhe të ardhurave, duke shmangur praktikën e rritjeve mbi baza të analizave të emergjencës dhe duke mos llogaritur efektet sociale afatgjata.

Reformimi i sistemit të përgjithshëm të sigurimit social.

Mbi këtë bazë, në këto ndryshime ku bëhet fjalë për sistemin e përgjithshëm të sigurimeve shoqërore, brenda sistemit të përgjithshëm u shtua skema e pensioneve sociale dhe fillimi i ndërtimit të skemave profesionale të pensioneve, si dhe trajtimi, si një masë tranzitore të skemave kompensuese.

Në sistemin e tregut evidentohet të ketë kategori të veçanta njerëzish, të cilët për arsye nga më të ndryshmet nuk mund të kenë arritur që nëpërmjet punësimit apo aktivitetit ekonomik të plotësojnë periudhën minimale të sigurimit, për të marrë një pension.

Periudha minimale e sigurimit, bazuar në parimet e ndërtimit të skemave të pensioneve publike, si dhe në Konventen Nr. 102 të ILO-s ka qenë e përcaktuar për 15 vite dhe po kaq mbetet edhe në ndryshimet e bëra të ligjit. Në këto kushte, për këto kategori personash, por edhe si një shumë bazë e mbështetjes shtetërore të përfituesve të pensioneve në harmoni me pensionin kontributiv dhe forcimin e parimit kontributiv, në nenin katër të ligjit të mëparshëm u shtua neni 5/1, ku u vendos një kategori përfitimi që emërtohet “Pensioni Social”. Shuma mujore e pensionit social është afërsisht e barabartë me shumën e të ardhurave që ofrohet nga skema paraardhëse, për një të siguruar që ka minimumin e periudhës së sigurimit prej 15 vjetësh dhe që kishte kontribuar mbi një pagë minimale në shkallë vendi.

Pension social i akordohet qytetarëve shqiptarë në moshën 70 vjeç e lart, që nuk kanë të ardhura të tjera të përfituara nga pasuritë, trashëgimitë, të ardhura nga investimet, etj, pra kur vërtetohet që nuk kanë mjete të tjera alternative për jetesën. Vendosja e kufirit moshor prej 70 vjeç është bërë për arsyen që qytetarët të inkurajohen të marrin pjesë në skemë nëpërmjet pagimit të kontributeve dhe përfitimit të një pensioni më të madh dhe më dinjitoz. Gjithashtu në këtë ndryshim parashikohet që pensioni social mund të jetë i pjesshëm për atë kategori personash që kanë një sasi të ardhurash, por niveli i tyre mujor është më i ulët se masa e përcaktuar e pensionit social. Kriteret e përfitimit përcaktohen nga Keshilli i Ministrave.

Bazuar në të dhënat nga regjistri i shtetasve dhe regjistri i pensioneve, si dhe duke vlerësuar në mënyrë “eksperte” numrin e përfituesve (kjo për shkak të mungesës të të dhënave për burimet e të ardhurave të të moshuarve pa pension), parashikohet që numri i përfituesve për vitet e para, të jetë 5000 - 6000 persona, me një kosto vjetore prej rreth

400 milionë lekë në vit, të cilat do të financohet nga të ardhurat e përgjithshme, nëpërmjet buxhetit të shtetit.

Gjithashtu, në nenin 2 të ligjit të ndryshuar, u parashikua shfuqizimi i tre paragrafëve të dispozitës paraardhëse, të cilat evidentonin vendosjen e sistemit të kompensimeve të të ardhurave minimale, duke bashkuar sistemin e pensioneve me kompensimet dhe duke mbyllur kështu një praktikë të masave të emergjencës. Skemat e sigurimeve shoqërore parimisht janë skema që financohen nga kontributet dhe mbi këtë bazë çdo e ardhur në pension duhet të jetë e mbështetur me kontribute, në të kundërt subvencionet buxhetore rrisin ndjeshëm dhe në mënyrë të mbuluar kontributin e shtresave aktive, si dhe të pensionisteve për financimin e pensionit.

Nga ana tjetër, duke qenë se sistemet e kompensimeve të vendosura që nga viti 1993 dhe deri në vitin 2007, për rritjen e çmimit të energjisë, të ushqimeve, të bukës, si dhe kompensimet e tjera të vendosura për përfituesit e pensioneve minimale, tashmë ishin bërë pjesë e të ardhurave të pensionistëve, për pensionet aktuale, si dhe për ato pensione që u caktuan me datë fillimi deri në 31.12.2014. Ndërsa për përfitimet pas vitit 2015 përfitimet rregullohen nëpërmjet formulës së pensioneve dhe vendosjes së pensioneve sociale, të cilat optimizojnë përfitimet e ardhshme me ato aktuale.

Një masë mjaft e rëndësishme u ndërmor edhe nëpërmjet ndryshimeve të bëra në nenet 9 dhe 10 të ligjit, referuar nenit 5 dhe 6 të ligjit të parë, ku është parashikuar që duke filluar nga viti 2015 e në vazhdim, do të ketë vetëm një kategori të pagës minimale dhe është pikërisht paga minimale në shkallë vendi, e cila vendoset nga Këshilli i Ministrarave në zbatim të dispozitave të kodit të punës. Gjithashtu në këtë ndryshim u parashikua që edhe paga maksimale aktuale nga viti 2015 e në vazhdim, të rritet me të njëjtin indeks sa edhe paga minimale. Vendosja e një page minimale të vetme për të

gjithë kategorite kontribuese, si dhe e sistemit të rritjes së pagës maksimale me të njëjtin indeks si dhe paga minimale, do të shmangë defektet aktuale në masën e pensioneve minimale, si dhe do të realizojë uniformizimin e përfitimeve krahasuar me kontributet e paguara. Nga ana tjetër, vendosja e pagës minimale në shkallë vendi edhe në zbatim të ligjit, e kombinuar me përmirësimin e rregullave dhe indekseve të rivlerësimit të pagave, mbi të cilat janë llogaritur e paguar kontributet në vite, do të sjellë si pasojë përmirësimin e përfitimeve dhe lidhjen më të drejtë të tyre me kontributet e paguara, përgjatë gjithë periudhës së punës.

Gjithashtu në ndryshimet e ligjit, në dispozitat që lidhen me kapitullin e kontributeve, janë reflektuar disa ndryshime dhe janë shfuqizuar disa dispozita, të cilat ishin të ndërtuara që në vitin 2005 për kalimin e mbjeldhjes së kontributeve nga sigurimet shoqërore në përgjegjësi të Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve. Këto dispozita tashmë kanë mbetur pa funksion, ndërkohë që për procedurat e mbledhjes dhe transferimit të kontributeve është ndërtuar dhe zbatohet një ligj i veçantë.

Në ndryshimet e ligjit u parashikua llogaritja e përfitimeve bazuar në pagën neto, ndërkohë që janë rregulluar dhe optimizuar kriteret që kanë të bëjnë me periudhën që merret për bazë për llogaritjen e të ardhurave, si në raste të sëmundjeve, ashtu edhe të barrëlindjeve. Sipas dispozitave të para përfitimet për këto raste përlllogariteshin me bazën e vlerësuar të vitit të fundit kalendarik, ndërkohë që nga zbatimi në praktikë në të shumtën e rasteve përfitimet ishin shumë më të ulta se paga përfundimtare e përfituesit, si dhe periudhat e sigurimit ishin të palidhura me përfitimin.

Në ndryshimet e bëra në nenin 30, referuar nenit 15 të ligjit të parë, është bërë ripërcaktimi i llojeve të pensioneve duke shfuqizuar termin “pension i pjesshëm i pleqërisë”. Sipas formulës së re të kalkulimit të pensioneve, duke filluar nga data

1.1.2015 e në vazhdim, ky term nuk ka kuptim. Termi pension merr kuptim për çdo person të siguruar, që nëpërmjet kontributeve të paguara, përgjatë gjithë veprimtarisë së tij ekonomike, ka një periudhë kontributive jo më pak se 15 vite. Në këto kushte ndryshimet e formulës së pensionit janë bërë në nenet 31 dhe 32 të riformuluara, ku parashikohet ndryshimi i kushteve dhe formulës së pensionit.

Sa më sipër duke filluar nga viti 2015, në harkun kohor 2015-2032, mosha e pensionit për gratë do të rritet me dy muaj në vit deri në arritjen e moshës 65 vjeç, ndërsa për këtë periudhë mosha e pensionit për burrat nuk do të ketë ndryshim. Pas vitit 2032 mosha e burave dhe e grave do të rritet në proporcion me shtimin e parashikuar të jetëgjatësisë, duke u barazuar në 67 vjeç në vitin 2056. Gjithashtu me ndryshimet e bëra në neni 32, bëhet një ripërcaktim i formulës së llogaritjes së pensionit dhe heqje e tavaneve, të cilat kufizonin marrjen e pensionit më të lartë se dyfishi i pensionit minimal edhe për rastet kur me kontributet e paguara përlllogaritej një pension më i lartë. Këto tavane krijojnë padrejtësi, kishin dobësuar ndjeshëm lidhjen midis pensionit dhe kontributit dhe dekurajonin pagimin e kontributeve me paga të larta, duke u bërë shkak për evasion dhe fshehje të pagave.

Sipas dispozitave të para, pensioni llogaritet sipas një formule të përcaktuar, e cila merr parasysh një pension bazë që përcaktohet çdo vit me VKM, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 75% e pagës neto minimale në shkallë vendi dhe një shtesë e cila llogaritet si 1% për çdo vit sigurimi, e bazës së vlerësueshme ose e pagës mesatare, mbi të cilën janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore e aktualizuar. Pensioni i llogaritur sipas formulës ishte objekt i kufizimit të dy rregullave: - pensioni i llogaritur nuk mund të ishte më i madh se 75% e pagës mesatare neto në tre vite të njëpasnjëshme në dhjetë vitet e fundit të punës dhe - nuk mund të ishte më i madh se dyfishi i pensionit bazë.

Praktikisht, këto dy kufizimi kishin bërë që kthimi i kontributeve të paguara gjatë gjithë karrierës në formën e pensionit për të siguruarit me paga mbi pagën mesatare të ishte në nivele shumë të ulëta (rreth 55%), ndërsa për të siguruarit me paga minimale kthimi i kontributeve të ishte rreth 150%, që do të thotë që marrin 50 % më shumë sesa kanë kontribuar.

Për rivendosjen e parimit kontributiv dhe forcimin e tij, në këtë ndryshim u bë ripërcaktimi i formulës së përlllogaritjes së pensionit, duke zëvendësuar pensionin bazë me pensionin social dhe duke rritur atë pjesë të pensionit që lidhet drejtpërdrejt me madhësinë dhe vitet e kontributeve të paguara. Ky ndryshim do të rrisë peshën e pjesës së pensionit që merr për bazë pagën mbi të cilën ka kontribuar gjatë jetës, si dhe gjatësinë e periudhës së sigurimit (vitet e sigurimit). Kështu për personat që kanë kontribuar më gjatë në skemë ose kanë kontribuar me paga të larta, masa e pjesës kontributive të pensionit do të jetë më e madhe, duke krijuar një lidhje më të drejtë midis kontributit të paguar ndër vite dhe pensionit. Ky ndryshim në mënyrën e llogaritjes u shoqërua edhe me eliminimin e dy kufizimeve, duke lënë si pension që do të përfitohet vetëm masa e pensionit që del nga llogaritja sipas formulës.

Sipas kësaj formule për personat që kanë kontribuar me paga mbi pagën mesatare, masa e pensionit do të rritet në nivele të pranueshme ndaj pensioneve aktuale dhe bazuar në shumat më të mëdha të derdhura si kontribut. Pensionistët që do të dalin në pension nga viti 2015 dhe për një periudhë afatmesme do të kenë një rritje të moderuar të masës së pensionit ndaj atij aktual. Ndërsa në periudhën afatgjatë shpresohet për personat që kontribuojnë me paga më të larta, pensionet do të jenë më të qenësishëm dhe të mbështetur mbi pagat e tyre reale të deklaruara në listpagesa dhe të indeksuara sipas rregullave të qarta dhe të qëndrueshme, të cilat do të japin një bazë të vlerësueshme më

të lartë dhe për rrjedhojë një masë më të madhe për pjesën kontributive të pensionit (shtesa në formulë).

Për vitin 2016 shpenzimet për pensione ishin 82 295 milionë lekë (bashkuar me fondin për rritjen e pensioneve) me një rritje ndaj vitit 2013 në shumën 5433 milionë lekë dhe që është pasojë e shtimit të numrit të pensioneve si dhe e indeksimit të masës së tyre. Por, ndërsa shtesa në shpenzimet për pensione është në këto nivele, shtesa e të ardhurave nga kontributet arrin në rreth 60% të kësaj shume, duke vazhduar të thellojë bilancin negativ aktual të pensioneve, si dhe të sistemit në përgjithësi. Ndër masat e rëndësishme për minimizimin gradual të këtij deficiti dhe të deficitit të përgjithshëm parashikohet të jenë rritje ekonomike, formalizimi i ekonomisë, masat efikase për mbledhjen e kontributeve, si dhe ndërtimi i një lidhje të drejtë kontribut- pension, por ndër to ndikim do të ketë edhe rritja graduale e moshës së daljes në pension.

Si u justifikua rritja e moshës së pensionit me ndryshimet e fundit?

Ndryshimet demografike dhe sidomos rritja e jetëgjatësisë, kanë rritur ndjeshëm kohën e gëzimit të pensionit duke çbalancuar raportin e shumës së kontributeve të paguara dhe shumës së përfituar si pension. Ky fenomen i evidentuar në shumë shtete të Europës dhe në Botë është evident edhe në Shqipëri. Si rezultat i shumë faktoreve, jetëgjatësia evidentohet të rritet me një trend mesatar me mbi 1 muaj në vit. Ndërkohë është fakt që jetëgjatësia tek gratë është më e lartë se tek burrat. Aktualisht, në Shqipëri koha mesatare e gëzimit të pensionit për të dyja gjinitë për vitin 2016 është 21.9 vjet: për meshkujt 19.7 vjet dhe për femrat 25.3 vjet²⁸. Pra, koha e gëzimit të pensinit për femrat është 5 vjet më e lartë se për meshkujt për dy arsye kryesore: jetëgjatësia më e madhe e femrave, si dhe dalja në pension pleqërie më herët se meshkujt.

²⁸ http://www.iss.gov.al/al/ep-content/uploads/2014/02/Perb_12_16_26_05_2016.pdf (f 17)

Nga grupet e mbrojtjes së të drejtave të grave është ngritur gjithnjë shqetësimi i trajtimit të pabarabartë i grave, në lidhje me daljen në pension dhe nxjerrjen nga tregu i punës më herët. Kjo nxjerrje nga tregu i punës krijon probleme të natyrës sociale dhe ekonomike tek gratë, si humbje të ekspertizës, përjashtim nga vendimarrja dhe kontributi në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, diskrimin gjinor, përjashtim nga jeta aktive shoqërore, etj. Shumica e vendeve të Europës kanë një trajtim të barabartë përsa i përket moshës së daljes në pension për të dyja gjinitë.

Duke marrë në konsideratë traditën e vendit tonë, zhvillimet e tregut të punës, nivelin e papunësisë të grave afër moshës së pensionit, problemet sociale, etj, me ligjin është menduar që mosha e daljes në pension për gratë të rritet me pesë vjet, pra nga 60 në 65 vjeç, duke harmonizuar të gjitha kërkesat dhe detyrimet. Për të shmangur efektet sociale dhe rritur pranueshmërinë është përcaktuar që kjo rritje moshe të bëhet në mënyrë graduale duke e rritur me vetëm 2 muaj në vit dhe efektin e plotë do ta ketë në vitin 2032 ose pas 18 vjetësh.

Rritja graduale e moshës së daljes në pension për gratë natyrisht do të ndikojë në uljen e shpenzimeve për pension dhe nga ana tjetër do të shmangë diskriminimin e deritanishëm, do të plotësojë rekomandimet e Bashkimit Europian dhe do të harmonizojë këtë me vendet e tjera të rajonit dhe Europës. Gjithashtu, kontribui mi më i madh, i shoqëruar edhe me disa “privilegje” të tjera që skema ofron për gratë, do të japin për to një pension më të lartë se sot.

Bazuar në statistikat të pensioneve dhe parashikimin e numrit të pensioneve të reja, aktualisht numri i grave që del në pension pleqërie është rreth 15 200, me një efekt mesatar vjetor 2663 milione lekë. Mbështetur në nenin 92 referuar nenit 43 të ligjit, kuadrin e rritjes graduale të moshës së daljes në pension me 2 muaj në vit, numri i grave

që nuk del në pension për shkak të rritjes së moshës përlllogaritet të jetë rreth 2500 persona. Për shkak se shpërndarja e pensioneve të reja është gjatë gjithë vitit, në vitin e para numri i pensioneve të reja për gratë është rreth 1300, me një efekt financiar vjetor 210 milione lekë.

Ndryshimet në ligj ripërcaktuan rregulla të qarta dhe të sakta lidhur me indeksimin e pagave mbi bazën e të cilave është paguar kontributi nga momenti i pagesës deri në datën e daljes në pension. Bazuar në ndryshimet e referuar nenit 31 të ligjit, për efekt të kalkulimit fillestar të pensioneve, duke filluar nga data 1.1.2015 e në vazhdim, do të realizohet ripërcaktimi i koeficienteve të indeksimit të bazës së vlerësuar, përcaktimi i një pagë referuese për vjetërsinë e punës në ish-kooperativat bujqësore, eliminimi i dysHEMEVE administrative që krijonin shKëputje në kalkulimin e pensioneve fshat-qytet edhe pas 20 vjetësh të ndryshimeve të para ligjore.

Sa sipër duke qenë se në harkun kohor 1994-2014 indeksi i rivlerësimit të pagave për efekt të pagimit të kontributeve, duke qenë i lidhur me nivelin e kontributit mesatar, është deformuar e dëmtuar si shkak i rritjes administrative të tavanit të pagës mbi të cilën paguhen kontributet nga 1/3 ne 1/5 duke filluar nga viti 2002, por edhe si shkak i uljes së normës së kontributit ndaj pagës nga 42,5 ne 24,5 %, aktualisht edhe paga e rivlerësuar minimale mbetet rreth 20% më e ulët se paga minimale aktuale. Në këto kushte për uniformizimin e pensioneve të caktuara bazuar në dispozitat egzistuese me ato të parashikuara sipas formulës së re, duke rujtur nivelin aktual të të ardhurave minimale nga pensioni, por edhe për mos krijimin e disbalancave të përfitimeve të vitit të ardhshëm me ato aktuale, në këtë ndryshim është parashikuar që për efekt të llogaritjes së pensioneve, me datë fillimi pas 1.1.2015 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese sipas llojit të punës ose funksionit

përpara datës 01.01.1994, si edhe mbi pagat individuale mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 01.01.1994 deri në 31.12.2014, të indeksuara me indeksin që del nga pjestimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2016 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës. Koeficientët e indeksimit sipas viteve, si edhe deri sot do të miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Nga ana tjetër vendosja e pagës referuese për vjetërsinë e punës në ish-kooperativat bujqësore bën të panevojshëm përdorimin e rregullave të ndryshme për llogaritjen e pensionit. Duke filluar nga viti 2015, çdo njeri, pavarësisht nga historiku i vjetërsisë në punë, në marrëdhënie me shtetin, me ish-kooperativat, apo me kontribute të derdhura nga viti 1994 dhe në vazhdim, do të ketë të drejtë të marrë një pension që varet nga shuma e pensionit social, shuma e kontributeve të paguara dhe gjatësia e periudhës së sigurimit. Një masë e tillë eliminon dy formulat, heq barrierën administrative të ndarjes së pensioneve fshat-qytet, në vartësi të gjysmës së periudhës së sigurimit, sjell detyrimin dhe të drejtën për të paguar kontribute dhe për një pension që varet prej tyre, krijon një lidhje të drejtpërdrejt midis masës së kontributit pa diferencime dhe të masës së pensionit, si dhe reflekton një formulë që realist heq dallimin pension fshati-pension qyteti.

Gjithashtu referuar nenit 32 të ligjit, parashikohen qartë rregullat për indeksimin e pensioneve, duke abroguar ato dispozita që krijojnë mundësinë për rritje të diferencuar të pensioneve apo për rritje në nivele të zgjidhjeve të momentin, por që krijojnë problematika për qëndrueshmërinë financiare afatgjatë të sistemit. Pensioni social, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit, familjare, si edhe të ardhurat nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, do të indeksohen çdo vit, për të kompensuar pasojat e ndryshimit të çmimeve të mallrave dhe të shërbimeve të zgjedhura për nivelin minimal

të jetesës së pensionistëve. Këshilli i Ministrave me vendim të veçantë do të ripërcaktojë listën e mallrave të zgjedhura, mbi të cilën llogaritet indeksi, metodën e llogaritjes dhe datën e indeksimit të pensioneve.

V.4 Problemet që konstatohen në sistemin aktual të pensioneve

Për të konstatuar qartë problemet duhet të shqyrtohet ecuria e madhësisë së disa treguesve analitikë, si pensioni mesatar, raporti i zëvendësimit, i mbulimit, i varësisë, si dhe i përfituesve ndaj numrit të përgjithshëm të popullsisë për të gjithë periudhën që analizohet.

1. *Masa e ulët e përfitimeve nga pensionet* - kjo vjen për shkak të ritmit të ngadaltë të rritjes së madhësisë reale të pensioneve me kalimin e kohës. Shënojmë se në vitin 2015 pensioni mesatar real krahasuar me vitin 1993, është rritur me 2% në vit, ndërsa paga mesatare është rritur me 38% në vit. Me shqetësuese paraqitet situata e masave të pensioneve në fshat, ku madhësia e pensionit mesatar real ka shënuar një ulje prej 24% në vitin 2015 në krahasim me vitin 1993.
2. *Shkalla e zëvendësimit* - që shpreh raportin midis madhësisë së pensionit mesatar me pagën mesatare, rezulton me prirje përkeqësimi, si në qytet ashtu edhe në fshat. Në qytet, nga 60.2% që ka qenë në 1994, në vitin 2006 ulet në 43.4%. Ndërsa, në fshat kemi një trend tjetër. Deri në vitin 2000 kemi një rënie deri në 15.78%, nga 27.34% që ishte në vitin 1994. Më pas kemi një rritje të këtij raporti në 26.9%, në vitin 2006.
3. *Koeficienti i varësisë së sistemit* - që shpreh raportin e përfituesve ndaj kontribuesve të skemës së sigurimeve shoqërore, është përkeqësuar nga vit në vit

deri në vitin 2002. Në vitin 2003 ka përmirësim dhe më pas me arritjen e moshës 65 vjec për burrat dhe 60 vjec për gratë, ka filluar përsëri renien.

4. *Norme e lartë e evazionit të kontribuesve* - lidhur me numrin e kontribuesve. Numri i kontribuesve ndaj forcave të punës është në nivelet 65-67%. Ky tregues shumë më i përkeqësuar është në fshat, ku numri i kontribuesve ndaj personave të punësuar nuk i kalon 50%, megjithëse qeveria ka vendosur norma të ulta të kontributit.
5. *Të ardhurat nga puna si pjesë e PBB-së* - kur këto të fundit vlerësohen nga pikëpamja e uniformizimit të tyre me kontributet e derdhura, rezultojnë në nivelet 11.5-12.2%, ndërkohë që në vendet e tjera ky tregues është shumë më i lartë. Edhe nga ky tregues mund të arrijmë në konkluzionin se niveli i evazionit është shumë i lartë në lidhje edhe me pagën mbi të cilën paguhen kontributet.
6. *Mbulimi nga pensionet* - në vitin 2016 rezulton 146.5% dhe është i krahasueshem me Rumaninë, Moldavinë dhe Bullgarinë, çka tregon se aktualisht kemi një përqindje të mirë të mbulimit të popullsisë me elementë të sigurimit shoqëror. Megjithatë ky tregues paralajmëron se mosha mesatare e pensionisteve është e lartë dhe për pasojë koha e gëzimit të pensionit do të jetë e lartë.
7. *Sistemi i pensioneve rezulton i pa balancuar* - megjithëse shkalla e zëvendësimit është mbajtur e ulët 43.8%, në fshat ajo është rreth 26.7%, përsëri si shkak i një raporti kritik kontribues/përfitues, që në fakt më së shumti është pasojë e evazionit, sistemi i pensioneve rezulton me humbje. Deficiti nominal i skemës së pensioneve në 5 vitet e fundit, (në këtë tregues janë marrë parasysh vetëm kontributet e mbledhura direkt për skemen e pensioneve) arrin mesatarisht në rreth 1.6% të PBB-së.

KAPITULLI VI → PROGNOZIMI ME MODELIN PROST

Politikat e sotme të pensioneve mund të ndikojnë në të ardhurat e daljes në pension dhe në financat publike për dekadat e ardhshme. Sistemet e ndërtuara sigurojnë të ardhura që mundësojnë daljen në pension, mund të jenë të përballueshme sot, këto sisteme do të provojnë paqëndrueshmëri në të ardhmen, duke pasur parasysh presionin e dyfishtë të plakjes të popullsisë nga njëra anë dhe vjetërimi i skemave të pensioneve nga ana tjetër.

Hartuesit e politikave dhe aktorët e tjerë kryesorë kanë përdorur modelin Prost për të vlerësuar skemat ekzistuese dhe mundësitë e reformave, në më shumë se 90 vende të botës. Modeli është projektuar për të nxitur politikë-bërjen dhe për ta mbështetur në tejkalimin e hendekut midis analizës sasiore dhe cilësore të sistemit të pensioneve. Ky është një model fleksibël, i bazuar në një paketë të mjeteve kompjuterike, lehtësisht i përshtatur me një gamë të gjerë rrethanash të vendeve të ndryshme që e përdorin.

VI.1 Pse prognozojmë sistemet e pensioneve?

Sistemet e pensioneve pay-as-you-go janë paraqitur më pak ose aspak analiza për efektet afatmesme ose afatgjata mbi të moshuarit, mbi punëtorët dhe mbi financat publike. Pasi skemat janë ngritur, mbetet një nevojë për shqyrtim të rregullt të ndikimit të faktorëve në sistemin e pensioneve, të tillë si ndryshimi i jetëgjatësisë dhe menyrat e pjesëmarrjes të fuqisë punëtore në këto skema.

Hartimi i politikave të pensioneve mund të jetë i rrezikshëm pa parashikimet afatgjata të sistemit financiar që mbështetin këto skema. Programet e pensioneve mund të jenë ndikuar politikisht, por efekti i plotë financiar i këtyre ndikimeve duket vetëm gjatë

periudhave afatgjata, apo në ndikimin në gjeneratat që do të vijnë. Kur skemat pay-as-you-go futen për herë të parë, mund të gjenerojnë të ardhura neto për qeverinë, për shkak se të ardhurat nga kontributet e pagave kalojnë (fillimisht në mënyrë modeste) shpenzimet e përfitimit. Kostot e vërteta të skemës së pensioneve shfaqen në periudha afatmesme dhe afatgjatë, vetëm kur sistemi maturohet. Njerëzit shpesh i konsiderojnë këto përfitime të ardhshme si të drejta të pa diskutueshme, duke e bërë politikisht shumë të vështirë rregullimin në përputhje me presionet demografike dhe ekonomike²⁹. Përfitimet e pensionit janë ndonjëherë të mbrojtura edhe nga kushtetutat e vendeve të ndryshme.

Vende, të tilla si Brazili³⁰, ku tre të katërtat e deficitit fiskal i atribuohen sigurimeve shoqërore, janë raste të izoluara. Kostoja e paguar për subvencionin e pensioneve i zë vendin shpenzimeve të programeve të tjera, të cilat e meritojnë të marrin me shumë, si shëndetësia, arsimi, etj. Dhe kur pagesat i kalojnë të ardhurat e kontributeve, subvencionimet kërkohen nga të ardhurat e përgjithshme, të tilla si taksat mbi vlerën e shtuar apo taksat e përgjithshme. Përfitimet e pensionit kanë tendencë për të shkuar në një pakicë të privilegjuar të mbuluar me siguracione që punon në sektorin formal, në mënyrë që subvencionet e nevojshme për të mbështetur përfitime të tilla, mund të jetë shumë regresive.

Modelet e skemave vlerësojnë bilancet e të ardhurave gjatë një periudhe afatgjatë dhe kështu përcaktojnë qëndrueshmërinë e sistemit. Modelimi i pensioneve, gjithashtu mund të vlerësojë në mënyrë rigoroz reformat e ndryshme të sistemeve të pensioneve, duke i informuar si politikëbërësit dhe publikun për pasojat financiare të ndryshimit.

²⁹ Rasti Grek i uljes se masës së pensioneve.

³⁰ Bonturi, M. (2002), "The Brazilian Pension System: Recent Reforms and Challenges Ahead", OECD Economics Department Working Papers, No. 340, OECD Publishing, Paris.

VI.2 Pyetjet e kërkimit

PROST është modeluar për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

- Cilat do të jenë kontributet, përfitimet, të ardhurat dhe nevojat potenciale për subvencione afatgjata? Do të jetë i zbatueshëm dhe i qëndrueshëm sistemi në periudha afatgjata?
- Çfarë lloj përfitimesh mund të presin njerëzit për të marrë në të ardhmen? A do të sigurojë sistemi i pensioneve të ardhura të mira pas daljes në pension për kategori të ndryshme të njerëzve?
- Sa të mëdha janë detyrimet e nënkuptuar të qeverisë për sistemet e pensioneve?
- Si do të zgjerohet mbulimi, duke ndryshuar kualifikimin, duke ndryshuar përfitimet, ose përshtatur normat e kontributit që ndikojnë sistemin?
- Si do të ndryshojnë kostot, shpenzimet dhe përfitimet në bazë të reformave të ndryshme?

VI.3 Metodologjia e prognozimit.

Modeli përdor të dhënat e vendit specifik të ofruara nga ana e përdoruesit. Ai gjeneron projeksionet e popullsisë, e cila e kombinuar me supozimet ekonomike, përdoren për të parashikuar numrat e ardhshme të kontribuesve dhe përfituesve. Këto, nga ana tjetër krijojnë flukse të të ardhurave dhe shpenzimeve. Modeli më pas projekton balancat fiskale, duke marrë parasysh çdo para-financim të pjesshëm të detyrimeve.

Modeli mund të përdoret si për pagesë në një “stok” apo një qasje “rrjedhjese”.

Një seksion i veçantë në PROST analizon ndikimin e pensioneve në një nivel individual. Me anë të modelit mund të shqyrtojmë ndikimin e sistemit dhe reformave në

punëtorët individualë me të ardhura të ndryshme, normat e vdekshmërisë, profilet e të ardhurave, mosha e hyrjes në punë, modelet e daljes në pension, etj

Modeli mund të vlerësojë çdo gjë nga reformat fillestare parametrike të sistemit pay-as-you-go të ndryshimit të moshës së pensionit, normat e kontributeve, përfitimet, indeksimin, etj, për reformat strukture, të tilla si kalimi i individit, të skemave plotësisht të financuara. PROST mund të trajtojë skemat e fondeve të sigurimit, si dhe sistemet pay-as-you-go, si pikënisje, para reformës.

Modeli gjithashtu lejon rrugë të ndryshme të tranzicionit për një sistem të ri, duke përfshirë edhe grup-mosha (breza) të mbuluara nga sistemi i ri (të tilla si duke aplikuar reforma vetëm për punëtorët e rinj) dhe trajtimin e të drejtave të pensionit të përlogaritur para reformës. Të drejtat e përlogaritura mund të paguhesh në mënyra të shumta, duke përfshirë si pagesa njëherëshe dhe pagesave rrjedhese.

VI. 3.1 Outputi i modelit

Modeli Prost prodhon pesë module outputi, përfshirë këtu tabelat dhe grafikët.

Modulet përshijnë:

1. *Projeksionet e popullsisë*, duke përfshirë tabelat e jetëgjatësisë, piramidat e popullsisë, raportet e varësisë së popullsisë, etj.
2. *Strukturën demografike*: forcën e punës dhe punësimit, numrin e kontribuesve dhe përfituesve, raportin e varësisë së sistemit.
3. *Flukset financiare*: parashikimet e pagave, përfitimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve të sistemit të pensioneve, bilancin e skemës së pensioneve dhe të borxhit të nënkuptuar të pensioneve. Moduli i flukseve financiare gjithashtu

llogarit rregullimet për të përfituar nivele apo shkallë kontributi që do të “balancojnë” sistemin, dmth të sjellë të ardhurat dhe shpenzimet në baraspeshë.

4. *Reformat sistematike*: ky modul ilustron efektin e një ndryshimi në një regjim “shumështyllësh”, duke përfshirë edhe një pension pay-as-you-go, bashkëngjitur me sisteme të financuara plotësisht apo pjesërisht. Ai mat ndikimin edhe në financat e sistemit dhe mbi pensionet individuale, duke përfshirë matjen e kostove të tranzicionit. Përfitimi i përgjithshëm i pensioneve dhe vlera e secilës prej shtyllave jepen të ndara.
5. *Efektet mbi shembujt individual*: modeli përpunon kontributet dhe përfitimet për shembuj individuale të ndryshëm, të përcaktuar nga mosha, gjinia, mosha e hyrjes në tregun e punës, mosha e daljes në pension, profili i të ardhurave, vdekshmëria, etj.

Të gjitha modulet lejojnë analizën e ndjeshmërisë së rezultateve të parametrave kryesore demografike dhe ekonomike, të tilla si fertiliteti, jetëgjatësia, rritja e pagave dhe normat e interesit.

VI. 3.2 Të dhënat dhe supozimet e modelit

Modeli ka nevojë për të dhëna realiste për të mbështetur qëndrueshmërinë e gjetjeve. Të dhënat kryesore të nevojshme janë:

- Fertiliteti i popullsisë dhe vdekshmëria, sipas moshës dhe gjinisë.
- Normat e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, shkalla e papunësisë sipas moshës dhe gjinisë.
- Numri i kontribuesve dhe përfituesve, kontributi i tyre dhe modelet e pensionit, sipas moshës dhe gjinisë.

— Pagat dhe pensionet, sipas moshës dhe gjinisë, shpërndarja e të ardhurave për kontribuesit dhe pensionistët.

Modeli gjithashtu mbështetet në supozimet për disa tregues, duke përfshirë:

- Rritja e pagave.
- Rritja ekonomike.
- Rritja në mbulimin e skemës së pensioneve kontributive.

Tabela 3 përmbledh të dhënat dhe supozimet e përdorura në model.

Tabela 3 Të dhënat dhe supozimet e përdorura në modelin PROST

Të dhëna lidhur me:			Supozime lidhur me:		
<i>Demografinë</i>	<i>Tregun e punës</i>	<i>Ekonominë</i>	<i>Demografinë dhe Tregun e punës</i>	<i>Ekonominë</i>	<i>Sjelljen</i>
Fertiliteti i popullsisë	Normat e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, sipas moshës dhe gjinisë	Numri i kontribuesve dhe përfituesve, kontributi i tyre, sipas moshës dhe gjinisë	Norma e projektuar e fertilitetit dhe vdekshmërisë	Rritja e projektuar e PBB-se	Normat e ardhshme pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, sipas moshës dhe gjinisë
Vdekshmëria, sipas moshës dhe gjinisë	Shkalla e papunësisë sipas moshës dhe gjinisë	Modelet e pensionit	Norma e projektuar e papunësisë	Rritja e projektuar e pagave	Shpërndarja e të ardhurave për kontribuesit dhe pensionistët.
	Pagat sipas moshës dhe gjinisë	Shpërndarja e të ardhurave për kontribuesit dhe pensionistët	Numri i kontribuesve		
			Numri i përfituesve		

KAPITULLI VII → SUPOZIMET PËR PROJEKTIM TË SISTEMIT SHQIPËTAR

VII. 1. Supozime Projektimi të sistemit bazë(egzistues)

1. Supozime lidhur me lindshmërinë, jetëgjatësinë në lindje dhe migrimin në të ardhmen.

— Lindshmëria

Lindshmëria në fakt përcaktohet nga ndikimet social - kulturore të një vendi. Tek lindshmëria ndikojnë një sërë faktorësh, siç mund të jenë: ndryshimi strukturor në tregun e punës, rritja e niveleve të arsimit, ndryshimi i vlerave, por gjithashtu edhe nga ndikimet e institucioneve tradicionale sociale, të tilla si familja e zgjeruar dhe kultura patriarkale, faktorë që mund të çojnë drejt trendeve të çrregullta të rënies apo rritjes të lindshmërisë.

Të dhënat e fundit në indeksin e lindshmërisë e evidentuar nga statistikat vitale, i shton pasiguri zhvillimeve të ardhshme në lindshmëri. Nga njëra anë mund të përfaqësojë një luhajtje afatshkurtër – siç është vëzhguar në të kaluarën në Shqipëri dhe në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Nga ana tjetër, rritja mund të jetë gjithashtu pararendëse e një rikuperimi të zgjatur nga zbatimi i një politike familjare proaktive, gjë që nuk është rasti i Shqipërisë. Megjithatë të gjitha hipotezat supozojnë se gratë do të lindin në mosha më të mëdha në të ardhmen (dmth shtyrje e lindjeve në kohë), ato kryesisht ndryshojnë në përputhje me trendin e numrit mesatar të lindjeve për grua (indeksin e lindshmërisë).

Tabela 4: Indeksi i lindshmërisë

Vitet	2011	2021	2026	2031	2060
Indeksi i lindshmërisë	1.73	1.44	1.3	1.4	1.5

Burimi: INSTAT, 2014

Parashikimet e lindshmërisë bazohen në tendencën afatgjatë dhe sugjerojnë një konvergjencë të vazhdueshme në drejtim të modelit Europian. Pritet një rënie e ngjashme ashtu si dhe në ciklin e kaluar të projeksioneve (INSTAT, 2004), i cili pati një parashikim mjaft të mirë për nivelin e lindshmërisë për vitin 2011. Indeksi i lindshmërisë do të zbresë nga 1,73 në vitin 2011 në 1,3 fëmijë për grua në vitin 2026 (INSTAT, 2014).

Tabela 5: Indeksi i lindshmërisë në Europë

Vendet/Vitet	2015	2020	2030	2040	2050	2060
Bulgaria	1.52	1.54	1.55	1.52	1.48	1.42
Greece	1.35	1.35	1.34	1.32	1.29	1.26
Croatia	1.52	1.51	1.48	1.43	1.39	1.34
Italy	1.43	1.42	1.40	1.37	1.33	1.29
Portugal	1.27	1.28	1.28	1.26	1.24	1.21
Romania	1.66	1.68	1.66	1.61	1.54	1.46
Slovenia	1.59	1.58	1.55	1.51	1.46	1.40

Burimi: Eurostat, 2014

Sipas tabelës 5 një ritëm i ngjashëm u vëzhgua në Portugali dhe në Itali në të kaluarën. Pas një vlere minimale të indeksin e lindshmërisë në vitin 2030, pritet një rënie e lehtë deri në nivelin 1,4 për shkak të lindjeve në moshë të madhe, të cilat më parë ndodhnin tek moshat më të reja. Shumë vende të Europës Perëndimore, Qendrore dhe Lindore kanë kaluar një rënie të tillë në lindshmëri, që nga viti 2003 (Eurostat, 2014).

Në përputhje me shtyrjen e lindjeve të pritshme dhe rikuperimin pasues, ne parashikojmë një plakje në lindshmëri (si dhe një përqendrim fillestar, pasuar nga një spostim i normave specifike të lindshmërisë rreth moshës mesatare në lindje).

Kjo konvergjencë e Shqipërisë drejt modelit dominues të lindjes së fëmijëve në Europë mund të pritet përgjatë procesit të vazhdueshëm të modernizimit të shoqërisë. Supozohet që lindshmëria e lartë e zonave rurale do të shkojë drejt niveleve të zonave urbane (sipas INSTAT, indekset e lindshmërisë respektive ishin 1,9 dhe 1,3 në vitin 2007), si dhe adoptimi i standardit urban të lindjes së fëmijëve nga migruerit nga zonat rurale në ato urbane. Ky parashikim i ulët nënkupton një rritje të vazhdueshme në arsimimin e nivelit të lartë, dhe një pjesëmarrje më të lartë të grave në tregun e punës, gjë e cila e komplikon pajtimin e madhësisë ideale të familjes me përgjegjësitë profesionale.

Efektet e krizës potenciale ekonomike do të mbështesnin gjithashtu shtyrjen dhe rënien e lindshmërisë, siç vëzhgohet në Europë³¹. Përtej efekteve negative të të ardhurave, lidhjet e forta familjare i motivojnë çiftet e reja për t'u kujdesur për situatën financiare dhe shëndetësore të prindërve të tyre, gjë e cila mund të çojë drejt një lindshmërie të shtyrë dhe të kufizuar tek brezi i ri. Krahës kësaj, emigrimi i djemve të rinj çon në martesë të vonshme dhe/ose ndarje bashkëshortësh, gjë e cila mund t'i vonojë lindjet. Kthimi i mundshëm i më shumë emigrantëve pas vitit 2026, mund të shoqërohet gjithashtu me rikuperimin e lindshmërisë kur çiftet ribashkohen në Shqipëri (Dumani dhe Subashi, 2011). Më pas, deri në vitin 2080, ritmi i ndryshimit të shkallës së lindshmërisë sipas moshës dhe gjinisë, i referohet popullsisë shqiptare projektuar nga Departamenti i Popullsisë pranë OKB-se.

³¹ Fertility reactions to the 'Great Recession' in Europe: Recent evidence from order-specific data
Joshua R. Goldstein, 2013

Tabela 6 : Parashikimi Botëror i Popullsisë

Vitet	2015-2020	2025-2030	2045-2050	2095-2100
Indeksi i lindshmërisë	1.76	1.78	1.77	1.82

Burimi: Organizata e Kombeve të Bashkuara, 2015

Pa sa më sipër indeksi i lindshmërisë për parashikimin do të merren sipas tabelës së mëposhteme. Ndërkohë që të dhënat e botuara nga INSTAT janë deri në vitin 2060 dhe parashikimi ynë shkon deri në vitin 2075, *supozojmë që shkalla e lindshmërisë dhe shkalla e mortalitetit pas vitin 2031 të mbeten konstante deri në fund të periudhës së parashikim.*

Tabela 7: Parashikimi i Indeksit të lindshmërisë për modelin.

Vitet	2016	2021	2026	2031	2060
Indeksi i lindshmërisë	1,73	1,61	1,56	1,50	1,50

— Jetëgjatësia në lindje

Koeficientët specifikë të vdekshmërisë sipas grupmoshës dhe gjinisë janë marrë duke u nisur nga nivelet e vrojtura në vitin 2011 dhe duke përdorur një shkallë fikse përmirësimi bazuar në tendencat e 10 viteve të fundit në Shqipëri. Parashikohet një rënie më e ngadaltë në vdekshmërinë e moshave më të mëdha sesa te fëmijët, pasi niveli është tashmë i ulët. Rënia mund të nxitet nga një stil jetese më i shëndetshëm (duke përfshirë konsumim më të vogël të duhanit dhe alkoolit dhe më pak aksidente), si dhe nga zhvillimet në teknologjinë mjekësore (dhe bio-teknologjinë), të cilat mund ta reduktojnë vdekshmërinë nga sëmundjet kardiovaskulare. Rritja e efektivitetit të sistemit për kujdesin shëndetësor dhe përhapja më e mirë e informacionit tek popullsia si dhe tek institucionet, e mbështet këtë tendencë. Tendenca aktuale e konvergencës së

vdekshmërisë së meshkujve me nivelet e ulta të saj tek gratë pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 8 :Jetëgjatësia sipas gjinisë.

Viti	Jetëgjatësia	
	Meshkuj	Femra
2011	74,4	79,2
2021	76,6	80,8
2031	78,1	81,9
2061	81,1	84,1

Burimi: INSTAT, 2014

— Migrimi ndërkombëtar

Duke pasur parasysh dy dekadat e mëparshme të emigrimit në shkallë të gjerë, të përhapur në të gjithë Shqipërinë, të gjitha parashikimet supozojnë një tendencë përgjithësisht në ulje për njëzet vitet e ardhshme. Në disa vende që kanë provuar emigrime të shumta (si rasti i Meksikës ose Marokut), flukset barazohen pas të paktën 15 deri 20 vitesh (De Haas, 2007). Shumë zona periferike tashmë provuan një shpopullim të fortë dhe nxitja e emigrimit pritet të reduktohet në të ardhmen. Në të njëjtën kohë, emigrimi për arsye pune në Itali dhe Greqi u ul, pasi emigrimi shqiptar u transformua nga një emigrim i dominuar nga meshkujt në një emigrim familjar ose martesor, ndërkaq edhe arsimimi luan një rol të rëndësishëm. Duke pasur parasysh nivelet e emigrimit për të dy gjinitë gjatë dekadës së fundit, janë supozuar tendenca të ngjashme në të ardhmen, si për meshkujt ashtu dhe për femrat. Prurjet e emigrimit përbëhen kryesisht nga migrantë që kthehen. Numri i tyre kohët e fundit është rritur edhe për shkak të krizës në Greqi dhe Itali, por pritet të reduktohet më vonë me daljen nga kriza. Megjithatë Shqipëria mund të bëhet tërheqëse për emigrantët jashtë vendit. Shkalla e kësaj tërheqjeje supozohet të varet nga ritmi i rritjes ekonomike në Shqipëri.

Emigrantët do të fillojnë gjithashtu të arrijnë moshën e pensionit dhe, ndoshta, të kthehen gjithnjë e më shumë në fund të viteve 2020. Të gjitha parashikimet japin një emigrim më të lartë sesa imigrimi, kështu që migracioni neto do të mbetet negativ, por supozimet ndryshojnë kryesisht tek ritmi i rënies së emigrimit.

Sipas parashikimit të emigrimit koeficientët e vërtetuar gjatë viteve 2000 parashikohen të ulen me një ritëm më të lartë: me dy të tretat deri në vitin 2021 (duke dhënë një Indeks Sintetik të Migrimit 0,5, si për burrat edhe për gratë) (INSTAT, 2014).

Mendohet se deri në vitin 2025 Shqipëria mund të jetë anëtarësuar në Bashkimin Europian, gjë e cila do të lehtësonte lëvizjen ndërkombëtare, kështu që Indeksi Sintetik i Migrimit pritet të mbetet konstant pas këtij viti. Numri i imigrantëve pritet të reduktohet nga 24 në 8 mijë për meshkujt ndërmjet viteve 2016 dhe 2021, dhe nga 12 në 6 mijë për femrat. Këto shifra mendohet të mbeten konstante deri në vitin 2031 (INSTAT, 2014) dhe deri në fund të periudhës së parashikimit të supozimit tonë. Ky parashikim bazohet tek pritshmëritë për tendencat pozitive të ekonomisë shqiptare, e cila mund të vazhdojë të evitojë recesionin. Rritja e investimeve të huaja direkte dhe mobilizimi më i mirë i burimeve ekonomike, financiare dhe të punës duhet të çojë drejt mundësive më të mëdha për punësim. Duke pasur parasysh një reduktim të pritshëm në hendekun e pagave ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të Europës Perëndimore, elementët tërheqës jashtë vendit mendohet të pakësohen, gjë e cila do të mbështeste lëvizjet e kthimit. Destinacionet e brendshme, të tilla si ekonomitë urbane në rritje do të bëhen një alternativë tërheqëse për njerëzit që banojnë në periferi.

Një politikë më kufizuese migrimi në Greqi dhe Itali mund t'i reduktojë edhe më shumë mundësitë për një (ri-)imigrim të ligjshëm. Për rrjedhojë, emigrantët që jetojnë tashmë jashtë vendit mund të qëndrojnë atje për periudha edhe më të gjata, duke çuar në një

stabilizim të numrit të të kthyerve. Pra, struktura tipike vajtje-ardhje e migrimit Shqiptar pritët të mbarojë.

2. Supozime lidhur me treguesit e punës

— Punësimi

Në tregun e punës në Shqipëri ekzistojnë dallime të konsiderueshme gjinore, ku femrat e të gjitha grup-moshave kanë shkallë shumë më të ulët punësimi se meshkujt. Hendeku është mesatarisht 15 pikë përqindjeje, pasi shkalla e papunësisë për femrat e moshës 15–64 vjeç është 40,7% krahasuar me 55,4% për meshkujt (INSTAT, 2014). Hendeku është më i ngushtë ndër punonjësit më të rinj të moshës 15–29 vjeç, për të cilët është vetëm 10 pikë përqindjeje, por shumë më i gjerë për moshat 30–64 vjeç, për të cilët arrin pothuaj në 20 pikë përqindjeje (INSTAT, 2014). Kjo do të thotë që femrat në moshë më të madhe kanë më shumë gjasa të përjashtohen nga tregu i punës për shkak diferencimi krahasuar me meshkujt (pavarësisht se shkalla e punësimit për femrat në moshë më të madhe është më e lartë sesa për femrat më të reja). Kjo mund të vijë si rezultat i faktit që femrat në moshë më të madhe kanë gjasa të largohen nga tregu i punës pasi marrin përsipër përgjegjësi familjare. Ky fakt gjithashtu sugjeron se femrat mund të hasin vështirësi në rikthimin në tregun e punës pasi kanë lindur fëmijë. Kjo është një çështje që duhet adresuar nëpërmjet veprimeve të synuara për të ndihmuar femrat në rikthimin në tregun e punës, ose nëpërmjet ofrimit të ambienteve të arsimit parashkollor dhe të kopshteve, si nëpërmjet veprimeve specifike për ritrajnimin dhe ndihmën për gratë që kthehen në punë, dhe si për shembull përmes politikave të orareve fleksibël në punë ose nëpërmjet të punuarit nga shtëpia etj, në mënyrë që të lehtësohet rikthimi i tyre në tregun e punës pas lehtësimit të përgjegjësisë të tyre familjare kur fëmijët bëhen të pavarur ose shkojnë në shkollë.

Hendeku gjinor është gjithashtu më i ngushtë midis femrave dhe meshkujve me nivel më të lartë arsimor. Ky fakt sugjeron që gratë dhe vajzat e arsimuara e kanë më të lehtë hyrjen ose rikthimin në tregun e punës në krahasim me ato më pak të arsimuara. Kjo do të thotë që ofrimi i lehtësive të arsimit parashkollor ose kopshteve mund të jetë veçanërisht i rëndësishëm për gratë më pak të arsimuara, për të mbështetur rikthimin e tyre në tregun e punës. Po ashtu, kjo sugjeron se masat për mbështetjen e rikthimit të grave më pak të arsimuara mund të jenë veçanërisht të rëndësishme dhe se programet për mbështetjen e grave që rikthehen në punë duhet të përfshijnë edhe një element të fortë ritrajnimit për të përmirësuar aftësitë e tyre për të pasur qasje në mundësi më të mira pune. Në këtë fushë një rol të rëndësishëm mund të luajë ngritja e sipërmarrjeve sociale, duke ndjekur shembujt e suksesshëm që janë zbatuar në vende të tilla si Italia veriore dhe vende të tjera në Europë.

Masa e nënpërfaqësimit të grave është më e lartë në sektorin privat jobujqësor, ku vetëm 33.4% e punonjësve janë gra, ndërsa shifra në sektorin publik është 48% (INSTAT, 2014).

Shehaj dhe Adnett (2014) përdorin të dhënat për Matjen e Standardeve të Jetesës për të analizuar shkaqet e pjesëmarrjes së ulët të grave në forcën punëtore. Ata mendojnë se kjo dukuri lidhet me shkaqe të ndryshme. Pjesëmarrja e grave në forcën punëtore është më e lartë në familjet me karakteristikat e mëposhtme: familje që marrin të ardhura nga remitancat, kanë nivel më të lartë arsimor, dhe janë më të mëdha në numër. Pjesëmarrja e grave në forcën e punës është më e ulët në familjet më të pasura.

Për arsyet e mësipërme shkalla e papunësisë është parashikuar si më poshtë:

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për meshkujt dhe femrat për çdo moshë është mbajtur konstante gjatë të gjithë periudhës së parashikimit.

Shkalla e papunësisë për meshkujt nga 19.8 në vitin 2016 shkon në 8% në vitin 2025, 5% në vitin 2050 dhe më pas mbetet konstante deri në vitin 2075 (INSTAT, 2014).

Shkalla e papunësisë për femrat nga 14.7 në vitin 2016 shkon në 7.5% në vitin 2020, 5% në vitin 2050 (në këtë vit barazohet me shkallën e papunësisë për meshkuj) dhe më pas mbetet konstante ashtu si për meshkujt deri në vitin 2075 (INSTAT, 2014).

3. Supozimet për numrin e kontribuesve.

— Akses në punësim

Numri i kontribuesve në skemën është supozuar të rritet mjaft deri në vitin 2020 si rezultat i reformave të marra nga qeveria për uljen e informalitetit, duke përbërë në vitin 2018 rreth 79% të të punësuarve që duhet të sigurohen. Për vitet në vazhdim për shkak të përmirësimeve të ndryshme si strukturore dhe të rregullave për të ulur informalitetin do të çojnë kështu në vitin 2025 - 93% të të punësuarve dhe në vitin 2040 - 95%. Më poshtë paraqitet ritmi i rritjes së numrit të kontribuesve nga një vit në tjetrin.

Tabela 9 :Parashikimi i numurit të kontribuesve për modelin

	2015	2025	2040	2060
Numri i kontribuesve	668,614 ³²	768,000	880,000	970,000
Ritmi i rritjes së numrit të kontribuesve		15 % Krahasuar me 2015	15 % Krahasuar me 2025	11 % Krahasuar me 2040

Kontribuesit do të rritet vetëm si pasojë e rritjes së numrit të të punësuarve, pasi kjo përqindje mbahet pak a shumë konstante deri në vitin 2075. Këtu mund të marrim parasysh dhe lëvizjen e brendshme të popullsisë, si rezultat i ndryshimeve demografike për shkak të urbanizimit që pretendohet nga studimet e INSTAT.

³² http://ëëë.issh.gov.al/al/ëp-content/uploads/2014/02/Perb_12_15.pdf

4. Supozime lidhur me rritjen ekonomike

Shqipëria arriti ta shmangë recesionin gjatë gjithë periudhës së krizës ekonomike dhe financiare globale që preku shumë partnerë të saj tregtarë të BE-së dhe u ndie përmes hallkave të tregtisë, remitançave dhe investimeve. Sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme, ritmi i rritjes mesatare ekonomike nga viti 2009 deri në 2014 ra nën 2.0% deri në nivelin më të ulët prej 1,11% në vitin 2013, pas të cilit pati një përmirësim të ndjeshëm me një rritje prej 2.74% në vitin 2015 dhe një parashikim prej 3.2% në vitin 2016.

Tabela 10 :Parashikimet për treguesit kryesore ekonomik.

Teguesit\Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Inflacioni	3.56	3.45	2.04	1.94	1.63	1.9
Rritja ekonomike	3.71	2.55	1.42	1.11	2.02	2.74
Papunësisë mesatare	14.2	14.3	13.8	16.4	17.9	17.4
Norma e papunësisë	57.7	59.4	62.1	70.4	71.8	72.2

Burimi: Banka e Shqipërisë, 2016³³

Një rritje modeste në huadhënie gjatë 2016 dhe përshpejtimi i shpenzimeve në tremujorin e fundit ishin arsyt kryesore të kësaj rritjeje. Tradicionalisht, edhe migrimi i jashtëm i ka dhënë një shtysë të mëtejshme shpenzimeve, duke rritur konsumin e brendshëm. Kjo pasqyron migrimin në shkallë të gjerë në Greqi, Itali, dhe vende të tjera të Europës. Që nga viti 1990, rreth një e pesta e popullatës është larguar nga vendi dhe jeton jashtë shtetit. Migrimi ka qenë një faktor i rëndësishëm në përballimin e mungesës së vendeve të punës dhe mundësive të fitimit të jetesës në Shqipëri. Vlerësimet zyrtare tregojnë se remitancat janë burimi më i madh i valutës së huaj, me rreth 14% të PBB-së (Banka e Shqipërisë, 2015). Kjo rrjedhë ka stimuluar kërkesën e brendshme, sidomos në

³³ Raporti Vjetor 2015 Banka e Shqipërisë

veprimtaritë jo të tregtueshme, si ndërtimi dhe shërbimet, dhe ka plotësuar të ardhurat e pothuaj të gjithë banorëve të Shqipërisë.

Viti 2016 pati performancë të mirë në krahasim me vitet e mëparshëm. Nevoja për të financuar deficitin e buxhetit dhe pranimi i detyrimeve të prapambetura të akumuluar, të llogaritura në 5,3% e PBB-se, e ngritën nivelin e borxhit publik në 72,2% në fund të vitit 2015, nga 70,4% në vitin 2013. Si rezultat i dobësimit të ekonomisë, niveli i varfërisë u rrit dhe shkalla e papunësisë mbetet e lartë, me rreth 17.4% në vitin 2015.

Tregtia e jashtme ishte ende mjaft e mëdha në vitin 2016, çka pasqyron një bazë prodhuese të kufizuar, konkurrencë përgjithësisht të ulët të ekonomisë dhe një deficit të madh fiskal. Rritja modeste në eksporte mallrash në vitin 2016 (INSTAT, 2016) u ndikua nga një kërkesë e jashtme më të ulët, kryesisht për shkak të luhatjeve në çmimet e lëndëve djegëse, mineraleve, dhe energjisë elektrike në tregun ndërkombëtar. Në tremujorin e parë të vitit 2016 pati një nivel më të ulët eksportesh krahasuar me vitin 2015 (INSTAT, 2016), ndërsa importet pësuan një rritje të vogël. Remitancat u rritën me 10,6% në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015 (Banka e Shqipërisë, 2016), ndonëse vazhdonin të ishin mjaft më të ulëta krahasuar me vitin 2012.

Politika monetare e ndërmarre nga Banka e Shqipërisë ka qenë e matur dhe kursi i qëndrueshëm i shkëmbimit ka kontribuar në ruajtjen e një norme inflacioni të ulët. Konsolidimi fiskal vazhdoi të zinte vend të rëndësishëm në agjendën politike. Çekuilibrat fiskale kanë bërë që borxhi publik të arrijë nivelin 72,2% të PBB-se në fund të vitit 2015 dhe amortizatorët fiskalë tashmë kanë shteruar për shkak të parashikimeve të dobëta makroekonomike në të kaluarën, ndërsa detyrimet e mëdha të prapambetura qeveritare që janë akumuluar flasin për një dobësi të madhe në menaxhimin e financave publike dhe kanë minuar likuiditetin dhe besimin tek ekonomia.

Në Shqipëri, raportet e të ardhurave dhe shpenzimeve në lidhje me PBB-në (përkatësisht 26% dhe 31% në 2014) janë të ulëta në krahasim me standardet rajonale, po kështu edhe efienca tatimore. Barra e rregullimeve të nevojshme buxhetore kryesisht mbi të ardhurat, përfshirë reformat në politikat tatimore dhe forcimi i administratës tatimore dhe mbledhjes së taksave. Në vitin 2014 të ardhurat janë rritur, tashmë ato përbëjnë 26% të PBB-së. Përveç kësaj, shpenzimet arritën në 31% të PBB-së në vitin 2014. Megjithatë, efikasiteti i mbledhjes së taksave, shpesh i ndikuar nga ciklet e zgjedhjeve, mbetet ende i ulët. Në shkurt të vitit 2014, FMN-ja miratoi një Fond të Zgjeruar trevjeçar, prej 330,9 milionë euro, për të mbështetur një program të guximshëm për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, që synonte pagimin e detyrimeve, me vlerë 5,3% e PBB-së, nga 2014 deri 2016. Në fund të marsit 2015, Banka Botërore miratoi një Garanci të Bazuar te Politikat e Financave Publike për Shqipërinë, me një fond prej 220 milionë Dollare, që i ka mundësuar vendit të ketë qasje në kredi ndërkombëtare me kushte të favorshme dhe të pakësojë varësinë nga bankat e vendit për financimin e deficitit.

Kushtet me të cilat janë dhënë këto kredi nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare lidhen me përmirësime të rëndësishme në menaxhimin e financave publike për të shmangur rishfaqjen e detyrimeve të prapambetura; zgjidhjen e kredive të këqija dhe forcimin e mbikëqyrjes së sektorit financiar për të rigjallëruar dhënien e kredive, si dhe rreziqet buxhetore për financimin e importeve.

Sipas të dhënave të mësipërme dhe parashikimeve të mëposhtme të Bankës Botërore, parashikimi për treguesit makroekonomikë është paraqitur në tabelë.

Tabela 11 : Parashikimi i rritjes reale ne vendet e Europës dhe Azisë Qendrore.

Vendet\Vitet	2014	2015	2016	2017	2018	2019
	Estimates				Projections	
Albania	1.8	2.6	3.2	3.5	3.5	3.7
Armenia	3.6	3	2.4	2.7	3	3.2
Azerbaijan	2	1.1	-3	1.2	2.3	2.3
Belarus	1.7	-3.9	-2.5	-0.5	1.3	1.4
Bulgaria	1.3	3.6	3.5	3.2	3.1	3.1
Croatia	-0.4	1.6	2.7	2.5	2.5	2.6
Georgia	4.6	2.8	3.4	5.2	5.3	5
Hungary	4	3.1	2.1	2.6	2.8	2.7
Kazakhstan	4.2	1.2	0.9	2.2	3.7	4
Kosovo	1.2	4.1	3.6	3.9	3.7	3.6

*Burimi: World Bank, 2017***Tabela 12 :**Parashikimi i treguesve kryesore ekonomike për modelin.

	2015	2016	2020	2050	2075
Rritja GDP reale	2.74%	3.2%	3.7%	3.5%	3.0%
Rritja pagës reale	1.2%	2.7%	3.2%	2.3%	2.0%
Inflacioni	1.9%	2 %	2.0%	2.0%	2.0%

Në tabelën e mësipërme është supozuar si do të jetë rritja reale e GDP deri në vitin 2020 në përputhje me gjithë diskutimet e mësipërme dhe parashikimet që kanë bërë institucionet e ndryshme financiare si vendas dhe të huaj. Si dhe vazhdushmërinë e rritjes ekonomike deri në vitin 2075, duke mbajtur të njëjtën rritje ekonomike.

5. Supozimet lidhur me rritjen e pensioneve

Për pensionet e skemës urbane në vitet 2016 është vendosur shifrat reale të rritjes së masës së pensioneve. Për vitet 2017, siç është parashikuar në Projekt Buxhetin duke ruajtur përafërsisht vlerat e rritjes nominale të GDP. Pas vitit 2020 është supozuar se ritmet e rritjes së masës së pensioneve urbane do të fillojnë të bien linearisht deri në vitin 2040 e më pas ky ritëm do të ndjekë inflacionin (do të indeksohen pensionet duke rikuperuar vetëm inflacionin).

Ashtu si për pensionet e skemës urbane. Bazuar në strategjinë e barazimit të masës së pensionit të skemës rurale me masën e pensionit minimal të skemës urbane, rritjet e masës së pensionit rural do të jenë më të shpejta. Më pas, duke filluar nga viti 2020 e në vazhdim është supozuar që ritmet e rritjes së masës së pensioneve të skemës rurale do të jenë të njëjta si për pensionet e skemës urbane.

Indeksi i pensioneve të skemës urbane dhe rurale në periudhën parashikuese 2016 – 2075 do të jetë si më poshtë:

Tabela 13: Supozimet e rritjes së pensioneve për modelin.

Lloji i pensionit\Vitet	2017	2018	2020	2040	2075
Pensione urbane	2%	3%	2.5%	2%	2%
Pensione rurale	2%	6%	5%	2%	2%

6. Supozime lidhur me përqindjen e kontributit për pensione

Në skemën urbane përqindja e kontributit për pensione është ulur vazhdimisht deri në uljen e fundit në Shtator të vitit 2006 nga 29.9% në 21.6 % dhe më pas ajo mbetet e pandryshuar deri në vitin e fundit të parashikimit.

Në skemën rurale të vetëpunësuarit në bujqësi derdhen kontribut në masa të përcaktuara me VKM çdo vit (e ndryshme për zonat fushore e malore), masa të cilat janë shumë më

të vogla se kontributi që derdh një i vetëpunësuar në qytet. Është parashikuar që në vitin 2020 të vetpunësuarit në bujqësi ta paguajnë vetë te gjithë kontributin për pensione.

VII.2. Supozimet me sistem të reformuar duke futur dhe kolonën e dytë.

VII.2.1 Parimet e ndërtimi të kolonës së dytë

Ndërtimi i kolonës së dytë, duhet bërë mbi bazën e disa parimeve që eksperiencia botërore i shpjegon mjaft qartë.

- **Ajo duhet të jetë e detyrueshme.** Arsyeja për këtë është qëndrimi miop i individëve – një numër i konsiderueshëm njerëzish mund të jenë dritëshkurtër, dhe të mos mendojnë për pleqërinë e tyre duke u bërë kështu një barrë për shoqërinë kur të plaken.

- **Me kontribute të përcaktuara (DC).** Lidhja e ngushtë e përfitimeve me kontributet shmang evazionin kontributiv, sepse njerëzit nuk i konsiderojnë kontributet si taksa. Pensioni llogaritet në mënyrë aktuariale mbi bazën e moshës dhe akumulimeve të punonjësit, dhe kjo mund ta shtyjë daljen e parakohshme në pension dhe ta rrisë moshën e daljes në pension kur rritet jetëgjatësia.

- **Totalisht e kapitalizuar.** *Së pari*, kjo e bën koston të qartë që në fillim. *Së dyti*, kjo mënyrë eviton rritje të mëdha të kontributeve të domosdoshme në sistemet PAYG kur popullsia plaket. *Së treti*, kjo mënyrë parandalon transferimin ndërmjet brezave prej të rinjve tek të vjetrit. *Së katërti*, kapitalizimi shërben për të ngritur kursime kombëtare në terma afatgjatë.

- **E administruar në mënyrë private.** Kjo maksimizon faktin që objektivat ekonomike dhe jo ato politike përcaktojnë strategjinë e investimeve. Në këtë mënyrë administrimi privat do të zgjedhë alokimin më të mirë të kapitalit dhe fitimin më të lartë

mbi kursimet dhe gjithashtu ndihmon vendin në zhvillimin e tregjeve financiare. Fondet private zakonisht investojnë në një miks bono publike dhe të korporatave, equities dhe pasuri të patundshme, dhe kanë një shkallë të lartë fitimi. Ato mund të shfrytëzojnë edhe diversifikimin internacional, që bën të mundur interesa më të larta dhe risk më të reduktuar. Ato nxisin gjithashtu zhvillimin e tregut financiar, duke krijuar një kërkesë për instrumente dhe institucione të rinj financiare.

VII.2.2 Probleme që duhen marrë në konsideratë për të realizuar futjen e kolonës së dytë të pensioneve.

1-Menaxhimi dhe financimi i tranzicionit

Kalimi në sistemin e më shumë shtylla pothuajse gjithmonë kërkon burime shtesë.

- **Financimi i borxhit.** Premtimet e sistemit ekzistues PAYG janë si bono formale të qeverisë. Në teori, buxheti i çdo vendi reflekton jo vetëm borxhin e tij formal por edhe borxhin e tij implicit për pensionet PAYG dhe premtime të ngjashme. Qeveria mund ta financojë koston e tranzicionit duke marrë hua ose në vend ose jashtë, por edhe kjo ka kosto financiare.
- **Rritja e masës së kontributit për pensione.** Një vend mund të zgjedhë të financojë një pjesë ose të tërë koston e tranzicionit duke ngritur në total masën e kontributit por kjo ka pasur për pasojë rritjen e informalitetit në shumë vende, si rrjedhim kostoja e kolonës së dytë duhet të mbulohet brenda masës ekzistuese të kontributit.
- **Reduktimi i shpenzimeve në kolonën e parë.** Disa rregullime në nivelin e përfitimeve të kolonës së parë (shkalla e zëvendësimit, indeksimi, dhe mosha e daljes në pension) mund të jenë të nevojshme për ta sjellë atë në balancë, së bashku me shpresën për një rritje në pjesëmarrjen e forcave të punës. Këto rregullime duhen

bërë edhe nëse nuk ka kolonë të dytë. Efektivisht, një pjesë e barrës së tranzicionit mbahet nga pensionistët dhe punonjësit më të moshuar – zakonisht në formën e moshave më të mëdha të daljes në pension dhe një indeksim pensioni më pak xheneroz.

2-Probleme të tjera për t'u marrë në konsideratë

Problemet madhore që kanë dalë deri tani lidhen me kostot e larta administrative dhe shtrembërimet në tregun financiar për shkak të rregulloreve dhe kufizimeve për investime. Një fushë e tretë që ka nevojë për thellime të mëtejshme studimore është efekti i reformës së pensioneve mbi shpërndarjen dhe shtrirjen e kësaj shpërndarjeje.

3-Madhësia e kolonës së dytë

Madhësia e kolonës së dytë varet nga objektivat dhe përfitimet e pritura prej reformës së pensioneve, si dhe nga kufizimet ekonomike dhe institucionale për arritjen e këtyre objektivave. Kur fillohet të merret në shqyrtim futja e kolonës së dytë, ka nevojë të shpjegohen disa kufij fillestare për madhësinë e mundshme të ndonjë kolone të dytë midis të cilëve zgjedhjet mund të bëhen mbi bazën e analizës së mëtejshme ekonomike dhe eksperiencës ndërkombëtare. Në këtë kuptim, bazuar në çfarë ka ndodhur në shumicën e vendeve në terma të marrëveshjeve institucionale, nuk këshillohet një kolonë e dytë me më pak se 4-6% për shkak të kostos së saj efektive. Asetet që shkojnë në kolonën e dytë duhen investuar në bazë të sinjaleve të tregut nëse konvertimi në sistemin e kapitalizuar është për të kontribuar në rritjen ekonomike të ardhshme. Eksperienca sugjeron që analiza duhet të nisë me një kufi të sipërm për përqindjen e kontributit për kolonën e dytë në rangun 5-10% të pagës.

Një element tjetër që dikton madhësinë e kolonës së dytë – veçanërisht gjatë viteve të para pas futjes së saj – janë rregullat që do të adaptohen për njerëzit që do të mbulohet në mënyrë të detyrueshme, për ata që duhet të përjashtohen, dhe nxitjet e ofruara.

4-Mbledhja e kontributeve dhe Administrimi i tyre.

Dizenjimi i mbledhjes dhe clearinghouse. Clearinghouse mund të jetë një agjenci shtetërore që mbledh kontributet e kolonës së dytë, një mbajtës-rekordesh apo edhe një agjent mbajtës-rekordesh dhe informues ekskluziv për pjesëmarrësit e fondit. Propozohet që rolin e clearinghouse psh mund ta luajë Banka Shqipërisë.

Mbledhja e kontributeve është më e komplikuar në një sistem shumë kolonësh se sa në sistemin publik. Mbledhja, regjistrimi dhe transferimi i kontributeve në llogaritë individuale është problematik. *Disa reforma janë shtyrë vetëm për arsye të problemeve të mbledhjes së kontributeve.*

5-Lufta kundër evazionit

Evazoni i kontributeve të sigurimeve shoqërore nuk është çështje vetëm e faktit që punëdhënësit kërkojnë të reduktojnë koston e tyre të punës ose një preference e punëtorëve për konsumin korrent ose faktorë të tjerë. Skemat e sigurimeve shoqërore kërkojnë:

- të drejtën për inspektim të rekordeve të punëdhënësve dhe një akses të lirë në informacionin ndihmës si për shembull gjendja bankare e punëdhënësit, taksat e paguara.
- të drejtën për të vlerësuar dhe mbledhur detyrimet kontributive, ato të papaguara dhe vendosjen e gjobave në lidhje me borxhin e sigurimeve shoqërore duke pasur prioritet mbi kreditorët e tjerë.

- *procedura administrative të thjeshta*. Një numër unik rregjistrimi për çdo punëdhënës dhe çdo punëmarrës është i domosdoshëm.
- *detyrim efektiv për të paguar*. Kjo kërkon verifikime të shpeshta të fitimeve të punëdhënësit dhe realizimin e investigimeve për mospërputhje të mundshme. Duhet inspektore të trainuar mirë të shpërblyer në mënyrë adekuate në mënyrë që të sigurohet ndershmëria e tyre.
- *fushata informimi publik* për të inkurajuar zbatimin e ligjit. Një mënyrë që në disa vende ka nxitur zbatimin e ligjit është publiciteti (dhe persekutimi) i punëdhënësve për evazion (ose kërcënim për të bërë një gjë të tillë).

VII.2.3 Strukturat institucionale të nevojshme për të implementuar skemën private të pensioneve

Sistemi miks kërkon të përballesh edhe me sfiden e krijimit të industrisë së qendrueshme të pensioneve si dhe të organizmave rregullatore të kërkuar që do ta mbështesin. Kështu, disa institucione luajnë një rol kyç në funksionimin e sistemit. Këto mund të përfshijnë fondet private të pensioneve (FPP), kompanitë e menaxhimit të aseteve (KMA), bankat kujdestare (BK), dhe fondet shtetërore të akumulimit (FSHA). Ngritja e ktyre të fundit mund të kërkohej përkohësisht në një vend, ku eksperiencat e mëparshme me kompanitë rentiere e kanë friksuar popullatën në drejtim të investimit dhe depozitimit të parave të tyre në fondet private. Një strategji të tillë e shohim psh në Kazakistan³⁴.

³⁴ World Bank: Pension Reform and the Development of Pension Systems: An Evaluation of World Bank Assistance Background Paper. Kazakhstan Country Study . Edëard Palmer

- FFP themelohen si entitete/kompani private dhe mund të menaxhohen si fonde të hapura ose të mbyllura. Në rastin e skemave me mbledhje të decentralizuar të kontributeve FPP mund të kenë si funksion kryesor edhe mbledhjen e kontributeve dhe administrimin e llogarive të kontribuesve. Këto përgjegjësi përfshinë transferimin e kontributeve tek KMA, shpërndarjen e të ardhurave nga investimi në llogaritë individuale dhe llogaritja dhe pagesa e përfitimeve. Gjithashtu, FPP prodhojnë informacion për kontribuesit rreth vlerës totale të llogarive të tyre, vlerës njësi dhe fitimin nga investimi. Për më tepër, FPP janë përgjegjëse për vendosjen e rregullave për investimet për KMA.

- KMA janë entitete juridike të krijuara si kompani closed-end joint stock.
- BK duhet të jenë ekzekutuesit (kujdestare për çdo parregullsi, dhe kanë autoritet të pezullimit pa gjyq) e sistemit të reformuar të pensioneve për të siguruar që as FPP dhe as KMA nuk mund të bëjnë përdorim kriminal të aseteve në llogarite e kontribuesve të skemës.

- FSHA, themelohen nga qeveria, si kompani closed-end joint stock. Ministria e Finances gjeneron kaptalin fillestar. FSHA ka një bord drejtoresh që përbëhet kryesisht prej përfaqësuesve të qeverisë dhe të Bankës Qendrore.

VII.2.3.1 Strukturat rregullatore dhe administrative

Shembulli i Kazakistanit na ofron tre entitete qeveritare të cilat janë përgjegjëse për rregullimin e sistemit të pensioneve: 1) Mbikqyresit e FPP dhe KMA, 2) Komiteti për rregulloret e fondeve të pensioneve; dhe 3) Banka Qendrore që mbikqyr BK.

- Komisioni i siguriteteve kombëtare është përgjegjës për: (1) liçensimin dhe mbikqyrjen e KMA, (2) liçensimin dhe mbikqyrjen e BK (së bashku me Bankën Qendrore), dhe (3) rregullimin e aktivitetit të investimeve të FPP.
- Komiteti për rregulloret e fondeve të pensioneve është përgjegjës për: (1) liçensimin dhe mbikqyrjen e FPP, (2) aprovimin e praktikave të kontratave të pensioneve; (3) rregullimi i pagesës së përfitimeve, (4) sigurimi i konfidencialitetit të llogarive individuale të pensioneve, (5) ruajtja dhe vëzhgimi i transfertave ndërmjet fondeve, (6) rregullimi i veprimeve, llogaritjeve/kontabilitetit, riorganizimit, bashkimit dhe likuidimit të fondeve. Është gjithashtu përgjegjëse për kontrollin dhe mbikqyrjen e FSHA.
- Banka Qendrore (Banka Kombëtare) është përgjegjëse për liçensimin dhe rregullimin e BK.

Gjithashtu është edhe enti i sigurimeve shoqërore (në rastin tonë ISSH), që për eksperiencën e Kazakistanit i jep një rol të trefishtë: (1) llogaritja dhe pagesa e pensioneve PAYG, (2) sigurimi që popullsia aktive merr pjesë në sistem nëpërmjet dhënies së numrit të identifikimit unik, dhe (3) sigurimin që kontributet caktohen në mënyrë të saktë në fondet e zgjedhur nga kontribuesit.

VII.2.3.2 Përcaktimi i rolit të qeverisë para dhe pas ndërmarrjes së reformes.

Megjithatë çdo vend ka zgjedhur varinte të ndryshme mbi këtë temë, objektivat e politikës së përgjithshme janë të njëjta: tjetërsimi i riskut mes sistemit PAYG dhe atij të kapitalizuar, reduktimi i anomalive të shkaktuara nga skema PAYG dhe përfitimi nga anët positive të skemës së kapitalizuar si dhe ulja e borxhit të pensionit gjatë këtij procesi.

Në momentin kur perpilohet një skemë pensionesh, politikëbërësit kanë përpara një mori zgjedhjesh - por më parë duhen plotësuar disa kushte paraprake.

Në sektorin publik, si fillim, plani i pensioneve shtetërore duhet të jetë i pranueshëm nga pikëpamja fiskale. Kjo nuk do të thotë që shpenzimet publike për pensione duhet të minimizohen, por ato duhet të shkojnë paralel me rritjen e vazhdueshme të ekonomisë.

Së dyti, sistemet e pensioneve duhet të jenë politikisht të pranueshem. Reforma e pensioneve - si në sistemin PAYG edhe në atë të financuar - nuk është një ngjarje e izoluar në rrjedhën e kohës, por është një proces që kërkon mbështetjen e të gjithave niveleve të qeverisë.

Hapi i parë dhe me vendimtar në kryerjen e reformës së skemës së sigurimeve shoqërore është zgjidhja e politikës për mënyrën e kalimit nga kolona e parë e sistemit PAYG në sistemin shumëkolonësh të kapitalizuar. Në bazë të përvojës ndërkombëtare dy janë politikat e përdorura për kryerjen e reformës: Reforma me një hap dhe reforma me faza. Reforma *me një hap* udhëhiqet nga probleme normative dhe ka një kosto të lartë tranzicioni por nga ana tjetër kjo reforme duket e preferueshme meqë shpërndarja e kostove mund të arrihet nëpërmjet financimit të borxhit.

Në reformën *me faza* sistemi një kolonësh nuk do të zhduket menjëherë. Kalimi gradual kërkon që kolona e parë të ekzistojë paralelisht me kolonën e dytë.

Nëse me termin “*fazë*” do të kuptohej ngritja dhe përmirësimi gradual i performancës së institucioneve financiare, si dhe përshtatja e nevojshme legislative për dizenjimin e kolonës së dytë, atëhere kjo duhej të ishte një *fazë e ndërmjetme*. Referuar në praktikën e vendeve të tjera, të cilët e kanë përfunduar reformën në pensione, vërehet se faza e implementimit të kolonës së dytë kërkon një periudhë nga tre deri në pesë vite. Gjatë kësaj kohe, “stabilizohen” parametrat e kolonës së parë.

Një çështje lidhur me projektimin e kolonës së dytë është roli i qeverisë si garant. Garancite e qeverisë duhen konsideruar me kujdes dhe duhet t'u drejtohen personave më të pambrojtur, sic janë punëmarrësit me të ardhura të pakta.

Në sistemin e ngritur shumëkolonësh dy janë rolet kryesore të qeverisë: *mbledhja e kontributeve (nese politike-bërësit vendosin për një sistem të centralizuar të mbledhjes së kontributeve) dhe mbikqyrja.*

VII.2.3.3 Mbikqyrja e qeverisë për fondet private

Autoriteti i mbikqyrjes. Ky duhet të ketë rregullore të qarta dhe fuqi vepruese, me autoritetin e vënies së gjobave dhe madje heqje liçence nëse rrethanat e justifikojnë një gjë të tillë. Stafi i autoritetit duhet të jetë shumë i trainuar, me paga konkurruese për të evituar largimin e tyre në tregun privat. Autoriteti duhet të ketë një buxhet adekuat, me qëllim që të operojë pa ndërhyrje dhe të ketë burimet e nevojshme fizike dhe teknike. Më e rëndësishmja, autoriteti duhet të jetë politikisht i pavarur, për të evituar ndërhyrjet në aktivitetet e tij.

Këto janë fushat kryesore të mbikqyrjes që duhen mbuluar:

- E para është përgjegjësia për kontrollin institucional, përfshi aktivitetet e liçensimit, marketingut dhe reklames, transparenca e informacionit nga fondet e pensioneve, vlerësimi i performances dhe inspektimet ne vend.
- E dyta është përgjegjësia për aktivitete financiare, përfshi proceset e mbledhjes, kujdestarinë, vlerësimin e aseteve, llogaritjen e interesit, limitin e investimeve dhe, nëse ka, interesin minimum të garantuar. Kjo fushë e përgjegjësisë kërkon mbledhjen e informacionit nga menaxheret e fondeve të pensioneve, kujdestareve dhe tregut, dhe kryqëzimi i këtyre burimeve në mënyrë të vazhdueshme.

- E treta është përgjegjësia për rregullimin dhe monitorimin e çeshtjeve të pjesëmarrjes gjatë periudhës së akumulimit – dmth, procesin e bërjes anëtar i një fondi pensionesh dhe lëvizja në një tjetër dhe mënyra se si fondet e pensioneve komunikojnë me anëtarët e tyre. Vitale në këtë fushë përgjegjësie është ruajta e një departamenti të fuqishëm të ankesave, të aftë për marrjen, përpunimin dhe zgjidhjen e ankesave të punonjësve kundrejt menaxherve të fondeve të pensioneve.

- E katërta është përgjegjësia për pagesen e përfitimeve. Kjo përfshin procedura për të marrë përfitime (shuma të menjëhershme, terheqje të programuara ose annuity). Kjo fushë përgjegjësie duhet koncentruar në procedurat për të marrë përfitime, rregullat e annuity dhe mbikqyrje e vazhdueshme e pageses së përfitimeve.

- E pesta është ajo për analizën dhe planifikimin. Ky funksion duhet të jetë përgjegjës për planin strategjik në agjencinë e mbikqyrjes, përgatitja dhe publikimi i raporteve statistikore dhe studimeve mbi evoluimin e sistemit, dhe zhvillimin e rregulloreve të reja.

VII.2.3.4 Reformat paralele të nevojshme për të siguruar suksesin e skemës shumekolonëshe

- Shumë vende që kanë ndërmarrë reformën në fushën e sigurimeve shoqërore nuk kanë stabilizuar një infrastrukturë të sektorit bankar apo të tregut të aksioneve, gjë që është vendimtare për suksesin e institucioneve të kursimeve private sic janë fondet e përbashkëta, kompanitë e sigurimit apo fondet e pensionit.

- Gjithashtu aparati i mbledhjes së taksave mund të luajë një rol të rëndësishëm në mbledhjen e kontributeve për kolonën e dytë. Për këtë arsye në mjaft vende administrimi i taksave po i nënshtrohet një ndryshimi rrënjësor.

- Nga ekspertë të fushës së sigurimeve është e këshillueshme që qeveria të ngrejë një njësi të pavaruar me ekspertët më të mirë të fushës për reformën e pensioneve, të mbrojtura nga influencat politike apo rutina e veprimtarisë së menaxhimit, që të mund të përqëndrohet në detyra profesionale.

- Reformat në sistemin ekzistues PAYG, ose kolonës së parë.

- Për t'u vlerësuar në sektorin e marrëdhënieve me publikun është çështja e transparencës së reformës. Në shumë raste masa e kontribuesve ka mbështetur reformën e pensioneve nëse i është bërë e ditur se: a) përfitimet dhe kontributet janë të lidhura ngushtë, kështu që përfitimet pasqyrojnë kontributet e kryera; b) roli i sektorit privat në sigurimin e pensioneve duhet rritur, përkundrejt institucioneve të gjithëpushtetshëm të sigurimeve shoqërore. Kontribuesit duhen informuar rregullisht, dhe tërheqja e vëmendjes së publikut ndaj ndryshimeve ekonomike, demografike dhe financiare lehtëson procesin e reformave.

VII.2.4 Përcaktimet ligjore për implementimin e skemës private të pensioneve.

Masat paraprake, të cilat bëjnë të mundur fillimin e reformës në sistemin e pensioneve janë:

- Hartimi i bazës ligjore për funksionimin e kolonës së dytë.
- Përcaktimi i kriterëve për fondet private
- Politikat fillestare favorizuese për profesionet e vështira.

Rezultatet që janë shfaqur tashmë nga zbatimi i legjislacionit ekzistues, si dhe nga të gjithë ato faktorë që u përmendën në pjesët e mëparshme të këtij raporti, por të shoqëruara edhe nga fenomene të tilla të pashmangshme, si plakja e popullsisë dhe

emigracioni intensiv e bëjnë të ardhmen e pensioneve të brezave aktualë shumë të rrezikshme.

Hapësirat që krijon legjislacioni aktual për organizimin e fondeve private, e bëjnë thuajse të pamundur arritjen e një rezultati inkurajues në sistemin e pensioneve për një periudhë relativisht të gjatë kohore. Në këto kushte, do të konsiderohej si një nevojë e menjëhershme përshtatja e legjislacionit për këto institucione financiare në të njëjtat raporte me evoluimin e zhvillimeve financiare ekzistuese dhe të pritshme.

Si hapa të nevojshëm për fillimin e një reforme në sistemin e pensioneve, mund të përmenden:

- Miratimi i akteve fillestare rregullatore, krijimi i kolonës së dytë dhe stimulimi i asaj të tretë të sistemit të fondeve të pensioneve - miratimi i VPS (sistemi vullnetar suplementar) dhe OSS (sistemi i detyrueshem suplementar), të cilat duhet të tentojnë gjithashtu, të japin ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e edukatës së sigurimit.

- Miratimi i një ligji të ri – **Kodi i Sigurimeve**, si dhe rikonceptimi i funksioneve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (jobankare) të cilat do të merren me administrimin e fondeve të pensioneve, të instituteve të sigurimit, si dhe **të sigurimit shëndetësor**, duke u bërë iniciues dhe udhëheqës i reformës së sistemit të pensioneve.

Këto hapa shoqërohen me një bashkëpunim institucional brenda sistemit pensional, ku do të përfshihen jo vetëm kompanitë e mëdha të fondeve të pensioneve, por edhe institucione të tjera financiare si Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave (strukturat e posaçme) së bashku me shërbimet tatimore e doganore, madje edhe institucionet e sistemit bankar privat.

VII.3 Supozimet i modeleve për shtyllën e dytë.

Supozimet do të bëhen duke futur dhe kolonën e dytë të pensioneve përkrah skemës aktuale egzistuese në tre variantet e mëposhtëme. Treguesit e tjerë për supozime do mbahen si në optionin optimist për reformimim e skemës egzistuese.

Një sistem i tillë nënkupton ekzistencën e një shtyllë të parë shtetërore dhe të një shtyllë të dytë, të detyrueshme dhe private. Përkrah këtyre dy shtyllave ekziston edhe një shtyllë e tretë mbi baza vullnetare e cila tashme egziston në shqipëri. Në këtë skenar popullsia ndahet në dy grupe në bazë të një moshe, mbi të cilën popullsia do të vazhdojë të kontribuojë në shtyllën e parë dhe nën të cilën popullsia që do të kontribuojë në shtyllën e dytë.

Alternativat për sistemin shumë-shtyllësh të pensioneve janë të ndryshme. Por ne po supozojme tre variantet:

1. **Shtylla e dytë është e plotë.** Shtylla e parë nuk vazhdon më të funksionojë përtej gjeneratës së fundit që është pjesë e saj, dhe i gjithë kontributi paguhet i plotë në shtyllën e dytë. Fillimisht është zgjedhur një moshë e caktuar si për meshkuj edhe për femrat dhe është supozuar që popullsia mbi këtë moshë do të jetë pjesë e kolonës së parë PAYG, ndërsa popullsia nën këtë moshë do të jetë pjesë e kolonës së dytë.

2. **Shtylla e dytë me një kontribut të pjesshëm.** Shtylla e parë vazhdon të funksionojë përkrah saj do të ndërtohet një shtyllë e dytë. Fillimisht është zgjedhur një moshë e caktuar si për meshkuj edhe për femrat dhe është supozuar që popullsia mbi këtë moshë do të jetë pjesë e kolonës së parë PAYG, ndërsa popullsia nën këtë moshë do të jetë pjesë e të dy kolonave, një pjesë e kontributeve do të shkojnë në kolonën e parë dhe pjesa tjetër në kolonën e dytë. Për grupmoshën nën 35 vjeç kontributi për pension shkon një pjesë në shtyllën e parë dhe një pjesë (në parshikim është marrë përqindjet 10%) për shtyllën e dytë.

3. **Shtylla e dytë me një kontribut të pjesshëm.** Shtylla e parë vazhdon të funksionojë përkrah saj do të ndërtohet një shtyllë e dytë. Fillimisht është zgjedhur një moshë e caktuar si për meshkuj edhe për femrat dhe është supozuar që popullsia mbi këtë moshë do të jetë pjesë e kolonës së parë PAYG, ndërsa popullsia nën këtë moshë do të jetë pjesë e të dy kolonave, një pjesë e kontributeve do të shkojnë në kolonën e parë dhe pjesa tjetër në kolonën e dytë. Për grupmoshen nën 35 vjeç kontributi për pension shkon një pjesë në shtyllën e parë dhe një pjesë (në parashikim është marrë përqindjet 5%) për shtyllën e dytë.

— Shtylla e dytë është e plotë

Shtylla e parë nuk vazhdon më të funksionojë përtej gjeneratës së fundit që është pjesë e saj, dhe i gjithë kontributi paguhet i plotë në shtyllën e dytë.

Moshat dhe përqindjet e kontributit sipas variantit të sipërpërmendura janë si më poshtë:

Tabela 14: Supozime për kolonën e dytë të plotë.

Opsioni	Shtylla 1	Shtylla 2	Punëmarrësi	Punëdhënësi	Pensioni
mbi 35 vjeç	21.6 %		8.6%	13%	Llogaritja sipas skemes aktuale
nën 35 vjeç		21.6 %	8.6%	13%	Pension privat

Viti bazë.....2015

Viti i fillimit të kolonës së dytë..... 2018

Viti i fundit i parashikimit..... 2075

Është zgjedhur mosha 35 vjeç si për meshkuj edhe për femrat dhe është supozuar që popullsia mbi moshën 35 do të jetë pjesë e kolonës së parë PAYG, ndërsa popullsia nën moshën 35 do të zhvendoset e gjitha në kolonën e dytë. Gjithashtu është supozuar që të

gjithë kontribuesit e rinj që hyjnë në skemë, pavarësisht nga mosha të jenë pjesë e kolonës së dytë.

Për persona që bëhen pjesë e kolonës së dytë do të njihen të gjitha të drejtat e fituara nga skema e mëparshme. Përfitimet në këtë rast përcaktohen proporcionalisht me të drejtat e akumuluar në kolonën PAYG.

Në këtë rast, kur një pjesë e kontribuesve zhvendosen nga kolona e parë në të dytën edhe kontributi i tyre shkon nga kolona e parë në të dytën.

Pjesa e kontributit që shkon për shpenzime administrative në kolonën e dytë është parashikuar të jetë 5% e totalit të kontributeve që derdhen në këtë kolonë në vitin e parë të futjes së kolonës së dytë dhe më pas ulet linearisht deri në 3% në vitin e fundit të parashikimit, ndërsa pjesa që shkon për përfitime të tjera (përveç atyre të pleqërisë) do të përbëjë rreth 6% të totalit të kontributeve.

Interesi real i fituar nga llogaritë individuale është parashikuar të jetë 4%.

Të gjitha supozimet e bëra për kolonën e dytë janë të njëjta si për modelin urban ashtu edhe për atë rural.

— Shtylla e dytë është e pjesshme dhe përkraj saj vazhdon të funksionojë edhe shtylla e parë

Mosha dhe përqindja e kontributit sipas variantit do të jenë si më poshtë:

Tabela 15: Supozime për kolonën e dytë të pjesëshme 10%.

Opsioni	Shtylla 1	Shtylla 2	Punëmarrësi	Punëdhënësi	Pensioni
mbi 35 vjeç	21.6 %		8.6%	13%	Llogaritur me formulë
nën 35 vjeç	11.6%	10%	3.6% 5%	8% 5%	Pension nga PAYG + pension nga kolona e dytë

Kontributi për pension shkon një pjesë në shtyllën e parë dhe një pjesë në skenar janë marrë përqindjet 10 për shtyllën e dytë.

Viti bazë.....2015

Viti i fillimit të kolonës së dytë..... 2018

Viti i fundit i parashikimit..... 2075

Për modelimin e këtij skenari, fillimisht është zgjedhur një moshë e caktuar si për meshkuj edhe për femrat dhe është supozuar që popullsia mbi këtë moshë do të jetë pjesë e kolonës së parë PAYG të reformuar, ndërsa popullsia nën këtë moshë do të jetë pjesë e të dy kolonave, një pjesë e kontributeve do të shkojnë në kolonën e parë dhe pjesa tjetër në kolonën e dytë.

Gjithashtu, është supozuar që të gjithë kontribuesit e rinj që hyjnë në skemë do të kenë statusin e popullsisë kontribuese nën këtë moshë të caktuar, pra do të jenë pjesë e të dy kolonave.

— Shtylla e dytë është e pjesshme dhe përkrah saj vazhdon të funksionojë edhe shtylla e parë

Mosha dhe përqindja e kontributit sipas variantit do të jenë si më poshtë:

Tabela 16: Supozime për kolonën e dytë të pjesëshme 5 %.

Opsioni	Shtylla 1	Shtylla 2	Punëmarrësi	Punëdhënësi	Pensioni
mbi 35 vjeç	21.6 %		8.6%	13%	Llogaritur me formulë
nën 35 vjeç	18.9%	5%	6.1% 2.5%	10.5% 2.5%	Pension nga PAYG + pension nga kolona e dytë

Kontributi për pension shkon një pjesë në shtyllën e parë dhe një pjesë në skenar janë marrë përqindjet 5 për shtyllën e dytë.

Viti bazë.....2015

Viti i fillimit të kolonës së dytë..... 2018

Viti i fundit i parashikimit..... 2075

Për modelimin e këtij skenari, fillimisht është zgjedhur një moshë e caktuar si për meshkuj edhe për femrat dhe është supozuar që popullsia mbi këtë moshë do të jetë pjesë e kolonës së parë PAYG të reformuar, ndërsa popullsia nën këtë moshë do të jetë pjesë e të dy kolonave, një pjesë e kontributeve do të shkojnë në kolonën e parë dhe pjesa tjetër në kolonën e dytë.

Gjithashtu, është supozuar që të gjithë kontribuesit e rinj që hyjnë në skemë do të kenë statusin e popullsisë kontribuese nën këtë moshë të caktuar, pra do të jenë pjesë e të dy kolonave.

KAPITULLI VIII → REZULTATET E PARASHIKIMIT


VIII. 1. Rezultatet e parashikimit të sistemit bazë (egzistues).

VIII. 1.1. Parashikimet për popullsinë.

Duke analizuar të dhënat e popullsisë sipas moshave për të gjithë periudhën e parashikimit deri në vitin 2075, vihet re një plakje e popullsisë shqiptare në të ardhmen afatgjatë, e cila reflektohet në:

— një rritje të pjesës së popullsisë mbi moshën e pensionit ndaj totalit të popullsisë; ky tregues fillon të rritet nga viti 2015 deri në fund të perjudhës së parashikimit, pjesa e popullsisë mbi moshën e pensionit ndaj totalit të popullsisë rritet gradualisht duke aritur vlerën më të madhe në fund të vitit të parashikimit si në grafikun e mëposhtëm:


Grafiku 1 : Popullsia sipas grupmoshave.



Siç duket edhe nga grafiku, rritja e pjesës që zë popullsia mbi moshën e pensionit ndaj totalit të popullsisë, shoqërohet me uljen e pjesës që zë popullsia nga mosha 15 vjeç deri në moshën e pensionit ndaj totalit të popullsisë dhe gjithashtu me uljen e pjesës që zë popullsia nën moshën 15 vjeç ndaj totalit të popullsisë.

— **një rritje të koeficientit të varësisë së të moshuarve**, i cili merr vlerat më të vogël në vitin bazë, më pas rritet deri në vitin 2075 ku merr vlerën më të lartë. Ky tregues merr vlerën gati 70% në vitin e fundit të parashikimit 2075, si në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 2 :Koeficienti i të varësisë së të moshuarve.




Këto fenomene demografike të cilat dëshmojnë për një plakje të popullsisë shqiptare në perspektivën afatgjatë, shoqërohen edhe me ndryshime në treguesit e skemës së sigurimeve shoqërore.

— **norma e varësisë së sistemit (NVS).** Norma e varësisë së sistemit fillon të rritet gradualisht si rezultat i rritjes së numrit të pensionistëve me ritme me të shpejta dhe në 30 vitet e ardhshme, përkeqësohet në mënyrë graduale. NVS peson një rënje të vogël në fillim për shkak të rritjes së numrit të kontribuesve në vitet e para për shkak se parashikohet që ekonomia të formalizohet dhe të shtohen kontribuesit në vitet e para, më pas pas stabilizimit të tyre NVS fillon të rritet deri në fund të perjudhës së parashikimit.

Rritja e normës së varësisë së sistemit tregon që do të ketë më shumë pensionistë për çdo kontribues (pjesë e popullsisë në moshë pune që mbështet të parët).


Grafiku 3 : Norma e varësisë së sistemit.



— **numri i pensionistëve ndaj numrit total të popullsisë** ecën në të njëjtin kah me normën e varësisë së sistemit. Ky numër do të rritet me ritme më të shpejta nga viti

2015 deri rreth vitit 2040. Duhet theksuar se ky raport arrin nivelin rreth vitit 2040 dhe më pas vazhdon të rritet përsëri. Pas viteve 2050 ky raport parashikohet që të ketë ritme rritje më të vogla si rezultat i uljes së ritmit të rritjes së numrit të pensionistëve që reflekton uljen e ritmit të rritjes së numrit të kontribuesve.


Grafiku 4 : Numri i pensionistëve ndaj numrit total të popullsisë.



— **shkalla e mbulimit të të punësuarve**, e cila përfaqësohet nga raporti kontribues mbi të punësuarit shënon rritje gjatë periudhës së parashikimit. Ritmi i rritjes së këtij treguesi (siç shihet edhe në grafikun e mëposhtëm) është i madh gjatë viteve 2015 – 2040; kjo vjen si rezultat i rritjes më të shpejtë të numrit të kontribuesve gjatë kësaj periudhe; kështu shkalla e mbulimit nga 50.3% shkon në 68.6% në vitin 2040 dhe më pas, ritmi i rritjes është më i ngadaltë deri në vitet 2075, kjo si rezultat i rritjes me ritme


më të ngadalta të numrit të kontribuesve. Më pas ky tregues mbetet pak a shumë konstant rreth vlerave 64 % deri në vitin e fundit të periudhës së parashikimit.

Grafiku 5 : Norma e varësise së sistemit.



— **Shkalla e zëvendësimit** (Është një tregues sintetik i rezultatit). Shkalla e zëvendësimit për skemën pëson një rritje të vogël deri tek viti 2019 si pasojë e efekteve mos rritjes të pagës mesatare parashikuar deri tek viti 2019 dhe si rezultat i rritjes së masës së pensionit siç është përshkruar tek supozimet. Më pas, ulja e ritmit të rritjes së masës së pensionit, (rritja e pensioneve pas vitit 2019 ndjek inflacionin) dhe rritja e pagës mesatare me ritme më të shpejta se masa e pensionit sjell një ulje të shkallës së zëvendësimit, siç tregohet në grafikun e mëposhtëm: (paga mesatare ndjek ritmet e rritjes së pjesës intensive të GDP dhe ndërsa pensionet ekzistuese llogariten mbi pagat mbi të cilat janë derdhur kontributet në vitet e mëparshme, shkalla e zëvendësimit llogaritet duke pjesëtuar pensionin aktual me pagën mesatare aktuale).

Grafiku 6 :Shkalla e zëvendësimit të sistemit.



Ky tregues ulët gradualisht duke marrë vlerat rreth 25 - 26% në vitin e fundit të periudhës së parashikimit. Në këtë rast, në vitin 2075 pensioni zëvendëson vetëm rreth 26.2% të pagës mesatare të parashikuar për atë vit, vlerë kjo që është shumë larg kërkesave të ILO për sigurimet shoqërore, për një lidhje midis masës së pensionit minimal dhe pagës minimale kontributive, e cila është 70%.

Të gjithë këta tregues na japin një pamje të qartë për përkeqësimin e situatës së skemës së pensioneve. Rritja e numurit të pensionistëve është me ritme më të larta se rritja e kontribuesve në skeme. Gjithashtu ritmet e kontribuesve përveç viteve të para si shkak i formalizimit, do të vazhdojë të ulët nga ulja e numurit të vogël të lindjeve që aktualisht

kemi, e cila do të pasqyrohet tek fuqia puntotore në të ardhmen dhe njëkohësisht tek numuri më i vogël i kontribuesve.

VIII. 1.2. Parashikimet e rezultatit financiar.


Në **totalin e të ardhurave** janë përfshirë kontributet e paguara nga kontribuesit, të cilët përfitojnë një pagë nga puna si dhe gjithë llojet e kontributeve që derdhen në skemë.

Në **totalin e shpenzimeve** janë përfshirë shpenzimet për pensionet e pleqërisë.

Balanca është diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të ardhurat dhe shpenzimet e skemës në tërësi për të gjithë periudhën e parashikimit, paraqiten grafikisht si vijon:

Grafiku 7 :Të ardhurat dhe shpenzimet.




Rritja e masës së pensionit sipas inflacionit, siç e theksuam më sipër dhe ritmet më të ngadalta e rritjes së pagës kontributive, sjell rritjen me ritme më të shpejta të të shpenzimeve krahasuar me të ardhurat dhe si pasojë një balancë negative për skemën, e

cila sa vjen e rritet. Por nga ana tjetër, rritja e masës së pensionit sipas inflacionit ul shumë shkallën e zëvendësimit dhe si pasojë ul të ardhurat e pensionistëve krahasuar me pagën mesatare kontributive.

Ndryshe do të ishte në qoftë se do të përpiqeshim të ruanim shkallën e zëvendësimit (të ardhurat e pensionistëve krahasuar me pagën mesatare kontributive të mbeten në të njëjtin raport). Në këtë rast, paga dhe pensioni do të rriten me të njëjtat ritme dhe kjo do të sjellë një situatë akoma më të keqe financiare.

Një paraqitje grafike e balancës së skemës ndaj GDP nominale jepet në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 8 :Balanca e sistemit ndaj GDP nominale .



Në vitet e para balanca e skemës ndaj GDP ulet si rezultat i uljes së normës së rritjes së pensioni sipas inflacionit për pensione dhe më pas rreth vitit 2027 fillon të rritet. Kjo rritje do të jetë si rezultat i rritjes së përfitimit për pensionistet e rinj me formulën e re të

pensionit. Rritja do të vazhdojë me ritme më të shpejta duke arritur kulmin në vitin e fundit të periudhës së parashikimit.

VIII. 2. Rezultatet e parashikimit të sistemit me kolonë të dytë të plotë.

Kalimi i një pjese të kontribuesve të skemës PAYG në kolonën e dytë do të thotë më pak kontribute për kolonën e parë. Në vitin e parë të futjes së kolonës së dytë të ardhurat e skemës PAYG zvogëlohen me 21.6%, ndërkohë që fondi që duhet për të përballuar pagesat e pensioneve nuk ndryshon. Në kolonën e parë tashmë ka më pak kontribues që duhet të mbështesin po ato pensionistë. Duke patur parasysh gjithashtu që kontribuesit e rinj që i bashkohen skemës së pensioneve do të jenë pjesë e kolonës së dytë, numri i kontribuesve në këtë skemë do të fillojë të ulet, ndërkohë që kontributi i tyre bëhet gjithmonë e më shumë i pamjaftueshëm për të përballuar pagesat e pensionistëve aktuale dhe të pjesëmarrësve të skemës, të cilët momentalisht janë kontribues por do të jenë përfitues kur të kenë plotësuar kushtet për pension.


Më poshtë paraqiten grafikisht të ardhurat e skemës PAYG optimiste para dhe pas futjes së kolonës së dytë të plotë

Kontribuesi më i ri në moshë që mbetet në kolonën e parë, në vitin 2018 është 36 vjeç. Atij do t'i duhet të kontribojë në skemë edhe për 31 vjet të tjera deri sa të arrijë moshën për të dalë në pension. Kështu deri në vitin 2049 do të kemi persona që derdhin kontribute në këtë skemë. Më pas do të ketë vetëm përfitues. Kështu, skema PAYG do të vazhdojë të paguajë përfitime personave që kanë qenë pjesë e saj deri rreth viteve 2065 – 2067.

Nga ana tjetër, personat që kanë kontribuar për ca kohë në skemën PAYG dhe në vitin 2018 duke qenë nën moshën 35 vjeç kalojnë në kolonën e dytë, kanë disa të drejta të


fituara në këtë skemë, bazuar në kontributet që ata kanë paguar kur kanë qenë pjesë e kësaj skeme.

Grafiku 9: Te ardhurat e sistemit PAYG kur futet kolona e dyte e plote.




Kështu shpenzimet për pensione pleqërie në skemën PAYG përbëhen nga shpenzimet për të paguar përfitimet e personave që janë pjesë e saj dhe shpenzime për të paguar të drejtat e fituara nga kjo skemë, të personave që tashmë janë pjesë e kolonës së dytë. Këto shpenzime, të ndara sipas llojit të përfituesve janë paraqitur më poshtë grafikisht:

Grafiku 10 :Shpenzimet e sistemit PAYG kur futet kolona e dyte.




Duke i parë në kompleks të ardhurat dhe shpenzimet e kësaj skeme, situata financiare e kësaj skeme paraqitet si më poshtë:

Grafiku 11 : Balanca e skemes PAYG me kolone te dyte te plote.



Balanca fillon të marrë vlera gjithnjë e më të ulta deri në vitin 2052, dhe më pas fillon të rritet por duke mbetur negative gjatë të gjithë periudhës. **Ndërkohë që totali i shpenzimeve vjen duke u rritur deri në vitin 2052 dhe më pas pëson ulje deri në vitin e fundit të parashikimit. Përsa i përket totalit të të ardhurave, ai vjen duke u ulur deri në vitin 2049 dhe më pas nuk pëson ndryshim në vlerën e tij.**


Duke e parë situatën financiare në skemën PAYG në raport me GDP, tabloja do të paraqitet si më poshtë.

Grafiku 12 : Balanca e skemës PAYG me kolonë të dytë të plotë ndaj GDP.

Një situatë krejtësisht të ndryshme financiare vemë re në kolonën e dytë. Në fillim të periudhës, pjesëmarrësit e vetëm në këtë kolonë janë kontribuesit (të cilët në vitin 2018 ishin deri në moshën 35) dhe më pas në të do të bëhen pjesë edhe të gjithë kontribuesit e rinj që do të hyjnë në skemë çdo vit. Fillimisht do të ketë vetëm kontribute dhe shumë pak shpenzime. Kontribuesit e rinj, që është supozuar të futen në skemë, sidomos në periudhën 20018 - 2020, si rezultat i uljes së informalitetit do të jenë edhe në mosha të larta, të cilët shumë shpejt do të plotësojnë kushtet për pension pleqërie, por sigurisht këta janë të paktë. Ndërkohë, në këtë kolonë do të fillojnë të paguhet edhe pensione invaliditeti apo familjare dhe sigurisht do të ketë edhe shpenzime administrative. Megjithatë siç duket edhe grafikisht, shpenzimet në vitet e para të periudhës së parashikimit do të jenë të pakta, balanca do të jetë shumë pozitive duke sjellë një situatë

financiare të favorshme dhe krijuar mundësinë e investimit të një pjese të madhe të të ardhurave.

Grafiku 13 :Te Ardhurat e kolones se dyte.




Shihet një rritje e ndjeshme e shpenzimeve rreth viteve 2040 – 2050, periudhë në të cilën kontribuesit që në vitin 2018 ishin nën moshën 35 vjeç plotësojnë kushtet për përfitim pleqërie.

Pikërisht në këtë periudhë fillon të rritet edhe shkalla e zëvendësimit e përfituesve nga kolona e dytë, pasi deri në këtë moment numri i përfituesve nuk është shumë i madh dhe për shkak të periudhës së shkurtër që ata derdhin kontribut në kolonën e dytë, shkalla e zëvendësimit nga kjo kolonë është e vogël. Shkalla e zëvendësimit të përfituesve të kolonës së dytë është e barabartë me shumën e shkallës së zëvendësimit të të ardhurave që personi merr nga të drejtat e fituara në skemën PAYG me shkallën e zëvendësimit të të ardhurave që personi merr në kolonën e dytë.


Më poshtë, për ilustrim paraqitet grafikisht numrin e kontribueseve

Grafiku 14 :Numri i kontibuesve sipas skemave.




Më poshtë, për ilustrim paraqitet grafikisht numrin e pensionistëve

Grafiku 15 : Numri i pensionistëve sipas skemave.



Më poshtë, për ilustrim paraqitet grafikisht shkalla e zëvendësimit, kur ata janë pjesë e skemës PAYG të variantit bazë dhe kur janë pjesë e kolonës së dytë të plotë.

Grafiku 16 :Shkalla e zëvendësimit sipas kolonave.




Shkalla e zëvendësimit, kur ata janë pjesë e skemës PAYG të variantit bazë pëson rënie në vlerat e saj nga viti 2020 dhe deri në fund të periudhës së parashikimit. Ndërkohë që shkalla zëvendësimit, e kolonës së dytë pëson rritje me ritme më të ngadalta deri në vitin 2048 dhe më pas vlerat e saj karakterizohen nga një rritja me ritme më të shpejtë deri rreth vitit 2068. Më pas deri vlerat e saj fillojnë të pësojnë ulje.

VIII. 3. Rezultatet e parashikimit të sistemit me kolonë të dytë të pjesshme 10%.

Pas dizenjimit të këtij skenari, rezultatet u krahasuan me rezultatet e opsionit të mësipërm.


Të ardhurat në skemën PAYG në vitin 2018 janë të mëdha në këtë opsion krahasuar me të parin, sepse të ardhurat në varianti me skemë të plotë fillojnë të bien pasi kontribuesit në këtë skemë fillojnë e reduktohen derisa arrijnë në zero, ndërsa në variantin në fjalë, të ardhurat fillojnë e rriten, pasi numri i kontribuesve do të vazhdojë të rritet. Të gjithë kontribuesit e rinj që hyjnë në skemë (hyjnë për herë të parë apo për shkak të uljes së informalitetit) do të jenë pjesë e të dy kolonave, do të jenë kontribues edhe për skemën PAYG dhe për kolonën e dytë. Por duke patur parasysh që në këtë rast norma e kontributit për skemën PAYG është më e vogël nga 21.6% në 11.6%, edhe të ardhurat e këtij varianti do të jenë më të ulta. Më poshtë, për ilustrim paraqitet grafikisht numrin e kontribueseve sipas skemave.

Grafiku 17: Nr kontribuesve sipas skemave.




Më poshtë, për ilustrim paraqitet grafikisht numurin e pensionisteve sipas skemave.

Grafiku 18: Nr pensionistëve të pleqërisë




Më poshtë, për ilustrim paraqitet grafikisht balanca/GDP sipas skemave.

Grafiku 19: Balanca/GDP




Më poshtë, për ilustrim paraqitet grafikisht shkallën e zëvendësimit sipas skemave.

Grafiku 20: Shkalla e zëvendësimit



Më qartë të ardhurat sipas skemave duket kur krahasojmë balancën me variantin me kolonë të dytë të plotë dhe me kolonë të dytë të pjeshme 10% si në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 21 : Balanca/GDP në të dy supozimet 10% dhe 5%.




Kjo do të thotë që në këtë variant në kolonën e dytë do të kalojë një pjesë më e vogël të ardhurash, e cila në grafikun e mësipërm paraqitet me pjesën ndërmjet grafikut me kolonës të dytë të plotë dhe me kolonë të dytë të pjesshme 10%.

Meqë në këtë rast do të ketë më shumë kontribues në skemën PAYG do të ketë gjithashtu edhe më shumë përfitues. Kështu shpenzimet do të rriten krahasuar me variantin me kolonë të dytë të plotë, por rritja më e dukshme do të jetë atëhere kur kontribuesit të cilët janë pjesë e të dy kolonave (deri në 35 vjeç) do të fillojnë të marrin përfitime, pra pas 25 – 30 vjetësh (nga viti 2018).

Ndërsa balanca për sistemin në total me të dy skemat sipas GDP do jetë si më poshtë:

Grafiku 22 : Balanca/GDP e të dy kolonave.




Sic shihet në këtë rast në rastin me kolonë të dytë të pjesshme 10% deficiti do të jetë më i vogël në fillim për shkak së një pjesë e kontributit në këtë rast derdhet në skemën

PAYG. Nderësa në rastin me kolonë të dytë të plotë që në vitin e parë të fillimit në skemën PAYG nuk do të kemi derdhje të kontributit.

Ndërsa e krahasuar me opsinin bazë³ balanca/ GDP e krahasuar me skemën e pjesshme 10% balanca e PAYG do të jetë si më poshtë.


Grafiku 23 : Balanca/GDP e krahasuar me variantin bazë.



Ndërsa në kolonën e dytë të krahasuar me situata financiare është përsëri e qëndrueshme me balancë gjithmone pozitive, megjithëse të ardhurat e këtij opsioni janë më të ulta krahasuar me opsinin e mësipërm po gjithmonë do të jetë pozitive si në grafikun e mëposhtëm.


Balanca në këtë variant do të jetë më e ulët krahasuar me opsinin me kontribut të plotë, por sidoqoftë ajo është pozitive që në fillim, fillon e rritet shpejt (**deri rreth vitit 2042**) derisa në skemë të hyjnë në mënyrë masive përfituesit dhe më pas rritet me ritme më të ngadalta.

Grafiku 24 : Balanca/GDP e kolonës së dytë.




Ndërsa raporti balancë / GDP i krahasuar për të dy opsionet për kolonën e dytë ka pamjen e mëposhtme:

Grafiku 25 :Balance/ GDP i krahasuar për të dy opsionet.



Shkalla e zëvendësimit për personat që janë pjesë e skemës PAYG në rastin e kolonës së dytë të plotë dhe kolonës së dytë të pjesshme 10% është e barabartë me shumën e shkallës së zëvendësimit që vjen nga skema PAYG dhe asaj që vjen nga kolona e dytë. Më poshtë ajo paraqitet grafikisht.

Grafiku 26 : Shkalla e zëvendësimit në dy rastet.



Ndërsa shkalla e zëvendësimit që vjen nga skema PAYG ulët vazhdimisht, shkalla e zëvendësimit që vjen nga kolona e dytë deri në vitet 2040 – 2044 është e papërfillshme (shumë pak përfitues ka që përfitojnë nga kjo kolonë në këtë periudhë) dhe më pas fillon e rritet. Por efekti real i këtij sistemi të ri do të duket tek ata përfitues të cilët do të kenë kontribuar gjatë të gjithë karrierës së tyre në kolonën e dytë.


Ndërkohë, nëqoftëse përqindja e kontributit që derdhet në kolonën e dytë është më e lartë apo numri i kontribuesve që i bashkohen kolonës së dytë është më i madh, rritja e shkallës së zëvendësimit do të vihet re më shpejt, por në këtë rast kostoja e tranzicionit do të jetë më e madhe.

VIII. 4. Rezultatet e parashikimit të sistemit me kolonë të dytë të e pjesshme 5%.

Balanca negative e skemës PAYG në këtë variant është në të shumtën e viteve nën 2 % të GDP, me përjashtim të viteve 2018 – 2036, por duhet theksuar se kjo balancë negative mbyllet rreth vitit 2062, duke krijuar kështu një periudhë shumë të gjatë tranzicioni për skemën PAYG. Sic viher re në këtë supozim deficitit i skemës PAYG është më i vogël se në të dy opsionet e para, pra dhe financimi i borxht do të jetë më i vogël për tu zgjidhur. Po nga ana tjetër do të thotë që në këtë variant në kolonën e dytë do të kalojë një pjesë shumë më e vogël të ardhurash. Kështu shpenzimet do të ulen në krahasim me variantin me kolonë të dytë të pjesshme 10% .


Më poshtë, për ilustrim paraqitet grafiksht balanca/GDP sipas skemave.

Grafiku 27:Balanca/GDP




Më poshtë, për ilustrim paraqitet grafiksht numurin e kontribueseve sipas skemave.

Grafiku 28 : Nr kontribuesve sipas skemave.




Më poshtë, për ilustrim paraqitet grafikisht numurin e pensionistëve sipas skemave.

Grafiku 29: Nr pensionistëve të pleqërise sipas skemave.




Më poshtë, për ilustrim paraqitet grafikisht shkallën e zëvendësimit sipas skemave.

Grafiku 30: Shkalla e zëvendësimit




Më poshtë, grafikisht paraqesim balancen/GDP ne te tre variantet e supozuara per kolone e dyte.

Grafiku 31: Balanca/GDP per kolonen e dyte.




Po kështu grafiksht paraqesim dhe balance/GDB për kolonën PAYG në të tre variantet ku futet kolona e dytë përkrah kolonës PAYG.

Grafiku 32: Balanca/GDP për kolonën PAYG.




Grafiksht për tre variantet e supozuara mund të shohim balancën e përmblodhur të dy skemave, PAYG dhe PAYG plus kolonën e dytë përkrah saj.

Grafiku 33: Krahësim i grafikeve Balanca/GDP



Ndërsa **shkalla e zëvendësimit** përmirësohet ndjeshëm, krahasuar me dy variantet e mëparshëm siç shihet në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 34: Shkalla e zëvendësimit sipas 3 skenareve.



KAPITULLI IX → PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

IX.1. Përfundime

Sistemi i pensioneve është një element i rëndësishëm i mbrojtjes sociale në Shqipëri. Megjithëse sistemi i pensioneve në Shqipëri ka kaluar një seri reforma të rëndësishme, në vitet 1993, 2002, 2005 dhe 2014 ai ende përballet me një numër sfidash (ILO, 2015). Aktualisht sistemi i pensioneve në Shqipëri dominohet nga skema e detyrueshme publike, e cila sot menaxhohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Analiza e sistemit bën evidente problemet e funksionimit të tij në kushtet aktuale të zhvillimit ekonomik të vendit tonë. Duke analizuar të gjithë treguesit e sistemi të pensioneve, ata na japin një pamje të qartë për përkeqësimin e situatës së skemës së pensioneve duke na bërë evidente dhe sfidat që do të përballet ai në të ardhmen.

Duke analizuar të dhënat demografike vihet re një plakje e popullsisë shqiptare në të ardhmen afatgjatë, e cila reflektohet në:

- një rritje të pjesës së popullsisë mbi moshën e pensionit
- uljen e pjesës që zë popullsia nga mosha 15 vjeç deri në moshën e pensionit
- uljen e pjesës që zë popullsia nën moshën 15 vjeç

Këto të dhëna tregojnë se rritja e numurit të pensionistëve është me ritme më të larta se rritja e kontribuesve në skeme. Po kështu ulja e numurit të vogël të lindjeve që aktualisht kemi, do të pasqyrohet tek fuqia puntotore në të ardhmen dhe njëkohësisht tek numuri më i vogël i kontribuesve.

Të gjitha këto faktorë demografikë çojnë në një përkeqësim të balancës së skemës së pensioneve e cila mund të verë në pikpyetje vet egzistencën e sistemit të pensioneve.

Me qëllim që sistemi të plotësojë funksionet për të cilat është ngritur, të jetë i qëndrueshëm financiarisht dhe ti përshtatet zhvillimeve të ardhshme social-ekonomike, si alternativë e vetme mbetet vazhdimi i reformimit të tij duke përmirësuar sistemin nepermjet futjes së kolonës të dytë perkrah sistemit PAYG që tashmë egziston.

IX.2. Rekomandime

Duke u bazuar në përvojën e vendeve të tjera që kanë aplikuar një sistem shumëkolonësh, duket të kihet parasysh disa mësimet të nxjera nga këto vende në aplikimin e kolonës së dytë. Duke parë dhe vështirësitë e implementimit në këto vende, i gjithë procesi kërkon një përkushtim dhe profesionalizem të lartë. Vështirësia e implemetimit e bën shumë te domozdoshme asistencen e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë, si BB apo FMN. Këto organizata apo të tjera që mendohet për asistence, duhet të asistojnë që në fillim të procesit të realizimit të reformës.

Duke u mbështetur në analizën e mësipërme të punimit mbi sistemin e pensionit rekomandojmë që:

- Kolona e dytë duhet të jetë e detyrueshme dhe me kontribut të përcaktuar i cili bën lidhjen më të mirë të skemës me individin.
- Masa e kontributit e parashikuar për tu vendosur në kolonën e dytë duhet të jetë 5% dhe me shpërndarje 50% me 50% midis punëdhënësit dhe punëmarësit. Kjo masë e kontributit të derdhur propozohet të jetë brenda masës egzistuese prej 21.6 % të derdhjes së kontributit në skemën e pensioneve.
- Rekomandohet që kjo skemë të menaxhohet nga një kompani private në kuadrin e një “Fond Pensioni”.

- Menaxhimi i kompanisë si “Fond Pensioni” e bën të domozdoshme vendosjen e kufizimeve sipas rregullave të mirëpërcaktuara, duke u bazuar në përvojën e vendeve të tjera për të shmangur reziqet e falimentit të tyre.
- Ngritja e këtij “Fondi Pensioni” e bën të nevojëshme dhe zhvillimin e tregjeve të kapitalit që të bëhet e mundur dhe zbatimi i saj.
- Menaxhimi i mbledhjes së masës prej 5 % të kontributit të derdhur rekomandohet të mbetet brenda skemës aktuale të menaxhimit të detyrimeve e cila realizohet nga Drejtoria e Tatimeve.
- Rekomandohet që për shkak të impaktit të madh që do ketë reforma në skemën aktuale egzistuese PAYG të kryehet me faza dhe jo e menjëherëshme.
- E gjithë reforma kërkon një kohe të domozdoshme për përgatitjen e saj, përjudha e tranzicionit nga skema egzistuese tek skema me kolonë të dyte minimumi kërkon një përjudhë kalimtare 4-5 vjet.
- Për shkak të kostos të madhe financiare të tranzicionit, dhe pamundësisë së përballimit të situatës nga skema aktuale, propozohet që borxhi qeveritar të jetë mekanizmi më i mirë i mbulimit të kostos së tranzicionit në skemën e propozuar.

LITERATURA

- [1] ILO (1952), ILO Convention no.102 on Minimum Standards for Social Security, Geneva: ILO.
- [2] ILO (2012), The Social Protection Floors Recommendation, 2012 (No. 202), Geneva: ILO.
- [3] ILO, World Bank (2015), A shared mission for universal social protection: Concept note. www.ilo.org/ëcm5/groups/public/—dgreports/—dcomm/documents/genericdocument/ëcms_378996.pdf
- [4] Schëartz, A. M., (2006), *Pension system reforms*. Social Protection discussion paper series; no. SP 0608. Washington, DC: World Bank.
- [5] <http://documents.worldbank.org/curated/en/468421468166155721/Pension-system-reforms>
- [6] OECD (2013), Pensions at a Glance 2013: OECD and G20 Indicators, OECD Publishing. http://dx.doi.org/10.1787/pension_glance-2013-en
- [7] Servais, J-M. (2014), International Standards on Social Security Lessons from the past for a better implementation http://islssl.org/ëp-content/uploads/2014/12/Servais_2014_Asian_Conf.pdf
- [8] Mattil, B. (2006), Pension Systems: Sustainability and Distributional Effects in Germany and the United Kingdom. Heidelberg, Physica-Verlag
- [9] BBC (2002), History of pensions: A brief guide, Based on information from the National Association of Pension Funds <http://neës.bbc.co.uk/1/hi/business/2488513.stm>

- [10] Holzmann, R., Hinz, R. (2005), Old-age income support in the 21st century: An international perspective on pension systems and reform. Washington D.C.: The World Bank.
- [11] Caucutt, E.M., Cooley T.F., Guner, N. (2007), The farm, the city and the emergence of social security, NEBR Working Paper No.12854. Cambridge MA: National Bureau of Economic Research.
- [12] Palacios, R., Sluchynsky, O. (2006), Social Pensions – Part I: Their role in the overall pension system, Pension Reform Primer Series Discussion Paper No.0601. Washington DC: World Bank.
- [13] Whitehouse, E. (2007), Pensions panorama: Retirement-income systems in 53 countries. Washington D.C.: The World Bank.
- [14] Should Social Security Benefits Be Means Tested? Martin Feldstein Journal of Political Economy, 1987, vol. 95, issue 3, 468-84
- [15] Reforming Pensions, Nicholas Barr and Peter Diamond November 2008
Submitted to International Social Security Review
- [16] Corsetti, G., and K. Schmidt-Hebbel. 1997. "Pension Reform and Growth." In The Economics of Pensions: Principles, Policies and International Experience, ed. S. Valds-Prieto. Cambridge: Cambridge University Press.
- [17] Diamond, P., and J. Hausman. 1984. "Individual Retirement and Savings Behavior." Journal of Public Economics, 23 (1/2): 81-114.
- [18] Disney, R. 1996. Can We Afford to Grow Older? Cambridge, MA: MIT Press.
- [19] Gruber, J., and D. A. Wise, eds. 1999. Social Security and Retirement around the World. Chicago: University of Chicago Press.

- [20] Holzmann, R., and R. Hinz, et al. 2005. Old-Age Income Support in the 21st Century: An International Perspective on Pension Systems and Reform. Washington, DC: World Bank.
- [21] Kakäani, N., and K. Subbarao. 2005. "Ageing and Poverty in Africa and the Role of Social Pensions." Sector Report, Africa Regional Human Development Department. Washington, DC: World Bank.
- [22] Koitz, D. 1988. Social Security: Its Funding Outlook and Significance for Government Finance. Washington, DC: Congressional Research Service.
- [23] Titmuss, Income Distribution and Social Change(1965)
- [24] Social Exclusion The European Approach to Social Disadvantage S.M. Miller
- [25] World Economic Situation and Prospects 2015
- [26] Central planning . Neë Haven : Yale University Press. 1964.Development planning: the sector phase, ëith different gestation periods. Tinbergen, J. Rotterdam: Netherlands Economic Institute, 1964 .
- [27] Averting the Old Age Crisis Policies to Protect the Old and Promote Groëth . Published for the World Bank Oxford University Press 1994. Foreëord
- [28] <http://www.oecd.org/els/public-pensions/PAG2013-profile-Denmark.pdf>
- [29] A comparison of US and UK pension security systems . David O. Harris Consultant Eatson Eyatt Worldëide International Pensions Seminar 7 June 2001 Brighton, United Kingdom
- [30] The German Public Pension System: Hoë it Was, Hoë it Will Be . Axel Boersch-Supan, Christina B. Wilke NBER Working Paper No. 10525

- [31] Pension Reform: Issues and Prospects for Non-financial Defined Contribution (NDC) Schemes. edited by Robert Holzmann, Edëard E. Palmer
- [32] OECD Reviews of Pension Systems: Mexico 2016
- [33] Pension reform in Poland impact on retirement incomes Agnieszka Chlon-Dominczak Ministry of Labour and Social Policy Helsinki, December 4, 2006
- [34] The sustainability of the Hungarian pension system: a reassessment (A magyar nyugdíjrendszer enttarthatósága) Written by: Gábor Orbán–Dániel Palotai (Economics Department, Magyar Nemzeti Bank) December 2005
- [35] Latvian Pension Reform. Louise Fox Edëard Palmer .August 1999
- [36] The Hungarian Pension Reform: A Preliminary Assessment of the First Years of Implementation Author: Roberto Rocha, Dimitri Vittas. 2002
- [37] Pension System Reform in Emerging Countries *The Case of Kazakhstan* Meiram Zhandildin. 2015
- [38] Pension Reform in Croatia. Zoran Anusic, Philip O'Keefe, and Sanja Madzarevic-Sujster . February 05, 2003
- [39] Pension Reform Issues and Prospects for Non-Financial Defined Contribution (NDC) Schemes Edited by Robert Holzmann and Edëard Palmer
- [40] Kodit i Punes Republika e Shqiperise
- [41] Ligji Nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar)
- [42] Ligji Nr. 4976, datë 29.06.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore”

- |43| VKM Nr. 77, datë 28.1.2015
- |44| http://www.iss.gov.al/al/ep-content/uploads/2014/02/Perb_12_16_26_05_2016.pdf (f 17)
- |45| Bonturi, M. (2002), “The Brazilian Pension System: Recent Reforms and Challenges Ahead”, OECD Economics Department Working Papers, No. 340, OECD Publishing, Paris.
- |46| Fertility reactions to the ‘Great Recession’ in Europe: Recent evidence from order-specific data Joshua R. Goldstein. 2013
- |47| Strategjia kombetare per punesim dhe aftesi 2014-2020 (Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, 2014)
- |48| http://www.iss.gov.al/al/ep-content/uploads/2014/02/Perb_12_15.pdf
- |49| Raporti Vjetor 2015 Banka e Shqiperise
- |50| ILO (2013), Strategjia e Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Sigurime Shoqëror për të gjithë: të ndërtojmë nivele minimale të mbrojtjes shoqërore dhe sisteme të plotë të sigurimeve shoqërore: permbljedhja e sintezes / Zyra Nënrajonale e ONP për Evropën Qendrore dhe Lindore. – Budapest: ILO, 2013
- |51| Partschi, M. (1983), Prinzipien und Formen sozialer Sicherung in nicht-industriellen Gesellschaften, Sozialpolitische Schriften, Heft 48, Berlin: Duncker & Humblot
- |52| Corsetti, G., and K. Schmidt-Hebbel. 1997. “Pension Reform and Growth.” In The Economics of Pensions: Principles, Policies and International Experience, ed. S. Valdés-Prieto. Cambridge: Cambridge University Press.
- |53| Diamond, P., and J. Hausman. 1984. “Individual Retirement and Savings Behavior.” Journal of Public Economics, 23 (1/2): 81–114. Disney, R. 1996.

- [54] Can We Afford to Grow Older? Cambridge, MA: MIT Press. Gruber, J., and D. A. Wise, eds. 1999. Social Security and Retirement around the World. Chicago: University of Chicago Press.

SHTOJCA**Skenari Bazë****Të dhënat demografike**

2020	2025	2030	2040	2050	2060	2070	2075
2,867	2,836	2,797	2,673	2,508	2,327	2,158	2,074
1,452	1,433	1,411	1,348	1,273	1,193	1,108	1,063
1,415	1,403	1,386	1,325	1,235	1,135	1,050	1,011
497	475	440	354	320	285	244	233
254	240	222	182	165	149	126	120
243	235	218	172	154	137	118	113
1,823	1,747	1,672	1,577	1,446	1,256	1,134	1,073
991	949	911	865	801	699	622	590
832	799	761	713	645	557	512	483
546	614	685	741	743	786	780	768
207	245	278	302	307	345	360	352
340	369	407	440	436	441	421	415
102.6%	102.1%	101.8%	101.8%	103.1%	105.1%	105.5%	105.1%
-2%	-2%	-3%	-6%	-7%	-8%	-8%	-8%
-8%	-1.2%	-1.8%	-2.0%	-6%	-1.5%	-1.2%	-8%
-1.1%	-1.1%	-8%	-6%	-1.3%	-1.5%	-1.0%	-1.2%
3.7%	3.0%	1.9%	.2%	.5%	.7%	-.4%	-.3%
100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
17.3%	16.8%	15.7%	13.3%	12.7%	12.3%	11.3%	11.2%
63.6%	61.6%	59.8%	59.0%	57.6%	54.0%	52.5%	51.7%
19.1%	21.6%	24.5%	27.7%	29.6%	33.8%	36.2%	37.0%
57.2	62.3	67.3	69.5	73.5	85.3	90.4	93.3
27.3	27.2	26.3	22.5	22.1	22.7	21.5	21.7
30.0	35.1	41.0	47.0	51.4	62.6	68.8	71.5
3.3	2.8	2.4	2.1	1.9	1.6	1.5	1.4
1.2%	1.1%	.9%	.8%	.8%	.7%	.7%	.7%
1.3%	1.3%	1.2%	1.4%	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%
162.3%	157.0%	151.2%	150.0%	150.0%	150.0%	150.0%	150.0%

Të dhënat e treguesve bazë

	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Popullsia	2,887.6	2,884.5	2,880.8	2,876.7	2,872.1	2,866.9
Jetegjatesia ne lindje: meshkuj	76.0	76.1	76.2	76.3	76.4	76.5
Jetegjatesia ne lindje: femra	80.0	80.1	80.2	80.2	80.3	80.4
Jetegjatesia ne moshen e pensionit: meshkuj	16.3	16.4	16.4	16.5	16.6	16.7
Jetegjatesia ne moshen e pensionit: femra	24.3	24.2	24.1	24.0	23.9	23.8
GDP nominale	1,509,503	1,590,811	1,680,069	1,778,104	1,885,850	2,004,357
Numri total i te punesuarve	1,211.1	1,225.9	1,239.1	1,249.5	1,259.4	1,267.6

Reformimi i sistemit të pensioneve, problemet dhe sfidat.

Numri i kontribuesve		613.7	630.4	647.1	663.2	677.6	691.4
qytet		430.7	448.0	465.5	482.5	498.3	513.6
fshat		183.0	182.4	181.6	180.7	179.2	177.8
Numri total i perfituesve		571.6	584.0	596.9	608.8	621.5	634.6
qytet		428.9	441.6	454.4	466.0	477.9	490.2
fshat		142.7	142.5	142.5	142.7	143.5	144.4
Numri i pensioneve te pleqerise		437.2	445.7	454.7	462.5	471.5	481.5
qytet		311.4	320.3	329.4	337.1	345.4	354.5
fshat		125.8	125.4	125.3	125.4	126.1	127.0
Totali i te ardhurave		54,569.2	58,956.1	63,669.5	68,650.5	73,804.5	79,239.1
qytet		45,775.0	49,807.0	54,171.1	58,815.9	63,662.4	68,794.9
fshat		8,794.2	9,149.1	9,498.4	9,834.7	10,142.2	10,444.2
Kotributet nga punedhenesit dhe punemarresit		49,677.5	54,772.9	60,263.2	66,089.6	72,155.7	78,559.2
qytet		45,403.9	49,403.1	53,731.9	58,339.0	63,146.2	68,237.1
fshat		4,273.6	5,369.7	6,531.3	7,750.6	9,009.5	10,322.1
Totali i shpenzimeve		88,909.9	95,947.2	103,328.4	110,614.3	118,338.7	126,539.1
qytet		74,882.1	80,960.4	87,328.0	93,541.3	100,088.9	107,068.1
fshat		14,027.8	14,986.8	16,000.4	17,073.0	18,249.9	19,471.0
Shpenzime per pensionet e pleqerise		72,008.0	77,932.2	84,169.5	90,278.8	96,832.7	103,892.3
qytet		59,154.8	64,226.5	69,564.9	74,718.4	80,214.8	86,171.8
fshat		12,853.3	13,705.7	14,604.6	15,560.4	16,617.9	17,720.6
Shpenzime per perfituesit e tjere		15,315.6	16,262.9	17,228.9	18,218.0	19,193.2	20,127.7
qytet		14,351.9	15,238.4	16,138.2	17,061.5	17,970.1	18,841.2
fshat		963.8	1,024.6	1,090.7	1,156.5	1,223.1	1,286.5
Balanca		(34,340.7)	(36,991.1)	(39,658.9)	(41,963.8)	(44,534.2)	(47,300.0)
qytet		(29,107.1)	(31,153.4)	(33,156.9)	(34,725.4)	(36,426.5)	(38,273.3)
fshat		(5,233.6)	(5,837.7)	(6,502.0)	(7,238.3)	(8,107.7)	(9,026.8)
Shkalla e zevendesimit per pensionet e pleqerise		39.9%	40.5%	41.0%	41.3%	41.6%	41.8%
qytet		38.4%	38.6%	38.7%	38.6%	38.4%	38.1%
fshat		43.6%	45.2%	46.9%	48.6%	50.3%	51.9%
Norma e varesise se sistemit		83.33	82.75	82.25	81.73	81.56	81.53
qytet		99.59	98.56	97.61	96.58	95.91	95.45
fshat		77.99	78.12	78.45	79.00	80.07	81.20
Norma e varesise se sistemit - pensionet e pleqerise		63.74	63.16	62.67	62.13	61.91	61.90
qytet		72.30	71.48	70.75	69.86	69.31	69.03
fshat		68.74	68.79	69.00	69.44	70.37	71.40
te ardhurat /GDP		3.6%	3.7%	3.8%	3.9%	3.9%	4.0%
qytet		3.0%	3.1%	3.2%	3.3%	3.4%	3.4%
fshat		0.6%	0.6%	0.6%	0.6%	0.5%	0.5%
shpenzimet /GDP		5.9%	6.0%	6.2%	6.2%	6.3%	6.3%
qytet		5.0%	5.1%	5.2%	5.3%	5.3%	5.3%
fshat		0.9%	0.9%	1.0%	1.0%	1.0%	1.0%
shpenzimet per pensione pleqerie /GDP		4.8%	4.9%	5.0%	5.1%	5.1%	5.2%
qytet		3.9%	4.0%	4.1%	4.2%	4.3%	4.3%
fshat		0.9%	0.9%	0.9%	0.9%	0.9%	0.9%
Balanca / GDP		-2.3%	-2.3%	-2.4%	-2.4%	-2.4%	-2.4%
qytet		-1.9%	-2.0%	-2.0%	-2.0%	-1.9%	-1.9%
fshat		-0.3%	-0.4%	-0.4%	-0.4%	-0.4%	-0.5%

Reformimi i sistemit të pensioneve, problemet dhe sfidat.

2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033	2034
2,835.9	2,828.9	2,821.5	2,813.7	2,805.4	2,796.9	2,788.0	2,777.8	2,766.8	2,755.1
77.1	77.2	77.4	77.5	77.6	77.8	77.9	78.1	78.3	78.5
80.9	81.0	81.1	81.2	81.4	81.5	81.7	81.8	82.0	82.1
17.1	17.1	17.2	17.3	17.5	17.6	17.7	17.8	17.9	18.0
23.5	23.6	23.7	23.8	24.0	24.1	24.3	24.4	24.5	24.6
2,711,891	2,879,540	3,057,064	3,245,012	3,443,964	3,654,528	3,877,345	4,113,087	4,362,464	4,626,218
1,243.4	1,237.5	1,231.8	1,224.3	1,217.5	1,211.2	1,205.6	1,199.9	1,193.2	1,186.5
717.3	721.8	726.7	731.4	736.5	741.5	746.4	751.7	756.9	762.2
548.5	555.1	562.0	568.6	575.4	582.2	588.9	595.7	602.5	609.4
168.7	166.7	164.7	162.8	161.0	159.3	157.5	155.9	154.4	152.8
701.3	714.3	726.4	736.8	747.3	756.9	765.6	772.5	778.1	782.8
550.0	561.3	571.8	580.6	589.6	597.7	604.6	610.0	614.8	619.0
151.2	153.0	154.6	156.2	157.7	159.3	161.1	162.4	163.3	163.8
534.1	544.5	553.8	561.4	569.5	577.0	583.6	588.5	592.3	595.2
400.8	409.7	417.5	423.7	430.6	436.6	441.7	445.4	448.5	451.1
133.2	134.8	136.3	137.7	138.9	140.3	141.9	143.1	143.9	144.2
103,477.6	108,835.5	114,432.1	120,141.0	126,070.3	132,169.0	138,409.2	144,909.6	151,591.6	158,503.5
92,308.2	97,541.0	103,011.2	108,591.7	114,387.0	120,351.2	126,463.8	132,824.5	139,369.7	146,147.3
11,169.4	11,294.4	11,420.9	11,549.4	11,683.3	11,817.8	11,945.4	12,085.1	12,222.0	12,356.2
102,598.6	107,912.6	113,463.4	119,125.5	125,006.3	131,055.0	137,244.1	143,691.4	150,318.7	157,174.1
91,559.8	96,750.2	102,176.0	107,711.2	113,459.5	119,375.4	125,438.4	131,747.6	138,239.6	144,962.4
11,038.8	11,162.4	11,287.4	11,414.3	11,546.8	11,679.6	11,805.7	11,943.8	12,079.1	12,211.7
171,999.3	181,839.4	191,595.7	200,988.8	210,824.5	220,576.8	230,161.3	239,296.0	248,230.1	257,040.7
146,394.0	155,026.4	163,592.6	171,803.7	180,487.4	189,055.0	197,409.0	205,401.3	213,292.3	221,158.2
25,605.3	26,813.0	28,003.1	29,185.1	30,337.1	31,521.9	32,752.4	33,894.7	34,937.8	35,882.5
143,987.7	152,748.9	161,408.1	169,702.3	178,449.2	187,128.1	195,628.4	203,659.3	211,476.0	219,149.1
120,528.3	128,159.7	135,709.7	142,904.7	150,579.5	158,152.8	165,499.6	172,463.5	179,307.7	186,105.3
23,459.4	24,589.2	25,698.4	26,797.6	27,869.7	28,975.3	30,128.8	31,195.8	32,168.3	33,043.8
24,736.9	25,649.8	26,574.8	27,499.4	28,407.0	29,295.0	30,190.4	31,099.4	32,017.7	32,950.6
23,102.1	23,945.7	24,798.4	25,648.9	26,485.4	27,303.0	28,130.2	28,972.9	29,829.2	30,701.0
1,634.8	1,704.1	1,776.4	1,850.6	1,921.7	1,992.0	2,060.2	2,126.5	2,188.5	2,249.6
(68,521.7)	(73,003.9)	(77,163.5)	(80,847.8)	(84,754.1)	(88,407.8)	(91,752.2)	(94,386.4)	(96,638.4)	(98,537.2)
(54,085.8)	(57,485.4)	(60,581.3)	(63,212.0)	(66,100.4)	(68,703.8)	(70,945.1)	(72,576.8)	(73,922.7)	(75,010.8)
(14,435.9)	(15,518.5)	(16,582.2)	(17,635.8)	(18,653.8)	(19,704.1)	(20,807.0)	(21,809.6)	(22,715.8)	(23,526.3)
41.8%	41.6%	41.4%	41.1%	40.9%	40.6%	40.3%	40.1%	39.7%	39.4%
36.3%	35.9%	35.5%	35.0%	34.6%	34.2%	33.7%	33.3%	32.8%	32.3%
58.1%	58.8%	59.4%	60.0%	60.4%	60.8%	61.2%	61.5%	61.7%	61.9%
88.58	90.01	91.26	92.31	93.34	94.24	95.04	95.56	95.94	96.18
100.27	101.12	101.74	102.11	102.47	102.65	102.66	102.40	102.03	101.57
89.65	91.78	93.87	95.96	97.91	99.97	102.23	104.15	105.81	107.23
67.58	68.74	69.72	70.51	71.32	72.04	72.68	73.06	73.31	73.43
73.07	73.80	74.29	74.52	74.83	75.00	75.00	74.77	74.43	74.01
78.96	80.88	82.73	84.55	86.26	88.07	90.09	91.77	93.20	94.39
3.8%	3.8%	3.7%	3.7%	3.7%	3.6%	3.6%	3.5%	3.5%	3.4%
3.4%	3.4%	3.4%	3.3%	3.3%	3.3%	3.3%	3.2%	3.2%	3.2%
0.4%	0.4%	0.4%	0.4%	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%

Reformimi i sistemit të pensioneve, problemet dhe sfidat.

6.3%	6.3%	6.3%	6.2%	6.1%	6.0%	5.9%	5.8%	5.7%	5.6%
5.4%	5.4%	5.4%	5.3%	5.2%	5.2%	5.1%	5.0%	4.9%	4.8%
0.9%	0.9%	0.9%	0.9%	0.9%	0.9%	0.8%	0.8%	0.8%	0.8%
5.3%	5.3%	5.3%	5.2%	5.2%	5.1%	5.0%	5.0%	4.8%	4.7%
4.4%	4.5%	4.4%	4.4%	4.4%	4.3%	4.3%	4.2%	4.1%	4.0%
0.9%	0.9%	0.8%	0.8%	0.8%	0.8%	0.8%	0.8%	0.7%	0.7%
-2.5%	-2.5%	-2.5%	-2.5%	-2.5%	-2.4%	-2.4%	-2.3%	-2.2%	-2.1%
-2.0%	-2.0%	-2.0%	-1.9%	-1.9%	-1.9%	-1.8%	-1.8%	-1.7%	-1.6%
-0.5%	-0.5%	-0.5%	-0.5%	-0.5%	-0.5%	-0.5%	-0.5%	-0.5%	-0.5%

2035	2036	2037	2038	2039	2040	2050	2060	2070	2075
2,742.8	2,729.9	2,716.4	2,702.4	2,688.0	2,673.2	2,508.3	2,327.4	2,158.4	2,074.3
78.6	78.7	78.9	79.0	79.1	79.3	80.4	81.5	82.4	83.4
82.2	82.3	82.4	82.5	82.6	82.7	83.7	84.7	85.6	86.4
18.0	18.1	18.2	18.3	18.3	18.4	19.2	19.9	20.6	21.2
24.7	24.8	24.8	24.9	25.0	25.1	25.8	26.5	27.2	27.9
4,905,133	5,200,029	5,511,771	5,841,265	6,189,462	6,557,364	11,578,651	19,998,234	33,617,512	43,145,220
1,180.0	1,174.3	1,169.0	1,163.1	1,157.3	1,150.7	1,074.3	953.7	856.6	812.7
766.7	771.6	776.6	781.5	786.6	791.3	722.0	617.8	550.5	520.5
615.6	622.1	628.6	635.0	641.5	647.6	596.2	515.4	463.9	441.0
151.1	149.5	148.0	146.5	145.2	143.7	125.8	102.4	86.6	79.6
786.1	788.2	788.9	788.7	787.4	785.2	743.0	709.4	658.2	630.6
622.2	624.5	625.5	625.4	624.6	623.3	597.1	584.0	551.8	532.1
163.9	163.8	163.5	163.3	162.8	161.9	145.9	125.4	106.4	98.5
597.0	597.9	597.4	596.0	593.6	590.6	544.8	516.2	473.7	451.4
452.9	454.0	453.9	452.8	451.1	449.1	419.1	410.3	385.7	370.8
144.2	143.9	143.5	143.2	142.5	141.6	125.7	105.9	87.9	80.6
165,449.6	172,676.1	180,156.2	187,852.1	195,891.6	204,077.3	257,580.6	300,580.2	361,301.7	395,885.7
152,968.9	160,064.5	167,411.8	174,980.2	182,881.2	190,941.1	243,560.9	286,667.8	346,962.4	381,334.4
12,480.7	12,611.6	12,744.4	12,871.9	13,010.4	13,136.2	14,019.7	13,912.5	14,339.3	14,551.3
164,063.4	171,230.9	178,649.8	186,282.9	194,256.7	202,375.5	255,441.9	298,093.2	358,320.8	392,623.7
151,728.6	158,766.7	166,054.5	173,561.4	181,398.4	189,392.9	241,586.1	284,343.4	344,149.2	378,242.5
12,334.8	12,464.2	12,595.4	12,721.4	12,858.3	12,982.6	13,855.8	13,749.8	14,171.6	14,381.2
265,521.7	273,689.1	281,279.1	288,403.0	295,145.9	301,577.4	358,621.7	429,960.6	491,487.6	520,670.2
228,786.8	236,176.1	243,020.8	249,384.5	255,464.6	261,329.8	314,730.4	384,637.1	445,213.7	473,624.7
36,735.0	37,513.1	38,258.2	39,018.5	39,681.3	40,247.7	43,891.3	45,323.5	46,273.9	47,045.5
226,501.7	233,554.4	240,039.7	246,055.6	251,681.5	256,996.2	302,768.2	361,341.0	410,870.6	434,324.9
192,670.7	199,008.3	204,808.2	210,120.0	215,137.3	219,931.8	262,461.4	319,931.8	368,946.2	391,882.4
33,831.1	34,546.1	35,231.5	35,935.6	36,544.2	37,064.3	40,306.8	41,409.1	41,924.5	42,442.5
33,874.4	34,777.7	35,665.6	36,552.2	37,439.5	38,323.7	48,041.6	59,513.3	69,763.6	74,510.0
